

EDUKATA ISLAME

REVISTË SHKENCORE, KULTURORE, ISLAME

VITI XXX NR.65 KORRIK-GUSHT-SHTATOR 2001



1971

2001

PRISHTINË
2001

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XXX nr. 65 / 2001

korrik-gusht-shtator 2001

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XXX nr. 65 – 2001

korrik-gusht-shtator 2001

Botues:

Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës

Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84

Tel & fax: 038 / 224-024

e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:

Mr. Qemajl Morina

qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:

Akad. Jashar Rexhepagiq, Dr.Pajazit Nushi,

Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti, Nexhat Ibrahim, i,

Hajrullah Hoxha dhe Xhabir Hamiti.

*Sekretar i redaksisë: **Hajrullah Hoxha***

Lektor: Isa Bajçinca

Korrektor: Skender Rashiti

*Realizimi: **Shtëpia Botuese***



Redaktor teknik: Bashkim Mehani

Operator kompjuterik: Nuhi Simnica

*Shtyp: **Koha** - Prishtinë*

Tirazhi: 1000

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXX nr. 65 / 2001
korrik-gusht-shtator 2001

Prishtinë
2001

Qemajl Morina

TRIDHJETË VJET TË REVISTËS “EDUKATA ISLAME”

Para plot tridhjetë vjetësh (më 1971) zuri të botohej revista “Edukata Islame”, si revistë e parë islame në Kosovë, me iniciativën e mulla Sherif Ahmetit, si organ i Shoqatës së Ulemave, me të cilën edhe iu vu themeli periodikut dhe publicistikës islame kosovare.

Është e madhe, prandaj, rëndësia kulturore-arsimore e posaçërisht ajo edukative e kësaj reviste, natyrisht po qe se ajo vështrohet në kontekst të rrethanave të kohës, të viteve shtatëdhjetë kur qe marrë vendimi për botimin e revistës. Vetë ideja për botimin e revistës ishte më shumë dashje dhe vullnet i mirë sesa mundësi me ndonjë mbështetje reale të potencialit të kuadrove të asaj kohe.

Megjithë vështirësitë dhe sfidat me të cilat u ballafaqua “Edukata Islame” gjatë tridhjetë vjetve të kaluar, ajo arriti jo vetëm të mbijetojë, por edhe të trasojë rrugën e saj duke tubuar rreth vetes një numër të konsideruar dashamirësh të fjalës së shkruar islame në gjuhën shqipe. Ajo ishte tribunë e shprehjes së mendimit islam. Prandaj, me plot të drejtë sot mund të thuhet se “Edukata Islame” gjatë këtyre tridhjetë vjetve ishte histori e gjallë e kulturës sonë islame. Ajo është

kronikë e jetës sonë shpirtërore. Për këtë arsye, çdo hulumtues dhe studiues i zhvillimit të jetës islame në këto troje, e ka vështirë ta bëjë atë pa iu referuar “Edukatës Islame”.

Revista “Edukata Islame” kontribuoi që fjala e shkruar islame në Kosovë të mos mbetet monopol vetëm i saj, por me kalimin e kohës filluan të shihnin dritën edhe botime të tjera të veçanta, ndërsa në vitin 1986 nisi të botohej edhe revista e përmuajshme “Dituria Islame”.

Lexuesit tanë të nderuar të fjalës së shkruar islame, vitet e fundit e kanë ndier mungesën e “Edukatës Islame”, për shkak të organizimit të ri në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës. Mirëpo, nuk ishte e udhës që kjo të refleктоhej në dëm të revistës sonë të vetme islame me një traditë tridhjetëvjeçare. Ky do të ishte një mëkat shumë i madh që do të bënte ky brez në hak të saj dhe përgjithësisht të fjalës së shkruar islame. E sotmja dhe e ardhmja nuk mund të ndërtohen pa u mbështetur në të kaluarën. “Edukata Islame” e pa dritën dhe rritën e saj në kohën më të vështirë, atëherë kur komunizmi ishte në kulmin e fuqisë dhe ajo mbijetoi, siç thamë, falë vullnetit dhe përpjekjeve të atij grupi të vogël, por që kishin besim të plotë se fjala e shkruar shqip islame megjithatë do të triumfonte. Vetëmse duhej pritur. Dhe koha e vërte-toi se ata patën të drejtë.

Duke u nisur nga këto parime Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, në njërin nga mbledhjet e saj të fundit vendosi të marrë përsipër botimin e “Edukatës Islame” për çdo tre muaj. Me këtë ajo dëshiron që fjala e shkruar islame të ketë peshën e saj, sepse ky është misioni i saj dhe përgjegjësia ndaj besimtarëve dhe dashamirëve të fjalës së shkruar islame në Kosovë dhe më gjerë në hapësirën shqiptare.

Lexuesit tanë të dashur do të vërejnë se ky numër jubilar me rastin e tridhjetëvjetorit të daljes së revistës “Edukata Islame” ka një përbërje të re të redaksisë. Në përbërjen e saj kemi akademikë, profesorë universiteti dhe përgjegjës të institucioneve tona me rëndësi kombëtare.

Kjo është një nismë e mbarë, që do të thotë se Bashkësia Islame është e hapur dhe se ajo u takon të gjithë atyre që dëshirojnë dhe janë të gatshëm të bashkëpunojnë me të. Aty ka vend për të gjithë dhe secili duhet ta japë kontributin e vet. Prandaj, shfrytëzojmë nga rasti që t'u bëjmë apel të gjithë atyre që kanë mundësi të japin kontributin e tyre, të na shkruajnë që revista "Edukata Islame" të bëhet vërtetë tribunë e të gjithëve, tribunë e fjalës së shkruar të shkencës, kulturës dhe edukatës islame. Kështu na mëson Kur'ani, libri ynë i shenjtë, kur thotë: "***Nun, betohem në penën dhe në atë që shkruajnë***". (*El-Kalem, 1*).

Njerëzit vdesin; ngjarjet harrohen; objektet, sado të mëdha qofshin, i shkatërron dhëmbi i kohës. Mbetet vetëm fjala e shkruar si dëshmi e kontributit dhe përpjekjeve të njeriut për kryerjen e misionit të tij në këtë botë kalimtare.

Duke shënuar përvjetorin e tridhjetë të "Edukatës Islame", kemi nderin që lexuesve dhe studiuesve tanë t'u prezantojmë bibliografinë e saj. Në këtë bibliografi është publikuar e gjithë lënda e botuar në revistë për këta tridhjetë vjet (1971-2001) sipas standardeve bashkëkohore, kështu që të jetë sa më e lehtë për t'u përdorur nga të gjithë si burim informacionesh e të dhënash konsistente.

Dr. Feti Mehdiu

DY JUBILE TË KULTURËS ISLAME NË KOSOVË

Viti 2001 paraqet një jubile të dyfishtë për kulturën dhe jetën islame në Kosovë, dhe jo vetëm në Kosovë. Këtë vit është përvjetori i tridhjetë i revistës së parë islame në gjuhën shqipe në Kosovë *Edukata Islame*. Është interesant se ky përvjetor përputhet me përvjetorin e pesëdhjetë të gurrës prej nga është ushqyer vazhdimisht kjo revistë. Këtë vit, më 2001, mbushen pesëdhjetë vjet nga fillimi i punës së medresesë së parë shqiptare në Prishtinë. Në këtë mënyrë Kosova sivjet shënon 30-vjetorin e revistës *Edukata Islame* dhe 50-vjetorin e medresesë “Alauddin”.

Medresenë “Alauddin” e përmendëm në këtë kontekst, jo pse ka pesëdhjetëvjetorin e themelimit, por thjesht për arsyen se ky institucion edukativ e arsimor është amëza që e lindi dhe djepi që e përkundi dhe e rriti *Edukatën Islame* kështu si është sot. Është fakt se kjo revistë e filloi punën e vet në vitin 1971 si organ i Shoqatës së Ulemave të Republikës Socialiste të Serbisë, (nr. 1 – 62), dhe më vonë u bë organ i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, (nr. 63 – 64, 1998), por gjithashtu është fakt i pamohueshëm se po të mos ishte medreseja e

Prishtinës e cila i dha jetë dhe krah me kuadrot e saj, *Edukata...* nuk do të gjallëronte dhe të fluturonte deri sot. Këtu qëndron thelbi i arsyes pse këtë revistë e shoh të pandashme, si një trup e një shpirt, me medresenë “Alauddin” të Prishtinës.

Me qëllim që kjo ide të mos keqkuptohet dhe të mos mendohet se mendojmë që me medresenë “Alauddin” fillon çdo gjë, si nga zeroja, në fushë të publicistikës islame, dëshiroj t’u kujtoj lexuesve se, fillimisht, bartësit e përgjegjësisë në këtë drejtim kanë qenë gjenerata paraprake – por të përqendruara në medrese dhe rreth saj – e cila kishite kryer medrese të ndryshme në Kosovë dhe jashtë saj, si në Prishtinë (Pirinaz), Prizren (Mehmed Pasha), Gjakovë (Medreseja e Madhe), Shkup (Medreseja Isa Beg) etj. Kujtoni H. Sherif ef. Ahmetin, kryeredaktorin e parë dhe shumëvjeçar të *Edukatës Islame*, Hfz. Muharem ef. Ramadanin, Rashid ef. Osmanin, Sadri ef. Prestreshin, Ibrahim Spahiun, Hfz. Safet Bashën, Hfz. Muhamet Islamin, Ferid Berishën, etj., të cilët me shkrimet e tyre hapën rrugën dhe i dhanë kurajo brezit të ri që të vazhdonin ta ushqenin revistën me kontributet e tyre. Rrugën e tyre e vazhduan me besnikëri pasardhësit e tyre dhe dalëngadalë zëvendësuan brezin e parë.

Në revistën *Edukata Islame* gjatë kësaj periudhe tridhjetëvjeçare, kontributin e tyre e kanë dhënë studiues, përkthyes e publicistë të ndryshëm në fushën e islamistikës dhe në kulturën shqiptare, jo vetëm kuadro të medresesë “Alauddin”. Këtu kanë kontribuar edhe kuadro që nuk janë drejtpërdrejt të kësaj medreseje, por mbetet fakt i pamohueshëm se pjesa dërrmuese e bashkëpunëtorëve të saj, që është fare normale, kanë qenë prodhim i drejtpërdrejtë i medresesë “Alauddin”. Prandaj këtë kontribut timin, me këtë rast jubilar, e kam lidhur ngushtë me emrin e kësaj shkolle.

Në numrin e parë, në vitin 1971, bashkëpunëtorët e *Edukatës Islame*, të gjithë ishin nxënës ose ish-nxënës të medresesë, me përjashtim

të H.Sherif ef. Ahmetit, i cili nuk ishte nxënës i kësaj medreseje po arsimtar i saj, dhe pikërisht ky u bë kryeredaktori i parë dhe e drejtoi atë deri në vitin 1998, (nr.49)

Bashkëpunëtorët tjerë të numrit të parë kanë qenë:

Hajrullah Hoxha, me dy kontribute,

Jashar Jashari, me dy kontribute,

Jetish Bajrami, me një kontribut, (ish- nxënës që kishin kryer medresenë e ulët të Prishtinës), dhe

Qemajl Morina e Abdulfetah Kadriu, që ishin nxënës të klasës së pestë të medresesë.

Me këtë rast mendojmë se është e udhës që të dallojmë bashkëpunëtorët që kanë kontribuar më së shumti për ta mbajtur në jetë këtë revistë të vetme të kësaj natyre në trojet shqiptare për njëzet vjet me radhë. Do të përmendim bashkëpunëtorët, që janë paraqitur më shumë se dhjetë herë me kontributet e tyre, duke i radhitur sipas radhës alfabetike.

Avni Aliu – pas kryerjes së maturës në medresenë “Alauddin” ka vazhduar studimet e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Gjakovë dhe Prishtinë. Ky është i pranishëm në *Edukata...* prej numrit 5(1972) me përkthimin e artikullit *Pendimi i sinqertë*, nga autori Hasan Levaković, fq. 36-41, dhe gjatë kësaj periudhe ka botuar këtu 26 kontribute me përmbajtje të larmishme nga fusha islame.

Bajrush Ahmeti - pas maturës në medresenë ”Alauddin” ka kryer studimet e Sheriatit në Bagdad, kurse në faqet e Edukatës është paraqitur në numrin 7 (1973) për herë të parë, me kontributin: *Halid ibn Velidi, hero i Jermukut – Shpata e Zotit*, (fq. 43-46). Gjatë këtyre tri dekadave ka botuar 46 kontribute, kryesisht në fushë të historisë islame.

Feti Mehdiu – pas maturës në “Alauddin”, ka kryer studimet në Filologji orientale në Beograd. Magjistroi me temën “Srpskohrvatski

prevodi Kur'ana” dhe doktoroi me temën “Përkthimet e letërsisë arabe në gjuhën shqipe”. Për herë të parë në revistën *Edukata...* u paraqit në numrin 3 (1971), me kontributin: *Të huajët (Jomuslimanët) për Islamizmin, Kur'anin dhe Muhammedin a.s.*, fq.31 – 39. Ka botuar, 23 kontribute të ndryshme, si përkthime, studime, vështrime, diskutime etj., në disiplinat të ndryshme islame.

Hajrullah Hoxha – pas kryerjes së medresesë së ulët në Prishtinë ka kryer medresenë e mesme “Gazi Husrevbeg” në Sarajevë. Në *Edukata Islame* është i pranishëm prej numrit 1 (1971) me dy kontribute: *Me rastin e ditëlindjes së njeriut më të famshëm në botë – Muhammedit a.s.*, (fq.3-5), dhe *Muhammedi a.s. dhe përhapja e fesë islame*, (fq. 19-23). Deri tani ka botuar 48 kontribute, kryesisht në fushën e historisë islame, me përkthime, diskutime etj.

Jashar Jashari – pas kryerjes së medresesë ka vazhduar studimet dhe ka kryer Fakultetin Juridik të Prishtinës. Në numrin 1 (1971) është paraqitur me dy përkthime: *Detyrat e fëmijëve ndaj prindërve*, (fq.24-31), dhe *Feja dhe jeta në dritën e Islamit*, (fq.43 – 47). Në vazhdim ka botuar 18 kontribute të ndryshme, kryesisht përkthime e informata.

Jetish Bajrami – pas kryerjes së medresesë së ulët të Prishtinës, medresenë e mesme e kreu në “Gazi Husrevbeg” në Sarajevë. Është i pranishëm prej numrit 1 (1971), në *Edukata Islame*, me përkthimin *Problemi i prapambetorisë së përgjithshme*, (fq.35 – 42), që e përktheu nga Glasnik VIS-a, nr.11-12/1970. Deri tani ka botuar 15 kontribute, kryesisht përkthime.

Nexhat Ibrahim - pas maturës në “Alauddin”, të Prishtinës, studimet islame i ka kryer në Sarajevë. Në *Edukata Islame* paraqitet për herë të parë në numrin 43 (1985) me dy kontribute: një përkthim nga Mustafa Mahmud, *Struktura e Kur'anit*, (fq.32-42), dhe një studim: *Shkolla juridike hanefite – skicë për një studim* – (fq. 63 – 76). Në

vazhdim ka botuar 12 kontribute: studime, përkthime etj., në akaid dhe disiplina të tjera.

Resul Rexhepi - pas kryerjes së maturës në medresenë “Alauddin” të Prishtinës, ka vazhduar studimet në Libi – Bengazi. Ka kryer studimet në degën e Sheriatit. Për herë të parë paraqitet në revistën *Edukata...* në numrin 22 (1978), me kontributin: *Besimi dhe puna në dritën e islamizmit*, (fq.23 – 28), dhe në vazhdim, deri tani, ka botuar 15 kontribute, kryesisht të së drejtës së sheriatit. Ka përgatitur edhe rubrikën me pyetjet e lexuesve dhe përgjigjet.

* * * * *

Ka edhe bashkëpunëtorë të tjerë që kanë kontribuar njëlloj sikurse këta që përmendëm më lart, porse këtu i veçuam ata bashkëpunëtorë që janë prodhim i drejtpërdrejtë i medresesë “Alauddin” me qëllim që të theksojmë kontributin e saj për revistën *Edukata Islame* dhe për shkakun se viti 2001 është në të njëjtën kohë vit jubilar edhe i medresesë, është pesëdhjetëvjetori i veprimtarisë së saj.

Bashkëpunëtorëve të tjerë, kontributi i të cilëve ka qenë shumë i çmueshëm dhe i mirëseardhur, madje do të jetë i mirëpritur për në të ardhmen, u kërkoj falje sinqerisht. Kontributi i tyre është paraqitur në bibliografinë complete të revistës që po botohet me rastin e tridhjetëvjetorit.

Për studiuesit e ardhshëm të islamistikës shqiptare mbetet obligim që revistës *Edukata Islame*, dhe jo vetëm kësaj, t’i qasen me vlerësimë më të hollësishme e të gjithanshme, me kritikë konstruktive duke i peshuar të gjithë faktorët dhe peripecitë nëpër të cilat ka kaluar ajo gjatë këtyre tridhjetë vjetve. Të mësojnë nga lëshimet eventuale dhe të bëjnë përpjekje që tradita e shkrimit të kultivohet dhe të ngrihet në një shkallë më të lartë.

Hapat e parë, dihet, bëhen duke u rrëzuar, por me ata hapa njeriu ngrihet në këmbë dhe i sillet rreth e rreth botës. Çkado që të hasë studiuesi në këtë revistë, i flet për një kohë dhe rrethana specifike nëpër të cilat duhet të kalojë zhvillimi njerëzor.

Idriz Haxhicana

**FENOMENI I TRINISË FETARE DHE IMPLIKIMET
NË (DEZ)AFIRMIMIN E ÇËSHTJES KOMBËTARE**

Me disa specifika të veta etosi i shqiptarëve i bën ata që aktualisht të dallohen si etnikum i veçantë në bashkësinë e popujve që popullojnë hapësirat e ngushta ballkanike, por edhe jo vetëm ato. Megjithëqë, Evropa, si një truall i përbashkët, pas shumë krahutave, në dhjetëvjeçarët e fundit të mijëvjeçarit të dytë, kryesisht arriti të formëonte identitetin vetanë, shqiptarët si autoktonë aty, sipas disa vlerësimeve, deri tani nuk u përfshinë në shumë procese integruese që po kryhen në hapësirat e Kontinentit të vjetër.

Shkaqet që ndoshta kushtëzojnë pozitën e tyre karshi, tani mund të themi, intencave panevropiane, mund të jenë të natyrave të ndryshme. Pa i veçuar të tjerët, do të përmendim një me të cilin shqiptarët në njëfarë mënyre identifikohen si populli i veçantë kur bëhet fjalë për identitetin kulturor. Kuptohet se kultura paraqet atë komponentën vendimtare dhe dalluese që formon karakterin dhe identitetin e individit dhe të kolektivitetit. Sa i përket Evropës, pra edhe Ballkanit,

është e njohur se dominon tradita fetare kristiane, e cila si ide i ka paraprirë krijimit të identitetit kulturor të qytetërimit evropëndimor.

Ndër shqiptarët kjo traditë është e pranishme me shekuj, mirëpo në historinë e tyre më të re zë fill kultura islame, e cila me koncepte dhe botëkuptime tjetërfare për jetën, ndikoi që në shoqërinë shqiptare, krishterimi të rrudhet në hapësira më të vogla dhe të humbë influencën që kishte pasur. Mbizotërimi i elementit islam në korpusin mbarë-kombëtar, bile formalisht konfirmon këtë fakt.

Në analizat e pasojave të mundshme të këtij realiteti multikonfesional, ka pretendime se kjo ka reperkusione veçanërisht në aspektin e angazhimeve për t'u bërë aktivë në proçese integruese të kontinentit dhe pjesë e komunitetit në të cilin është i përligjur sistemi vlerash që mëton jetësimin e konceptit globalist të jetës dhe ekonomizimit.

Se sa janë këto pretendime të bazuara nga aspekti global, mund të diskutohet duke e vënë çështjen në disa rrafshe, për se nuk do të thellohemi këtu. Le të shqyrtojmë këtë problematikë nga aspekti i ndikimit të multireligjiozitetit në raporte brendakombëtare. Të pasqyrojmë ato momente që ndihmojnë tendencat për (dez)integrimin e qenies nacionale shqiptare.

Konvertimi i (pa)dhunshëm i shqiptarëve

Kur duhet të jepet ndonjë gjykim për një dukuri të caktuar, rëndom nisemi nga preokupime aktuale, që ndoshta deri diku është e kuptueshme duke pasur parasysh nxitje të natyrës emocionale e për më tepër pragmatizmin e nevojshëm në përpjekjen për të zgjidhur ndonjë çështje. Në këto situata lind tendenca që realiteti të pasqyrohet në formën dhe mënyrën që është në funksion të realizimit të synimeve dhe politikës së ashtuquajtur ditore. Kjo bëhet edhe në rastin e shpje-

gimeve të atyre ngjarjeve, të cilat pak a shumë historikisht determinuan pozitën kulturore të shqiptarëve në qytetërimin evropian.

E kaluara shpirtërore e popullit shqiptar, për shkak se mungojnë dokumente historike, paraqet një fushë shkencorisht pak të ndriçuar. Deri tani vetëm një dokument nga gjysma e dytë e shekullit pesëmbëdhjetë zbulon se paraardhësit e tyre komunikonin në gjuhën e cila komfirmon kontinuitetin linguistik të tyre, deri më sot. Përveç kësaj, përmbajtja e tekstit të këtij dokumenti shpalon një të dhënë se besimi i krishterë ishte përcaktim shpirtëror i autorëve shqipfolës. Letrat apo shkrimet e asaj periudhe ndërkaq nuk ofrojnë fakte më të hollësishme se në ç' masë ishte shtrirja e këtij besimi atë botë ndër shqiptarë. Mirëpo, burime të shkruara në gjuhë të tjera, si dhe monumente të kulturës materiale, flasin se megjithatë besimi i krishterë kishte një shtrirje dominuese në shtresat e popullatës shqipfolëse. Bazuar në këtë fakt, ka një tendencë që opinionit të vendit, po sidomos atij të jashtëm, kjo të paraqitet si argument për përkatësinë e gjithmonshme dhe të vazhdueshme, në traditën e shumicës së kombeve evropëndimore. Rrjedhimisht gjithë ajo që sot dallon etosin e shqiptarëve nga kjo traditë, ishte rezultat i ndërhyrjes së dhunshme të kulturës joevropiane, e sjellë me pushtime ushtarake nga ana e popujve të tjerë, kryesisht të Orientit. Kjo do të shkaktojë jo vetëm shkëputjen e lidhjes së “natyrshe” midis popujve të së njëjtës traditë (shqiptarëve dhe evropëndimorëve), por edhe përbrenda korpusit nacional shqiptar do të prodhojë katarzë, e cila potencialisht, në momente të caktuara mund të inicojë antagonizma brenda shqiptarëve, mbi baza të përkatësisë profesionale, që domosdo ka për të dobësuar monolitëtin kombëtar.

Janë këto disa nga konstatimet që mbështetin tendencat për krijimin e qëndrimit prooksidental dhe përpjekje për të arsyetuar aktualitetin e palakmueshëm me këtë të “vërtetë” historike. Por sa është e vërtetë kjo e “vërtetë”?

Teza e parë se besimi i krishterë ishte feja e parë e shqiptarëve apo paraardhësve të tyre, natyrisht se nuk qëndron. S' do mend se Krishterimi si besim ose ideologji, do të jetë pranuar në një periudhë të caktuar historike (thuhet se kjo ka ndodhur dikur para 1600 vjetësh): nga paraardhësit e shqiptarëve. Meqë edhe para kësaj kohe dihet se ata nuk ishin njerëz të pafe ose ateistë po kishin përfytyrime të caktuara religjioze, del se të krishterët e parë shqiptarë kanë qenë të konvertuar.

Teza e dytë për Krishterimin si fe autoktone evropiane, pra edhe shqiptare, po ashtu nuk qëndron. Mbase format institucionale, nëse merret kjo si argument, do të zyrtarizoheshin në Perandorinë Romake (evropiane), megjithëse Bizanti, një qytet i vogël ku ishte selia dhe qendra e mbretërisë së parë krishtere, gjindet në Azinë (e Vogël), si mësim, si besim ose filozofi e jetës, Krishterimi djepin e ka në Lindjen (e Afërme). Vetë Jezusi ishte aziatik. Përveç kësaj, në këtë kontekst ndoshta është interesante të theksohet, dhe kjo gjithnjë sipas autorëve përëndimorë, se misioni i Jezusit kishte tiparet e një rebelimi apo reaksioni ndaj pushtuesit me kulturë evropiane që ishte e personifikuar në civilizimin romak (lexo evropian).

Teza e tretë se në dallim nga Krishterimi, feja tjetër (ISLAMI) u imponua me dhunë, për shumë arsye është e diskutueshme. Në shekujt pestë dhe gjashtë, kur siç pohohet, shqiptarët filluan të krishteroheshin, trevat e tyre ishin të okupuara apo sundoheshin nga të huaj, pikërisht nga ata që atë fe (Krishterimin) e kishin përlligjur si shtetërore apo zyrtare. Edhe pse nuk ka të dhëna se në ç' masë merrte pjesë dhuna në fushata të konvertimit, dihet se dëgjueshmëria qytetare, e nevojshme për pushtetmbajtësit, sigurohej me metoda të drejtpërdrejta apo të tërthorta për nënshtrim. Pasi dëgjueshmëria ndaj pushtetit si rezultat ka një pozitë më të favorshme, deri tek privilegje të caktuara

në shoqëri, - ky parim s'ka se si të pranohet në një rast (Islami) e të përjashtohet në rastin tjetër (Krishterimi).

Objektivisht, në të dy rastet, trajtimi i të nënshtruarve nga ana e pushtuesve, edhe në sferën e jetës shpirtërore (fesë) kushtimisht mund të merret se ishte i njëjtë. Themi kushtimisht, ngaqë një analizë objektive e shkaqeve por edhe i pasojave të ndonjë transformimi të vetëdijes dhe botëkuptimit, realisht nuk ka reperkusione të njëja. Se a ishin ato pozitive apo negative në rastin e ndryshimeve të feve tek shqiptarët, në opinion ekzistojnë dy mendime diametralisht të kundërta. Sidoqoftë, duhet të pajtohemi se ndikimi i kulturave të këtyre dy qytetërimeve, në aspektin e jetës shpirtërore, shkaktoi shkarjen e një uniteti të supozuar të shqiptarëve në vija konfesionale. Kjo ndarje do të institucionalizohej përmes organizimit të tri bashkësive fetare autonome: Kisha Ortodokse Shqiptare, Kisha Katolike, dhe Komuniteti Musliman Shqiptar. Është çështje tjetër me të cilën merren thuajse të gjitha nivelet e shoqërisë shqiptare, e kjo është kontributi i këtyre besimeve në (dez)afirmimin e komponentit kombëtar ose thjesht sa ndihmuan apo penguan, qoftë në të kaluarën, qoftë aktualisht, avancimin e vlerave që fuqizojnë mekanizmat në proceset për mëvetësinë e vërtetë kombëtare?

Karakteri (a)nacional i “Kishës Kombëtare”

Veprimtaria shumëshekullore e këtyre institucioneve kishtarë patjetër që do të reflektohet në raportin e pjesëtarëve respektivë karshi intereseve të kombit duke determinuar edhe qëndrime përkatëse në rastet e përballjes së tyre me sfida historike e konkrete. Në analizat e veprimtarive dhe influencave të këtyre institucioneve në krijimin e vetëdijes kolektive, objektivisht mund të dallohet tendenca që mbëshitet fushatat, synimi i të cilave është arsyetimi i politikës që prioritet ka

realizimin e aspiratave kombëtare. Natyrisht, duke u nisur nga ky fakt, ato medoemos kanë ngjyrimë subjektive, gjë që ndonjëherë edhe pranohet me pretekstin se konstelacioni i faktorëve të vendosjes përbrenda, dhe më tepër jashtë korpusit nacional, e kushtëzojnë këtë.

Pasi dy (ose tri) ritet fetare dominuese tek shqiptarët, përveç të tjerash janë rezultat i administrimit të huaj të vendit, ato edhe drejtoshin nga qëndrimet prej të cilave vinte ky pushtet. Është ky një fakt, por forma zyrtare e lidhjeve qendër-expozitur nuk ishte e njëjtë për konfesionet të veçanta. Edhe pse me kohë, varësisht nga statusi momental juridik i kategorive të caktuara të popullatave, format ndryshonin, në esencë për shkak të karakterit shpirtëror, - këto lidhje kryesisht kanë qenë konstante dhe të afërta.

Do të prezantojmë shkurtimisht natyrën e këtyre lidhjeve, për të kuptuar deri diku shkallën e influencës së mundshme të tyre tek besimtarët në drejtim të formimit të qëndrimit për çështje që prekin interesat e kolektivitetit. Sa u përket të krishterëve aktualisht, siç u përmend më lart, janë të organizuar në dy bashkësi ose, si thonë, në dy kisha – Kisha Ortodokse Shqiptare dhe Kisha Katolike. Përveç për nga riti, këto dy kisha të krishtera dallohen edhe për faktin se e para ka atributin që sugjeron përkatësinë nacionale.

Formulimi i emërimit natyrisht është e drejtë që i takon vetë subjektit e sanksionuar edhe në aktet normative me të cilat rregullon organizimin e brendshëm, mirëpo, edhe pse të vetëdijshëm se kjo mund të kuptohet si ndërhyrja në kompetencat që nuk na takojnë, do të shtrojmë pyetjen si: Sa është adekuat formalisht dhe praktikisht emërtimi, me atë atribut, i komunitetit të ortodoksëve shqiptarë?

Nga ana formale, kjo mund të kontestohet për faktin se, nëse vetëm rreth 10% e shqiptarëve deklarohen si besimtarë ortodoksë, atëherë si do të bëhet me 90%-shin që Kishën e këtij grupimi s'kanë sesi ta konsiderojnë të "veten". Realisht, pjesëtarët e saj janë

bashkëkombas, mirëpo të pretendohet se është gjithëshqiptare në kuptimin nacional, duket disi e pakuptueshme. Për qartësim të kësaj le të bëjmë një krahasim me kishat ortodokse tek popujt e tjerë. Për shembull, Kisha Ortodokse Ruse, Rumune, Greke, Serbe, Maqedonase, Ermene etj. mund të cilësohen si të tilla ngase shumica absolute e pjesëtarëve respektivë janë nga ai komb. Në rastin më të mirë, pa u keqkuptuar, besimtarët ortodoksë shqiptarë mund të kenë dhe duhet të kenë Kishën Autoqefale për veten e tyre, sepse, përndryshe, po qe se ajo do të jetë e gjithë shqiptarëve, - siç mund të kuptohet nga emërtimi, atëherë të gjithëve u lejohet kujdesi dhe ndërhyrja në punët e saj. Meqë kjo nuk ndodh dhe s'ka për të ndodhur, atëherë në njëfarë mënyre përvetësimi i saj kombëtar është nonsens. Mjerisht, për rastin e Kishës "shqiptare", karakterin kombëtar të saj e devalvon fakti se atë e udhëheq një i huaj, pra – joshqiptar! Për çfarë autoqefaliteti mund të bëhet fjalë këtu? Nga aspekti thjesht fetar, këtu s'ka gjë të keqe, meqë duhet t'i përmbahemi dhe të respektojmë parimin hyjnor se besimtarët janë vetëm vëllezër, mirëpo, ndoshta rrethanat politike në të cilat ka vepruar dhe vazhdon të veprojë kjo kishë, kanë ndikuar që të bartë hipotekën që konsiston në dyshimin për konsekuenca negative të bashkëpunimit me simotra të veta, në veçanti me atë greke. Afria mes dy institucioneve të së njëjtës fe, do të ishte diçka krejtësisht normale dhe e kuptueshme, po të mos shfaqeshin pretendime të vazhdueshme të njërit (institucionit grek) ndaj institucionit tjetër (shqiptar) dhe kjo jo vetëm në aspektin fetar. Pavarësia formale juridike e fituar vetëm para më pak se 100 vjetësh në njëfarë mënyre tregon se sa ka qenë i involvuar elementi i huaj në udhëheqjen e punëve kishtare, përmes të cilave ka qenë i mundshëm ushtrimi i ndikimit edhe në sfera të tjera të jetës në shoqërinë shqiptare. Natyrisht, nga përpjekja për ushtrimin e ndikimit prej të huajve, nuk ishin kursyer pak a shumë asnjë nga komunitetet fetare në Shqipëri.

Katolicizmi shqiptar – midis pretendimit për piemont nacional- (ist) dhe universalizmit të proklamuar

Jo rrallë mund të dëgjohe mendimi se shqiptarët para se të bëheshin muslimanë kanë qenë katolikë. Edhe pse zakonisht kjo dëgjohe nga njerëz të rëndomtë që nuk kanë njohuri të mjaftueshme për të kaluarën nacionale dhe fetare, duhet thënë se një bindje e tillë është formuar nga propaganda intensive e disa qarqeve të caktuara që bëjnë glorifikimin e ekzagjeruar të vlerave kulturore krishtere (katolike). Duke dalluar dhe spikatur të bëmat e institucioneve dhe individëve nga provinienca katolike, tentohet të formohet qëndrimi prokatolik dhe sugjesticioni për identifikimin e krishterimit me katolicizmin. Po qe se edhe përmendet ortodoksizmi si rit tjetër i krishterë, pason “shpjegimi” se fjala është për pjesëtarë të rebeluar nga feja katolike dhe se kisha ortodokse është e skizmuar (e shkëputur) nga kisha e “vërtetë” krishtere (lexo: katolike). Sa e (pa)vërtetë është kjo tezë? Çfarë thonë faktet historike në lidhje me rrjedhat e raporteve brenda-krishtere?

Aktualisht në botën e krishterë ka shumë organizata religjioze apo kisha, që pretendojnë se transmetojnë në formë autentike mesazhet e Jezu Krishtit. Në historinë e kishës së krishterë ato lindën si rezultat i mospajtimit doktrinare në interpretimin e mësimëve të Jezuit. Mund të thuhet se mospajtimet kanë filluar që kur ka filluar historia e fesë së krishterë.

Në vitin 395 mbreti Teodos, Perandorinë e madhe Romake e ndau territorialisht në dy pjesë, atë lindore nën administrimin e të birit Arkadie, dhe atë perëndimore nën administrimin e të birit tjetër Honorie. Kjo ndarje territoriale dhe administrative ndikoi që edhe qendrat kish-tare politikën udhëheqëse t’ia përshtatin realitetit të krijuar në Perandorinë Romake. Atëbotë ekzistonin pesë qendra me status të barabartë

juridiko-fetar. Këto ishin ipeshkvitë e Aleksandrisë, Jerusalemit, Antakisë, dhe Konstatinopojës në pjesën lindore të perandorisë, kurse në perëndim vepronte ipeshkvia e Romës.

Pasi fati i këtyre dy rajoneve të mëdha nuk ishte i njëjtë, edhe pozita ose më mirë të themi raporti midis këtyre qendrave kishtare ndryshoi.

Me shkatërrimin përfundimtar të “Romës Perëndimore” (476), ipeshkvi i Romës (deri në shek. VI), më vonë Papa, nisi të pavarësohet duke shtuar angazhimin në pagëzimin e barbarëve dhe njëherësh përfitimin e besnikërisë së tyre. Me kohë nga zotërues të rinj të tokave romake, Papa do të shpërblehej me territore me se do të rriste ndikimin e tij përgjithësisht dhe jo vetëm në aspektin fetar. Këtë ndikim ai tentoi ta shtrinte edhe në pjesën lindore të perandorisë. Pretendime të Papës së inkurajuar, ishin në të drejtën ekskluzive, si vazhdues i traditës shënpaliane edhe përvetësues i titullit Pasardhës si themeluesit të Kishës së Krishterë, për pranimin e primatit në udhëheqjen e botës së krishterë.

Mirëpo, kur këto pretendime u hodhën poshtë nga qendrat kishtare në lindje, pasoi reagimi i Papës (tani kryetar i Kishës Katolike (Katolikos=gjithëpërfshirës, universal) me ekskomunikime e kërcënime, madje edhe me ekspedita ushtarake ndëshkuese ndaj tyre. Kjo situatë konflikti zgjati me shekuj, madje edhe pas ndarjes zyrtare të botës së krishterë (1054).

Historia e këtyre konflikteve shënon shfrenime të egra të kryqtarëve (ekspeditat e Kryqëzatave) perëndimorë, të ndihmuar, dhe shumë prej tyre të organizuar, nga vetë Papa, ndaj Kishës së lindjes, tani Ortodokse (ortodoksis=burimore, e vërtetë, tradicionale). Se kjo ndodhi vërtet, tregon gjesti i Papës së fundit (Gjon Pali II), i cili me rastin e vizitës në kishat e Lindjes (2001), në Stamboll dhe në Siri, kërkoi ndjesë publikisht në emër të Kishës dhe besimtarëve katolikë, për

padrejtësitë e bëra në të kaluarën ndaj kishës dhe besimtarëve ortodoksë, nga ana e parisë katolike dhe ushtrive të shteteve katolike perëndimore.

Ishte ky një historik i shkurtër, nga i cili mund të kuptohen deri diku disa nga shkaqet e përçarjes midis të krishterëve. Ndërkaq, sot ato i dallojnë edhe konceptonet e ndryshme sa u përket autorizimeve të institucioneve supreme kishtarë për të ndryshuar dispozitat fundamentale fetare. Nga viti 1870, aktet fetare juridike të Kishës Katolike, kryetarit të vetë apo Papës, i mundësojnë pushtet të pakufishëm për vendimmarrje sa i përket fushës së religjionit dhe organizimit të jetës së besimtarëve gjithandej në botë. Ai është gjykatës suprem që vendos për caktimin apo shkarkimin e drejtuesve të institucioneve dhe organizmave kishtarë kudo që ekzistojnë ata. Natyrisht, edhe katolikët shqiptarë, mund ta kenë atë udhëheqës që e cakton Ati i Shenjtë e jo atë që e zgjedhin vetë.

Nga ana tjetër, nëse kemi parasysh se Papati ose Citta del Vaticano, jo vetëm që është qendra katolike botërore, por ka statusin e shtetit, në kuptimin juridiko politik, prandaj edhe pozicionimi strategjik dhe ideologjik i tij, objektivisht do të jetë i atillë që mundëson realizimin e interesave politikë e ideologjike të popujve dhe shteteve të provinencës krishtere katolike. Andaj edhe vendimet e kryetarit të Kishës Katolike që kanë të bëjnë me ekspozitura, kuptohet që i përshkon fryma e përkujdesjes për mbështetje të aspiratave pankatolike në botë. Çdo interes tjetër i popujve të veçantë mbetet në planin e dytë. Përfundimisht, çdo formë e manifestimit të ndërgjegjes nacionale do të mirëkuptohet për aq sa ajo është në funksion të politikës globale që udhëhiqet nga kryeqendra fetare.

Në dallim nga dy kishat krishtere ndër shqiptarët, muslimanët, me pavarësimin politik të kombit që i takojnë, çështjen e organizimit fetar e kanë të rregulluar mbi baza të autonomisë së plotë. Kjo do të thotë

se në botë nuk ekziston kurrfarë organi a asociacioni ndërislam, të cilit do t'i referoheshin, gjatë marrjes së vendimeve në komunitetin e vet fetar.

Muslimanët shqiptarë mes detyrimeve kombëtare dhe respektimit të karakterit mbinacional të Islamit

Vërtetë që historia e Islamit njih institucionin e halifes si autoritet suprem shpirtëror të muslimanëve, mirëpo praktikisht këtë autoritet ai nuk e ushtronte shumë më herët sesa formalisht, me vendimin e Asamblesë së Madhe Popullore Turke (mars 1924) kjo të bëhej me titullin formal që e kishte sulltani.

Edhe formalisht nga kjo kohë, muslimanët në botë, juridikisht janë të pavarur në të gjitha aspektet e organizimit të jetës fetare. Duke qenë të detyruar të respektojnë ligjet e shtetit ku jetojnë, ata çështjet fetare përpiqen t'i rregullojnë konformë me dispozitat islame dhe traditën e formuar. Kështu edhe pjesëtarët e fesë islame në tokat shqiptare, Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Mali i Zi, kanë aktet normative, me të cilat rregullojnë në mënyrë autonome çështjen e udhëheqjes së institucioneve të veta. Bashkësia Islame e Kosovës ka Kushtetutën e vet, si akti më i lartë juridik, në të cilën nuk ka asnjë dispozitë që i detyron muslimanët të mbështetin në ndonjë rekomandim të çfarëdo qoftë institucioni i jashtëm në lidhje me organizimin e mbrendshëm të saj.

Aq më tepër, edhe në sferën e zbatimit të ritualeve thjesht fetare, qëndron kërkesa për respektimin e traditës shumëvjeçare, të formuar nga gjeneratat e besimtarëve të këtij nënqielli. Pra, kemi të bëjmë me një traditë autoktone vendore, që dallon nga ato të muslimanëve të viseve të tjera të botës. Krahas kësaj, tek muslimanët shqiptarë, nuk ka munguar asnjëherë vetëdija për përkatësinë e përbashkët në Botën

Islame ose, si do të thoshin ata vetë, në ummetin musliman. Zaten, kjo vetëdije është kultivuar sepse rrjedh nga esenca e kulturës dhe shkencës së besimit që i përkasin, pa e humbur në asnjë moment interesin që të jenë në mbrojtje të qenies kombëtare. Historikisht kjo është vërtetuar kur muslimanët shqiptarë nuk hezituan për shkak të dallimeve në bindjet religjioze, të bashkoheshin me bashkëkombësit e tjerë në një front kundër rrezikut, qoftë të vinte edhe nga ata me të cilët kishin të njëjtën fe. Ngjarjet e historisë së lëvizjeve kombëtare për mëvetësi politike, janë një dëshmi e këtij përcaktimi.

Përfundim

Ndoshta asnjë komb tjetër përreth nuk u është nënshtruar ndikimeve të jashtme sa shqiptarët. Si etnitet i veçantë, pa ngjashmëri të posaçme me popuj të tjerë, shqiptarët kanë qenë pre e lehtë për të huajt. Transformimet që janë bërë në aspektin sociokulturor, sigurisht kanë qenë në rend të parë rezultat i ndërhyrjeve të elementit të huaj. Nga këto ndërhyrje, pak a shumë nuk janë kursyer as të tjerët, por aktualiteti shoqëror në trojet shqiptare sikur vërteton bindjen për pasojë më të dukshme që kanë lënë këto ndërhyrje.

Sigurisht që fenomeni i polikonfesionalitetit ndër shqiptarë nuk mund të injorohet dhe aq më tepër të bëhen përpjekje që ky produkt i “të huajve” të trajtohet parcialisht, dhe nga këndvështrimi jo i njëjtë. Vetëm ndriçimi objektiv i fakteve mund të ndihmojë në kuptimin dhe zgjidhjen e problemeve, që ndoshta mund të jenë pasojë e këtij fenomeni.

Kontributi i çdo konfesionit veç e veç duhet çmuar gjithsesi pasi të bëhen analiza të aktiviteteve të tyre në të kaluarën dhe aktualisht.

Krishterimi si fe e parë monoteiste, shqiptarët i futi në radhët e popujve të qytetërimit evropian, por njëkohësisht bëri ndarjen e parë

kombëtare në katolikë dhe ortodoksë, ndarje kjo që vazhdon me të gjitha implikimet në proceset e formimit të qëndrimit të përbashkët për preokupimet brendakombëtare. Forma institucionale e organizimit të dy riteve të krishtera legalizon në masë të madhe vazhdimin e ndërhyrjeve nga jashtë.

Islami i shqiptarëve, edhe pse bartte hipotekën e ideologjisë “jo-evropiane” pra edhe “joshqiptare”, institucionalisht është i lidhur ekskluzivisht me elementin kombëtar. Mosekzistimi i një qendre fetare botërore, të ngjashme me atë që e kanë besimtarët katolikë, sipas disa mendimeve, paraqet hendikep në realizimin e synimeve për t’u bërë fuqi respektabël ekonomike, kulturore e ushtarake. Mirëpo, çdo formë e lidhjes kërkon detyrimisht sakrifikimin e një pjese të sovranitetit fetar, kombëtar a ndonjë tjetër. Hëpërhë në botë muslimanët, kur është fjala për çështjet fetare, kanë parapëlqyer këtë formë të organizimit duke u përpjekur që përmes vetëvendosjes të ruhen dy identitetet – ai fetar dhe ai kombëtar. Si do të bëhet në të ardhmen, këtë vetëm Allahu e di.

Alija Izetbegović

KUR'ANI DHE SHARTET

Zakonisht ne lexojmë: Janë pesë obligime kryesore fetare: Shehadi, Namazi, Agjërimi, Zekati dhe Haxhi. I quajmë edhe pesë shtyllat e Islamit, ose më shpesh pesë shartet islame.

Këtë e hasim edhe në ilmihalë dhe në enciklopeditë. Kështu mësojnë fëmijët e muslimanëve në të pesë kontinentet. Kështu është themeluar botëkuptimi i përditshëm i muslimanëve dhe i të tjerëve, pa marrë parasysh se ç'është Islami më tutje, pjesa më e madhe e njerëzve konsiderojnë se ai është i dhënë në sharte, e pranuan atë apo nuk e pranuan.

Në mësimin e pesë sharteve përmbledhet kuptimi ynë për Islamin. Më pak është e ditur se në të përmbledhet edhe injoranca jonë për të. Kësaj injorance i është kushtuar ky artikull.

Gjatë leximit të Kur'anit, pasi ju i dini ato sharte, nuk mund t'i shpëtoni ndjenjës se shartet nuk e përmbajnë Kur'anin. Shartet duhej të ishin sintezë e Kur'anit, e ato nuk janë kështu në kuptimin tonë. Njerëzit ato i konsiderojnë si definicionin e Islamit, që nuk mund të jetë kështu asnjëherë.

Në një libër të logjikës lexoj: definicioni është punë logjike me të cilën përcaktohet përmbajtja e ndonjë lënde apo mendimi, kështu që ajo mund të njihet e të dallohet nga të tjerat. Mandej definicioni duhet t'i përshtatet lëndës; ai nuk mund të jetë shumë i ngushtë, e as shumë i zgjeruar, ai duhet t'i përmbajë ato dhe vetëm ato karakteristika që janë të domosdoshme për të caktuar përmbajtjen dhe dimensionin logjik të mendimit. As më shumë as më pak se kaq. Kështu, për shembull: katrori është katërkëndësh, brinjët e të cilit janë identike dhe vertikale me njëra-tjetrën. Elementet esenciale: numri i brinjëve (katër), brinjët identike, këndet në mes tyre (të drejta). Në definicionin që do të linte një nga këto elemente esenciale, ne nuk do të kishim mundësi ta njihnim katrorin. E ky nuk do të ishte definicioni i katrorit.

Diçka e ngjashme ndodh edhe kur i krahasojmë shartet me Islam-in: Shartet nuk i prezantojnë të gjitha elementet esenciale të Kur'anit, e sipas emërtimit duhej ta bënin këtë, të gjithë e presin me të drejtë. Krijohet ndjenjë e rrejshme për njohjen e Islamit vetëm përmes njohjes së sharteve. Kuptimi i gabuar është më i rrezikshëm se injoranca, sepse formohet pasqyra e gabuar e lëndës dhe bllokton dëshirën tonë për të ditur atë që për ne është e panjohur.

Nuk di se kush i ka përkufizuar shartet në formën e sotme, por nëse ato nuk përmbajnë esencën dhe tërësinë e Kur'anit, nuk është fare me rëndësi se si quhej ai person. Mësimi i sharteve është bërë zëvendësim për mësimin e Kur'anit. Metodatat e shkurtuara janë shumë të rrezikshme, andaj kanë përgjegjësi të madhe. Ato në vete mbajnë rrezikun e gjymtimit të ideve kryesore, dhe favorizohen nga përtacia natyrore e njerëzve. Njerëzit, me fjalë të tjera, më shumë preferojnë metodatat e shkurtuara dhe definicionet e gatshme. Kjo i liron ata nga studimi i gjatë dhe i mundimshëm personal. Më lehtë është të mësohen pesë shartet se të studiohet Kur'ani.

Ku është thirrja që të bëhesh i drejtë, e që theksohet në mënyrë kategorike; ku është porosia për luftë e ekspozuar në formë aspak më kategorike; ku është ajo “besoni dhe bëni vepra të mira”, e përmendur në aq shumë vende në Kur’an, me këtë rast jo vepra të mira në aspekt të namazit, agjërimit, veçse vepra të mira në përgjithësi, në kuptimin më të gjerë kuranor. Kjo thirrje që të bëhen vepra të mira, me përmendje të shpeshtë, i jep një nuancë krejt Kur’anit dhe ndikon si mbresa e parë dhe e fundit e atij që e lexon Kur’anin, ja pra, mu kjo thirrje nuk ka gjetur vend në asnjërin prej sharteve.

Të gjithë kanë ardhur në përfundimin se, nëse falem, agjëroj, jap 2,5% nga pasuria dhe eventualisht shkoj në Haxh, unë padyshim e kam siguruar lumturinë në të dy botët! Por a është kështu? – Literatura është e mbushur plot me tregime rreth atyre që kalojnë pragjet e xhamive derisa shpirtrat e tyre i kanë të zbrazëta. Këto rrëfime fatkeqësisht i shkruajnë vetëm qëllimkëqinjë.

Nëse me qindra vjet, nga gjenerata në gjeneratë, njerëzit marrin një formë defekte, të sakatuar, një kuptim të gjymtë të mendimit kryesor që formon frymën, kuptimet dhe sjelljet e njerëzve, a është atëherë çudi që edhe rezultatet në të njëjtën mënyrë të jenë defekte, jo të plota, të gjymta?

Shikuar nga këndi kuranor, Islami i ka mbi të gjitha dy sharte: i pari – të besosh, i dyti – të bësh mirë. Nëse dikush mendon se ajo e mirë mund të kufizohet dhe të përcaktohet vetëm në namaz, agjërim dhe zekat, ai i bën një shërbim shumë të dëmshëm Islamit, e mbi të gjitha i bënë padrejtësi vetvetes.

Natyrisht tani ndonjëri, duke mos kuptuar domethënien e kritikës sime, dëshiron të më kujtojë se kam harruar ahlakun, moralin islam, librin voluminoz që përmban të gjitha rregullat për ndershmeri, drejtësi, thjeshtësi, ndihmesën reciproke, mirësjelljen etj. Mirëpo, a nuk është ahlaku, në dallim nga shartet në plan të dytë? Një anketë siguri-

sht do të tregonte se një numër i madh i muslimanëve jetojnë dhe vdesin duke i ditur shartet, e duke mos ditur gjë për ahlakun dhe dispozitat e tij. Përkërisht, ka të bëjë edhe më faktin se disa nga ato dispozita duhej të ishin “sharte”. Një nga këto dispozita, gjithsesi është edhe misioni i së mirës në botë – kërkesa të cilën Kur’ani, krahas besimit në Zotin, e ka potencuar më së shumti.

Thirrjen e dyfishtë, Kur’ani vazhdimisht, pa u lodhur, e përsëriti në të 23 vjetët e shpalljes në të gjitha situatat që i kalonte shoqëria njerëzore, së cilës i është dedikuar drejtpërdrejt. Vetëm në suren “Bekare” atë e kam hasur në tetë vende (ajetet 58, 62, 82, 83, 117, 224, 254, dhe 227), pastaj njëkohësisht në suret që pasojnë: Ali Imran: 92, 104, 134, 180; Nisa: 36, 58, 124, 149; Maide: 1, 3, 10, 38, 51, 72; A’raf: 156, 198; Tevbe: 21, 72, 113; Hudë: 23; Rra’d: 22-24; Nahl: 90, 97; Isra: 7, 100; Kehf: 30, 108; Merjem: 60, 97; Ta-Ha: 75, 82; Enbija: 73, 94; Haxh: 41, 50, 56 etj. etj. Kjo është vetëm gjysma e parë e Kur’anit.

Ia lë lexuesit që të vazhdojë vetë më tutje, që ta vërtetojë se ajo “*besoni dhe bëni vepra të mira*” njësoj shpesh haset edhe në pjesën e dytë të Kur’anit.

Të besosh dhe të bësh vepra të mira – këto dy ligje të mëdha dhe të pathyeshme të jetës njerëzore, të shkruara në Kur’an në shumë vende, por edhe në zemrat e të gjithë njerëzve, gjenden para të gjitha lutjeve, agjërimeve, sadakave, haxheve dhe ritualeve. Vetëm atëherë kur t’i respektojmë dhe pasojmë ato, nëse pra besojmë dhe bëjmë vepra të mira, jemi muslimanë. Pa to ne nuk jemi ata (muslimanë) pa marrë parasysh “besh vaktin” (të mos e lëmë asnjë namaz) dhe gjërat e tjera të mira, të cilat para këtyre parimeve të mëdha dhe të thjeshta, janë në raport si forma ndaj esencës-thelbit, si teknika ndaj idesë, si mjet ndaj qëllimit. Edhe se a do të plotësohen këto forma me esencën, fenë e gjallë, apo do të jenë guaca të fosilizuara, të zbrazëta e pa jetë,

- varet vetëm nga fakti se a besojmë sinqerisht dhe a bëjmë vepra të mira. Në këto dy ligje mund të reduktohen gradualisht të gjitha kërkesat e tjera, urdhëresat, porosinë këshillat e ndalesat e Kur'anit. Kurse ato vetë janë elementare, më tutje nuk reduktohen njëri në tjetrin, për arsye se përbëjnë esencën e Islamit. Islam nuk ka vetëm me besim, pa vepra në të cilat manifestohet, vërtetohet, verifikohet ai. Dhe anasjelltas. Islam nuk ka vetëm me veprat e mira, pa besimin, në të cilin shihet arsyeja e tyre kryesore, kuptimi metafizik, justifikimi dhe vendi i tyre në fotografinë e përgjithshme të botës: kryej vepra të mira, sepse Zoti ashtu ka urdhëruar, përmbahem nga e keqja, sepse Zoti e ka ndaluar. Pa kontributin tim, një pjesë e botës, do të mbesë përherë e pambarruar apo e papërkryer, e pasendërtuar. Për këtë arsye nuk ka mundësi vetëm të besoj, por më duhet edhe të lëviz, të punoj dhe të veproj.

Ajo që në Krishterim është moto e dashurisë (“duaje të afërmin sikurse veten”), në hinduizëm parim i paqes (“satijagrehe”) ose në marksizëm “qeveria e klasës punëtore” ose “ndarja sipas nevojës” (apo diç e ngjashme), e njëjta gjë në Islam është “të besuarit dhe bërja e veprave të mira”. Në këtë parim gjenden ato dy themelet e Islamit, nga të cilat i pari (besimi) paraqet qëndrimin e brendshëm, një të njohur, intuiçen, përcaktimin, pasqyrimin e brendshëm të botës dhe gjithësisë, ndërsa i dyti (bërja e veprave të mira) nënkupton sjelljen në përputhje me atë besim, me atë vetëdije, pra të vepruarit, të bërës, me një fjalë strukturën e jashtme të fesë. Njëri është ana subjektive e tjetri ana objektive e përkatësisë-islame. Sipas Islamit, çdo gjë humane, andaj edhe çdo gjë islame, përmbledhet në instancën e fundit nga ajo të besosh dhe të bësh mirë. Këto janë ato dy qëllimet për të cilat Islami i thërret të gjithë njerëzit qëllim mirë.

Pse është me rëndësi të vihet në dukje ky aspekt i Islamit? – Njeriu mund të falet, të agjërojë, madje edhe zekatin ta japë (që është më vështirë), e të mbesë i zbrazët. Njeriu, në të kundërtën, nuk mund

të pasojë urdhrin kuranor, për bërjen e veprave të mira e të mos bëhet dhe të mbesë human, thjesht për arsye se nuk mund të jetë njëkohësi-sht i tillë dhe diçka tjetër (të jetë i mirë dhe i keq). Sepse namazi nuk është qëllim, namazi është mjet, rrugë; qëllimi është përsosmëria, qëllimi është mirësia në kuptimin më të mirë të fjalës, ose Zoti si mirësi absolute. Është e mundur falja me dyfytyrësi, por është e pamundur që me dyfytyrësi të jesh njeri i mirë (apo i drejtë). Ndërsa njerëzit shpesh ndërrojnë qëllimin dhe mjetin. Falen, por nga ajo falje kanë vetëm gjimnastikën ose agjërojnë, e nga ajo nuk kanë tjetër vetëm uri dhe etje.

Rreziku kryesor për fenë nuk vjen, siç mendohet zakonisht, nga pabesimtari. Rreziku i vërtetë vjen nga besimtarët e dobët, të padenjë. Besimi ka lindur, jeton dhe mbijeton në polemikë ose luftë me kufrin. Ky ballafaqim është i vjetër sa edhe vetë njerëzimi, e ndoshta do të vazhdojë për sa të ekzistojë ai; ai vetëm mund ta forcojë fenë, jetën e saj të brenshme, t'i sqarojë shkaqet e saj, ta mbajë vigjilente vetëdijen e saj. Aty janë qëndrimet të qarta dhe raportet të pastra. Por ç'të bëhet me fenë formale, të personifikuar në dispozita, në institucione, në hierarki, poza, fraza, iluzione? Kjo humbje e domethënies së vërtetë në formën e zhveshur shkon deri në masën hutuese, p.sh. pesë herë në ditë të pastrohesh dhe prapë të mbetesh i papastër. Në lindje kam parë në xhami, të disa njerëz të cilët merrnin abdest në mënyrë aq rutinore, sa dihej se i "pastronin" të gjitha pjesët e caktuara dhe – mbeteshin të papastër. Të habitur pyesim: Si u shkon kjo gjë për dore? – A nuk është kjo njësoj si edhe të biesh në pishinë e të mbetesh i terur. E krejt shkathësia përbëhet nga ajo se pastrimi është zëvendësuar me fërkim me dorë të lagur. Higjiena ka humbur, ka mbetur vetëm simbolika. Ajo që ka ndodhur këtu me abdestin, ka ndodhur edhe me disa, apo pothuajse me të gjitha dispozitat islame. Islami ka kaluar në ritual, i

zbrazët, dhe pa përmbajtje. Natyrisht, rezultatet në jetën konkrete janë po ashtu shkatërruese.

Prandaj, kur dikush më pyet dhe sidomos kur më pyet fëmija im: Ç'është Islami? – do t'i përgjigjem: Ai është të besosh dhe të bësh vepra të mira. Pastaj do t'i tregoj për namazin, agjërimin, haxhin dhe, në fund, do t'i them se këto janë rite. Ato i takojnë fesë, nëse zemra të është mbushur me besim (iman) në Zotin, dhe sjelljet e tua me vepra të mira. Nëse këto mungojnë këto rite mbesin të zbrazëta.

Situata për të cilën është fjala, shpjegon se për çfarë arsyeje, pa marrë parasysh, për të gjitha interpretimet njerëzore për Islamin, duhet të kthehem gjithnjë tek burimet e Islamit, dhe tek Kur'anit si burim kryesor. Vetëm Kur'anit është realiteti i përgjithshëm për Islamin. Ai është fjalë e Zotit. Shartet janë përpjekje e njerëzve për sintetimimin e Kur'anit.

*Përktheu: **Bashkim Avdiu**
(Marrë nga Takvimi i Sarajevës 1986)*

Ahmed Abdul-Kader Muabi

DËNIMET NË ISLAM

والله لو سرقت فاطمة بنت محمد لقطعت يدها
“Betohem në All-llahun se sikur
të kishte vjedhur Fatimja, e bija e
Muhammedit, do t’i preja dorën asaj”
(Hadith)

Islami është fe e përsosur, në të cilën janë të mbrojtur të gjithë njerëzit. Ai i merr nën mbrojtje të gjithë anëtarët e tij dhe u siguron atyre jetë të qetë e të ndershme. Për këtë qëllim në dispozitat e Sheriatit islam u caktuan dënime për ta mbrojtur të drejtën e individit dhe të bashkësisë. Aty nuk ka dallim midis të voglit e të madhit, të varfërit e të pasurit dhe sunduesit e të sunduarit. Të gjithë janë të barabartë para dispozitave të All-llahut. Këtë më së miri e ilustron fjala e Pejgamberit a.s., para më shumë se katërmbëdhjetë shekujve, ku thotë: “Betohem në All-llahun se sikur të kishte vjedhur Fatimja, e bija e Muhammedit, do t’i preja dorën asaj.”

Ky pra është Islami, që nuk bën dallim midis sunduesit e të sunduarit, zotërisë e shërbëtorit, të varfrit e të pasurit, - e tërë kjo për reali-

zimin e interesit të individit dhe të bashkësisë që ka për qëllim ruajtjen e pesë gjërave kryesore, që janë: 1) mbrojtja e fesë, 2) mbrojtja e shpirtit, 3) mbrojtja e mendjes, 4) mbrojtja e trashëgimisë, 5) mbrojtja e pasurisë.

Jeta pa fe do të thotë anarki dhe parregullsi në shoqërinë njerëzore. Prandaj për personin që i mohon normat e fesë (apstat – murted) është paraparë dënimi me vdekje. Mbrojtja e shpirtit do të thotë mbrojtja e së drejtës së njeriut për jetën:

وَلَكُمْ فِي الْقِصَاصِ حَيَاةٌ يَا أُولِي الْأَلْبَابِ “ **Në ekzekutimin me vdekje është jeta për ju, o ju të zotët e mendjes**”. (Kur’an, 2: 179).

Mbrojtja e mendjes do të thotë ruajtja e saj nga çdo sëmundje, e cila të zotin e saj mund ta kthejë në objekt loje në shoqëri, apo ai mund të kthehet në burim të së keqes dhe t’u sjellë dëm të tjerëve. Prandaj Islami ka ndaluar alkoolin dhe çdo send tjetër që mund të ketë ndikim negativ tek njeriu.

Ndërsa, sa i përket mbrojtjes së trashëgimisë (natalitetit), do të thotë ruajtjes së gjinisë njerëzore, Islami rregulloi dispozitat e martesës dhe nxiti për jetë bashkëshortore, kurse ndaloi cenimin e saj dhe vendosi dënime rigorozë për adulterinë (zinanë).

Përsa i përket ruajtjes së pasurisë, ndaloi rreptësisht vjedhjen dhe plaçkitjen e pasurisë dhe, për ata që cenojnë këtë të drejtë, ka paraparë dënime të rrepta.

Këto janë disa interesa, të cilat Islami i konsideron tejet të rëndësishëm, të cilët nuk lejohet të cenohen nga askush. Prandaj, këtë nëse shoqëria islame dëshiron të jetë e qetë, kërkohet t’i zbatojë dënimet në fjalë, sepse kësodore u ndalet hovi të këqijve, kriminelëve dhe lakmuesve.

Është e vërtetë se dënimet në Islam në pamjen e jashtme duken të ashpra dhe të vrazhda dhe se në aspektin e jashtëm paraqesin mundim për kriminelin, mirëpo ato në realitet janë përmirësim dhe edukim.

Përmirësim për individin dhe bashkësinë, si dhe eliminim i të këqija-ve e dëmeve. Megjithëse në zbatimin e këtyre dispozitave është interesi i të gjithëve, nuk janë të pakët zërat që kërkojnë anulimin e këtyre dënimeve duke pretenduar se ato janë aq të ashpra dhe të vrazhda, sa cenojnë karakterin e njeriut, si dhe nuk i përshtaten kohës në të cilën jetojmë dhe përparimit, dëshmitarë të të cilit jemi edhe ne vetë.

Këtyre shpifjeve mund t'u përgjigjemi si vijon:

Dispozitat e dënimeve në Sheriatin islam e kanë burimin tek i Gjithëdijshmi, i Cili i njeh më së miri interesat e njerëzve dhe mënyrën më efikase për shërimin e sëmundjeve të shoqërisë njerëzore.

Është më se e vërtetë se dënimet e All-llahut janë të ashpra dhe të vrazhda, sa prej tyre të dridhet edhe trupi. Prerja e dorës në rast vjedhjeje, është një ndëshkim i vrazhdë, i cili shkakton ndjenjën e dhembjes për shkak të dobësisë së ndjenjës njerëzore.

Por edhe më e vrazhdë se kjo është gjuajtja me gurë deri në vdekje (rexhm); për të martuarin, i cili cenon nderin e tjetërkujt; po ashtu ekzekutimi me vdekje si dhe vënia në kryq (gozhdimi) si dënim për cubat e rrugëve.

Të gjitha këto dënime, të cilat i caktoi All-llahu i Madhërisëm, ngjallin ndjenjën e frikës dhe të mëshirës në shpirtat e njerëzve tek ata që janë dëshmitarë të këtyre dënimeve, por edhe tek ata që zbatojnë dënimin. Për këtë arsye teksti kuranor thotë në mënyrë të qartë se nuk duhet të kemi mëshirë ndaj atyre mbi të cilët zbatohen dënimet më të vogla siç është “të rënë me shkop”, për se All-llahu i Madhërisëm thotë: *“Laviren dhe lavirin rrehni, secilin prej tyre me nga njëqind të rëna, dhe në zbatimin e dispozitave të All-llahut mos u tregoni zemërbutë ndaj atyre të dyve, nëse jeni që besoni All-llahun dhe botën tjetër. E gjatë zbatimit të ndëshkimit tuaj ndaj tyre, le të jenë të pranishëm një numër besimtarësh.”* (24:2).

All-llahu i Madhërishëm na tregoi urtësinë e vrazhdësisë së dënimit dhe shkakun pse e bëri atë aq të ashpër. Kështu All-llahu xh.sh. na e sqaron dënimin e vjedhjes:

وَالسَّارِقُ وَالسَّارِقَةُ فَاقْطَعُوا أَيْدِيَهُمَا جِزَاءً بِمَا كَسَبَا نَكَالًا مِنَ اللَّهِ وَاللَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٌ

“Vjedhësit dhe vjedhëses prituni duart, si shpagim i veprës që bënë (kjo masë është dënim nga All-llahu). All-llahu është i fuqishëm, ligdhënës i urtë.” (5:38).

Fjala “en-nekal”, e cila përmendet në ajetin e sipërm e ka kuptimin në gjuhën arabe “pengim”, që do të thotë se dënimi i vjedhësit i pengon të tjerët që të bëjnë të njëjtën veprë dhe i ndalon të tjerët që të bëjnë të njëjtin krim. Për këtë arsye ky ndëshkim është një prej begative të All-llahut për atë shpirt të prishur të cilin intuita e tij e çon të cenojë pasurinë e të tjerëve dhe për atë merr dënimin e merituar, ndërsa shoqëria jeton në qetësi dhe siguri të plotë.

Në aspektin e analizës gjuhësore, kuptimi i fjalës së All-llahut

(جِزَاءً بِمَا كَسَبَا نَكَالًا مِنَ اللَّهِ)

është që ky dënim është shpërblim për krimin dhe është pengesë edhe për atë tjetrin që nuk e ka bërë krimin.

DYSHIMET QË PËRHAPEN RRETH EKZEKUTIMEVE

Edhe pse ekzekutimi (kisasi) është çështje pa të cilën nuk mund të zbatohet drejtësia, sepse me të kriminelin merr shpërblimin e tij të merituar dhe në shoqëri mbretëron qetësia dhe drejtësia, megjithatë një numër i orientalistëve përhapin shumë dyshime kundër programit të Islamit rreth çështjes së ekzekutimit të dënimeve, në mesin e të cilave janë:

1) Ekzekutimi i dënimit është një prej pamjeve të primitivizmit dhe brutalitetit (barbarisë);

2) Nëse e zbatojmë ekzekutimin me vdekje të një vrasësi, atëherë shoqëria po i humb dy anëtarë të saj;

3) Krimineli konsiderohet i sëmurë, prandaj sëmundja e tij kërkon shërim e jo mbytjen e tij dhe marrjen e shpirtit;

4) Ekzekutimi i dënimit me vdekje është një lloj hakmarrjeje.

Për t'iu përgjigjur pyetjeve të përmendura, mund të themi:

1) Në ekzekutimin e dënimit me vdekje nuk ka kurrfarë primitivizmi e as barbarie. Por, primitivizëm është të lihet krimineli pa marrë dënimin e merituar, për arsye se ka marrë në qafë një shpirt të pafajshëm. Prandaj do të ishte plotësisht e drejtë që edhe ai të dënohet me të njëjtën masë.

2) Nëse pajtohemi me tezën se krimineli është i sëmurë, ekzistojnë shumë sëmundje për të cilat nuk ka shërim tjetër përpos heqjes së organit të prishur, prandaj mbytja e kriminelit është shërimi i tij që të mos përhapet sëmundja në shoqërinë e shëndoshë.

3) Ekzekutimi i dënimit në Islam nuk është sendërtuar si hakmarrje, por ai është paraparë për pengimin e hakmarrjes. Sepse, sikur ne të mos zbatonim ekzekutimin e dënimit, atëherë do të hakmerreshin të afërmit e të vrarit dhe prandaj kur ne zbatojmë ekzekutimin e dënimit, atëherë ne mbyllim mundësinë e hakmarrjes. E pra, si mund të jetë ekzekutimi hakmarrje?

Ekzistojnë dallime ndërmjet ekzekutimit të dënimit dhe hakmarrjes, prej të cilave më të rëndësishmet janë:

1) Ekzekutimi është i sendërtuar në barazi, ndërsa tek hakmarrja, zakonisht ekziston joproporcionaliteti.

2) Ekzekutimi nuk ndryshon me ndryshimin e fuqisë së ekzekutuesit dhe dobësive të tij. Ndërsa hakmarrja ndryshon me ndryshimin e fuqisë së ekzekutuesit dhe dobësisë së tij.

3) Ekzekutimi është sipas gjykimit të imamit, ndërsa hakmarrja është sipas dëshirës dhe përcaktimit personal të hakmarrësit.

Në zbatimin e dënimeve ka qetësi dhe siguri për shoqërinë dhe në të njëjtën kohë u tërhiqet vërejtja atyre që mendojnë të bëjnë krime. Zbatimi i dënimeve është adhurim dhe xhihad. Adhurim, sepse ai është zbatim i urdhrave të All-llahut, dhe xhihad, sepse ne e mbrojmë shoqërinë nga të këqijat e prishjes së saj dhe elementët që vazhdiisht shkatërrojnë strukturën e saj.

Zbatimi i dënimeve, sado të vrazhda qofshin ato, është mëshirë për njerëzit. Ashtu siç vepron mjeku kur i jep të sëmurit ilaçin jo të këndshëm, apo siç vepron prindi kur e qorton fëmijën e vet, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së tij.

SHERIATI VEPRON PËR PENGIMIN E KRIMIT

Sheriati islam vepron për pengimin e krimit para se ai të ndodhë, me shumë mënyra:

E para: (edukimi shpirtëror)

Sheriati islam i kushton rëndësi të madhe edukimit të ndërgjegjes njerëzore dhe atë e konsideron bazë kryesore për pengimin e krimit, duke marrë parasysh se ndërgjegjia fetare ka ndikim të madh në sjelljet e njeriut të ndërgjegjshëm. Ai e di se është nën mbikëqyrje të vazhdueshme. Për çdo veprim që bënë ai, i vogël qoftë a i madh, ai e kupton se, nëse ai mund të fshihet nga sytë e njerëzve, nuk mund të fshihet nga All-llahu xh.sh.

فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ (٧) وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ

“Kushdo që bën mirësi sa një thërrmijë, do ta shohë atë. Dhe kushdo që bën keq qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë.” (99:7-8).

Nëse ndërgjegjja fetare është në nivelin e duhur tek individ, atëherë ai është i sigurt se nuk mund të bëjë krime. Ai tërë jetën e tij e kalon me moral të lartë, i qetë, nuk ka zili ndaj njerëzve dhe as nuk i përgojon ata.

E dyta: Nxitja për punë dhe braktisja e pasivitetit

Islami i nxit njerëzit të punojnë dhe i qorton ata që të mos jenë pasivë. Këtë më së miri e ilustron këto thënie të Pejgamberit a.s.:

لئن يحتطب أحدكم خيره من ان يسأل الناس أعطوه أو منعوه

“Sikur dikush prej jush të bartë dru, është më mirë se të kërkojë lëmoshë prej njerëzve, i dhanë atij apo jo.”

“Askush nuk mund të hajë ushqim më të mirë se sa ushqimi që është produkt i duarve të tij”; Po ashtu thotë: “I Dërguari i All-llahut, Davudi hante prej punës së duarve të tij.”; dhe në hadithin e transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi thotë:

ما من مسلم يغرس غرسا أو يزرع زرعاً فيأكل منه طير أو إنسان أو بهيمة إلا كان له به صدقة

“Çdo mysliman që mbjell ndonjë pemë a ndonjë bimë, prej të cilës ha ndonjë shpend a ndonjë njeri apo ndonjë shtazë, ai do të ketë prej saj dobi (sadaka).”

E treta: Urdhri për punë dhe ndalimi nga e keqja

Islami thërret që në mesin e aderuesve të tij të mbizotërojë morali i lartë dhe sjellja e mirë. Lidhur me këtë All-llahu xh.sh. thotë:

“*Ju jeni populli më i mirë, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për të mirë, të ndaloni nga veprat e këqija.*” (3: 100). All-llahu xh.sh. po ashtu thotë: “... që porositën njëri-tjetrin t’i

përmbahen së vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.” (103:3).

E katërta: Ruajtja e shenjtërive individuale

Ekzistimi i çdo shoqërie njerëzore do të thotë preokupime dhe detyrime, të cilat i këmbëjnë anëtarët e saj. Po ashtu do të thotë obligime dhe detyrime që lypset të kryhen. Për këtë arsye duhet të ekzistojë një vetëdije e përbashkët në mesin e anëtarëve të shoqërisë.

Islami në misionin e tij erdhi për të ngritur ndjenjën e përbashkët në mesin e besimtarëve, ndërsa metoda që përdori për këtë, është se ai krijoi midis çdo individi shenjtëri, të cilat duhet të ruhen. Për këtë qëllim ai caktoi të drejtën, e cila nuk bënë të cenohet dhe detyrimin që duhet të kryhet ndaj të tjerëve.

Nëse e lexojmë fjalën e All-llahut:

قُلْ تَعَالَوْا أَنَا إِلَىٰ مَا حَرَّمَ رَبِّي كُنْتُم مِّنْ قَبْلِهِ مُشْرِكِينَ ۚ وَلَا تَتَّبِعُوا أَهْوَاءَ قَوْمٍ قَدْ عَتَقُوا النَّفْسَ مِنَّا ۚ إِنَّهُمْ لَا يَفْقَهُونَ إِلَّا سَوَاسِطَ مَا نَحْنُ بِمَبْعُوثِينَ ۚ لَوْ كُنَّا نَسْمَعُ أَوْ نَعْقِلُ مَا كُنَّا فِي أَصْحَابِ السَّعِيرِينَ ۚ وَمَا يَتَّبِعُ أَهْوَاءَ قَوْمٍ قَدْ عَتَقُوا النَّفْسَ مِنَّا ۚ إِنَّهُمْ لَا يَفْقَهُونَ إِلَّا سَوَاسِطَ مَا نَحْنُ بِمَبْعُوثِينَ ۚ لَوْ كُنَّا نَسْمَعُ أَوْ نَعْقِلُ مَا كُنَّا فِي أَصْحَابِ السَّعِيرِينَ ۚ وَمَا يَتَّبِعُ أَهْوَاءَ قَوْمٍ قَدْ عَتَقُوا النَّفْسَ مِنَّا ۚ إِنَّهُمْ لَا يَفْقَهُونَ إِلَّا سَوَاسِطَ مَا نَحْنُ بِمَبْعُوثِينَ ۚ لَوْ كُنَّا نَسْمَعُ أَوْ نَعْقِلُ مَا كُنَّا فِي أَصْحَابِ السَّعِيرِينَ ۚ

“Thuaj: Ejani t’ju lexoj atë që me të vërtetë jua ndaloi Zoti juaj: të mos i shoqëroni Atij asnjë send, të silleni mirë me prindërit, të mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne ju ushqejmë ju dhe ata, të mos u afroheni mëkateve të hapëta apo të fshehta, mos e mbytni njeriun, sepse mbytjen e tij e ndaloi All-llahu, përpos kur është me vend. Këto janë porositë e Tij, kështu që të mendoni thellë. Mos iu afroni pasurisë së jetimit derisa ai të arrijë pjekurinë.” (6: 151-152).

Nëse lexojmë me vëmendje ajetin e lartpërmendur, do të shohim se ai përcakton shenjat e ekzistimit të përbashkët midis individëve të

shoqërisë islame. Secili individ aty ka vendin e vet, pozitën e vet dhe sigurinë e vet në jetë, duke mos pasur të drejtë askush që të cenojë integritetin, nderin dhe pasurinë e tij.

Misioni islam ndaj shoqërisë është mision njerëzor, mision i paqes, i ruajtjes së integritetit, mision i sigurisë dhe qetësisë, mision i ngritjes së njeriut mbi primitivizmin dhe brutalitetin dhe mision i edukimit. Ai është misioni i sigurisë dhe qetësisë, sigurisë kundër cenimit të integritetit të njeriut.

A nuk mjafton kjo që të heshten zërat e armiqve dhe keqdashësve e të lartësohet e vërteta përballë përpjekjeve të armiqve.

ASHPËRSIA E DËNIMEVE DHE KUJDESI NË GJYKIM

Islami ka vendosur dënime efikase, mirëpo ato duken të tmerrshme e të vrazhda për atë që i shikon vetëm në sipërfaqe, pa u thelluar fare në analizën e tyre.

Nëse u bëjmë një vështrim teksteve të Kur'anit dhe haditheve të Pejgamberit a.s., do të shohim se Islami i zbaton këto dispozita vetëm atëherë kur i akuzuari të pranojë se ai i ka kryer ato krime pa kurrfarë arsyeje dhe pa qenë i detyruar të bëjë një gjë të tillë.

Është e vërtetë se dënimi i vjedhësit është prerja e dorës, mirëpo kjo dispozitë nuk zbatohet në asnjë mënyrë nëse ekziston edhe dyshimi më i vogël se vjedhja është bërë për shkak të urisë.

Islami e parasheh dënimin me gurë të lavirit dhe lavires, mirëpo ai e zbaton këtë vetëm atëherë kur ata të jenë të martuar, apo të dëshmojnë për të katër dëshmitarë sipas kushteve të parapara se ata e kanë parë veprën e gjallë. Do të thotë kur ata krenohen për veprën e tyre që ata t'i shohin të gjithë ata dëshmitarë. Në këtë mënyrë veprohet edhe me dënimet e tjera që i ka parapa Islami.

Prej kësaj kuptojmë se Islami ka ndjekur një program të caktuar kur ka bërë të detyrueshme dënimet në fjalë.

Ai në fillim ka zbatuar masat parandaluese për ruajtjen e shoqërisë nga ato shkaqe që mund të çojnë në krime e pastaj zbaton dënimin efikas, dhe ai është i sigurt për drejtësinë e këtij dënimi për atë person, të cilin nuk e shpie në krim ndonjë shkak i arsyeshëm.

Duke u nisur nga kjo, mund të pohojmë se programi islam është vital dhe dinamik, është program i përsosur, për arsye se ai mbështetet në kushtetutën qiellore.

LLOJET E DËNIMEVE NË ISLAM

E para: Dënimi i adulterisë (zinasë)

Ky lloj dënimi ndryshon prej një personi tek tjetri, nëse është i martuar apo jo. Dënimi i të martuarit nëse bën zina (marrëdhënie jashtëmartesore), është mbytja me gurë, burrë a grua. Këtë e argumenton hadithi i Ubadete ibnu Samit: الثيب بالثيب جلد مائة والرجم *“I veu me të venë me njëqind të rëna dhe vrasje me gurë.”* Si dhe hadithi i Asifit, të cilin e transmeton Ebu Hurejre r.a.:

واغد يا أنيس إلى امرأة هذا فان اعترفت فارجمها *“Çohu Enis, tek ajo grua, e nëse ajo pranon, dënoje me vrasje me gurë.”* Pejgamberi a.s. një dënim të këtillë kishte aplikuar ndaj Maizit, Gamidis dhe dy çifutëve. Ndërsa prijësi i besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibi, e kishte dënuar vrasjen me gurë Sherahaten.

A duhet të dënohet e veja me të rëna para se të vritet me gurë?

Lidhur me këtë, dijetarët kanë dy mendime:

1) Shumica e dijetarëve janë të mendimit se ajo nuk duhet të dënohet me të rëna, por duhet të vritet me gurë.

2) Ahmedi dhe Is-haku mendojnë se, ajo duhet të dënohet me të rëna e pastaj të vritet me gurë.

Mendimi i parë është më i rekomanduar sepse Pejgamberi a.s. urdhëroi të vritej me gurë Gamidia dhe po këtë e urdhëroi edhe për Maizin dhe i tha Enisit: *“Çohu o Enis, tek ajo grua, e nëse ajo e pranon atëherë mbyte atë me gurë”*, e nuk tha: Dënoje atë me të rëna e pastaj me gurë.

DËNIMI I BEQARIT

Beqar do të thotë, i pamartuar se e pamartuar.

Dënimi i beqarit është njëqind të rëna (shkopinj). Këtë dënim e mbështetin të gjithë fukahenjtë, për shkak të tekstit të Kur'anit:

“الرَّائِيَةُ وَالرَّائِي فَاجْلِدُوا كُلَّ وَاحِدٍ مِنْهُمَا مِائَةَ جَلْدَةٍ” ***“Laviren dhe lavirin t'i rrihni secilin prej tyre me nga njëqind të rëna”***. (24:2).

Ndërsa, sa i përket internimit, dijetarët e fikhut kanë mendime të ndryshme, mirëpo preferohet dënimi me gjithë të rënat me shkop.

DËNIMI I VEJUSHËS

Dënimi i të martuarit, qoftë burrë a grua, nëse ka bërë zina (marrëdhënie jashtëmartesore), është vrasja me gurë. Të gjithë dijetarët, pa përjashtim, janë të këtij mendimi, duke filluar prej sahabëve dhe tabiinëve. Këtë e vërtetojnë veprimet dhe fjalët e Pejgamberit a.s.. Ubadete ibnu Samit transmeton nga Pejgamberi a.s. se ai ka thënë:

خذوا عني خذوا عني قد جعل الله لهن سبيلا البكر بالبكر جلد مائة
و تغريب عام والثيب بالثيب - الجلد والرجم

Merreni prej meje, merreni prej meje. Beqari me beqaren njëqind të rëna me shkop dhe dëbimi një vit dhe vejani me vejushën njëqind të rëna dhe vrasje me gurë”. Mirëpo, meqenëse vërtetohet saktësia e

hadithit që ka transmetuar Ebu Hurejre, se Maizi e kishte pranuar aktin e zinasë para Pejgamberit a.s., atëherë, Pejgamberi a.s. tha: *“Merreni këtë dhe shkoni e mbyteni me gurë”*, Ibnu Shihabi thotë: *“Më ka treguar njëri prej atyre që e kishte dëgjuar Xhabir ibn Abdullahun që kishte thënë: “Isha prej atyre që e gjuanim me gurë dhe kur atë e kishin lodhur gurët, iku, mirëpo ne e zumë në rrugë dhe e mbytëm me gurë”*.”

Po ashtu Pejgamberi a.s. kishte urdhëruar vrasjen me gurë të Gamidisë, e cila kishte bërë zina dhe ishte e martuar.

Shumica dërmuese e fukahenjve e mbështetin dënimin me gurë të personit të martuar që bënë zina, duke u mbështetur në ajetin e Kur’anit:

الشيخ و الشيخة اذا زينا فارجموها البته نكالا من الله والله عزيز حكيم

Mirëpo, leximi i këtij ajeti u shfuqizua dhe mbeti fuqia e tij.

Këtë e vërteton fjala e Umer ibnu Hattabit r.a.:

“Kam frikë se njerëzit pas një kohe, do të thotë dikush prej tyre: Nuk e gjejmë vrasjen me gurë në Librin e All-llahut dhe ata humbin duke e lënë njërin prej farzeve, të cilin e zbriti All-llahu xh.sh. Vrasja me gurë gjendet në Librin e All-llahut dhe ai është obligim për çdo të martuar, burrë a grua, nëse ekzistojnë faktet e qarta, si shtatëzania apo vetë personi e pranon aktin e kryer. Pejgamberi a.s. aplikoi rexhmin ndaj Asimit vetëm atëherë kur ai erdhi te Pejgamberi a.s. dhe e pranoi aktin e kryer dhe kërkoi prej tij që të zbatonte vrasjen e tij me gurë. Këtë kërkesë ai e bëri me dëshirë dhe e përsëriti katër herë. Çdo herë kur Asimi paraqitej para Pejgamberit a.s., ai e kthente atë me shpresë se do ta ndërronte mendimin.

Në të njëjtën mënyrë veproi Pejgamberi a.s. me gruan e quajtur El-Gamidije, e cila iu paraqit Pejgamberit a.s. kur ishte shtatzënë nga marrëdhëniet jashtëmartesore dhe pranoi veprën e kryer. Pejgamberi

a.s. e urdhëroi atë të shkonte derisa të lindte. Ajo veproi ashtu dhe u kthye pas lindjes me dëshirë, duke kërkuar prej Pejgamberit a.s. zbatimin e dënimit ndaj saj. Pejgamberi a.s. e urdhëroi të shkonte dhe t'i jepte gji të porsalindurit. Ajo u kthye pas një periudhe dhe me fëmijën e saj në krah, i cili mbante në dorë një copë bukë, si argument se më nuk kishte nevojë për qumështin e saj. Prandaj nuk kishte tjetër pengesë për zbatimin e ndëshkimit ndaj saj.

Kështu pra, pranimi nga vetë personi për kryerjen e aktit të adulterisë, (zinasë) është kusht për zbatimin e ndëshkimit.

Përveç pranimit, ndëshkimi bëhet ndaj personit që ka kryer krimin e adulterisë (zinasë), nëse për të dëshmojnë katër dëshmitarë, të cilët janë dëshmitarë të gjallë për kryerjen e aktit të zinasë, mbështetur në ajetin e Kur'anit:

وَالَّذِينَ يَزْمُونَ الْمُحْصَنَاتِ ثُمَّ لَمْ يَأْتُوا بِأَرْبَعَةِ شُهَدَاءَ فَاجْلِدُوهُمْ ثَمَانِينَ
جَلْدَةً وَلَا تَقْبَلُوا لَهُمْ شَهَادَةً أَبَدًا وَأُولَئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ ۖ

“Dhe ata, që bëjnë shpifje për gra të dëlira dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, t'i rrihni me tetëdhjetë kamxhikë”. (24:4).

Personi ndaj të cilit zbatohet vrasja me gurë është njeri i martuar.

Fshehtësia e ashpërsisë së dënimit tek i martuari është sepse martesa duhet ta mbrojë atë që të mos mendojë për marrëdhënie jolegjitime (zina). Nëse nuk mund ta frenojë veten, do të thotë se instinkti i epsheve të tij të ndaluara është i fuqishëm dhe prandaj duhet të parashihet ndëshkim i vrazhdë e i dhembshëm, që nëse ai mendon këtë instinkt të epshit të ndaluar, le t'i kujtohet dënimi i ashpër i paraparë, dhe do të jetë shkak që ai të largohet nga të menduarit për kënaqësitë me rastin e kryerjes së marrëdhënieve jashtëmartesore (zinasë). Njeriu i pamoralshëm në shoqëri, është shembull shumë i keq, prandaj shembulli i keq në Sheriatin islam nuk duhet të ekzistojë. Nuk ka dyshim

se ky ndëshkim ka ndikim shumë të madh në kuptimin dhe eliminimin e krimit në çdo kohë dhe në çdo vend.

E dyta: Dënimi i vjedhësit

Sheriati islam ka paraparë prerjen si mjet për dënimin e vjedhësit. Lidhur me këtë, Kur'ani thotë:

وَالسَّارِقُ وَالسَّارِقَةُ فَاقْطَعُوا أَيْدِيَهُمَا جِزَاءً بِمَا كَسَبَا نَكَالًا مِنَ اللَّهِ وَاللَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٌ

“Vjedhësit dhe vjedhëses prituni duart si shpagim të veprës që bënë. Kjo masë është dënim nga All-llahu.” (5:38).

Fukahenjtë pajtohen se fjalët: “duart e tyre” përfshijnë dorën dhe këmbën. Kur vjedhësi vjedh për herë të parë, i pritët dora e djathtë, por nëse e përsërit atë për herë të dytë, atëherë i pritët këmba e majtë. Prerja e dorës bëhet nën byzyl, ndërsa këmba pritët në nyjën e shputës së këmbës.

Dijetarët e fikhut përmendin disa kushte, që duhet t'i paraprijnë ekzekutimit të dënimit, që janë:

1. Vjedhësi të jetë i moshës madhore.
2. Të jetë i lirë.
3. Gjësendet e vjedhura të jenë pasuri.
4. Gjësendet e vjedhura të jenë pasuri me vlerë.
5. Pasuria e vjedhur të arrijë vlerën (nisabin) një e katërta e dinarit apo tre dërhëmë, sipas mendimit të shumicës së dijetarëve.
6. Të nxirret pasuria prej vendit të ruajtur.
7. Vjedhësi të mos ketë lidhje me pasurinë e vjedhur, sepse nuk zbatohet dënimi nëse pasuria e vjedhur i përket babës së vjedhësit.
8. I vjedhuri të kërkojë prej vjedhësit pasurinë e vjedhur.

Motivi i ndëshkimit të vjedhësit apo vjedhëses me prerje është për arsye se ai që mendon të vjedhë, mendon që pasurinë e tij ta shtojë, duke i dëmtuar të tjerët. Atij nuk i mjafton pasuria e tij nëse ka pasuri,

por ai dëshiron ta shtojë pasurinë e tij, ose të paraqitet para njerëzve se është i pasur, ose të fitojë pasuri pa u munduar fare. Shkaku që e shtyn atë të vjedhë është fitimi ose shtimi i pasurisë. Sheriati e lufton këtë motiv duke zbatuar ndëshkimin e prerjes, sepse prerja e dorës a këmbës shkakton zvogëlimin e pasurisë, për arsye se dora dhe këmba janë mjete për punë. Me prerjen e tyre natyrisht zvogëlohet fuqia si në aspektin e prodhimit, edhe në aspektin e të pamit. Kjo do të thotë se Sheriati islam ka stimuluar faktorët, që nxitin për kryerjen e krimit me faktorët psikikë kundër krimit të vjedhjes.

Për këtë shkak dështuan ligjet e shpikura nga njerëzit, kur vendosën që ndëshkimi i vjedhjes të jetë me burg, sepse ky dënim nuk krijon në psikën e vjedhësit faktorë shpirtërorë, që do ta largonin atë prej krimit të vjedhjes.

Për këtë arsye kur orientalistët thonë se dënimi i vjedhjes në Sheriatin islam është shumë i ashpër dhe i vrazhdë, ne u themi atyre se ashtu është, mirëpo ajo është në nivel të aktit, që bën krimineli dhe dënimi duhet të jetë i të njëjtit nivel. Prandaj, aty nuk ka kurrfarë egërsie. Mirëpo, i egër është ai, që e plaçkit pasurinë e tjetërkujt pa të drejtë. Në anën tjetër, krimi i vjedhjes mund të bartë me vete edhe krime të tjera. Vjedhësi gjatë kryerjes së krimit të tij mund të vrasë pronarin e pasurisë, ose ta maltretojë atë, si dhe të përhapë frikë midis njerëzve për sigurinë e tyre.

Nëse bëjmë një krahasim midis shteteve që zbatojnë dënimin e prerjes së dorës dhe atyre që zbatojnë dënimin me burg, do të shohim se në vendet në të cilat zbatohet dënimi i prerjes së dorës, dukuria e vjedhjes është shumë e rrallë, ndërsa në vendet ku zbatohet dënimi me burg, kemi dështim të plotë. Këtu duhet shtuar se buxheti i këtyre shteteve është shumë i ngarkuar. Po ashtu, mund të shtojmë se zakonisht nëpër burgje bëhen bashkë i miri dhe i keqi. Aty gjenden ind-

ivide, të cilët janë të dënuar për kundërvajtje, si dhe kriminelë të vërtetë e kjo mund të jetë si shkak për përhapjen e krimit në mes tyre.

E treta: Dënimi i alkoolit

Sheriati islam për atë që e pi alkoolin, parasheh dënimin me tetëdhjetë shkopinj. All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

إِنَّمَا الْخَمْرُ وَالْمَيْسِرُ وَالْأَنْصَابُ وَالْأَزْلَامُ رِجْسٌ مِّنْ عَمَلٍ
الشَّيْطَانِ فَاجْتَنِبُوهُ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ

“Vërtet vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre, që të jeni të shpëtuar.” (5:90).

Çdo send që të dehë, konsiderohet alkool dhe për këtë Pejgamberi a.s. thotë: “Çdo pije është verë dhe çdo verë është haram.” Është zhvilluar një polemikë e gjatë rreth numrit të shkopinjeve, por ne po japim vetëm dy nga mendimet kryesore:

Mendimi i parë: Tetëdhjetë shkopinj. Të këtij mendimi janë imami Malik, Ebu Hanifja dhe një version i Ahmedit.

Mendimi i dytë: Dyzet shkopinj, të këtij mendimi janë imam Sha-fiu dhe imam Ahmedi, sipas një transmetimi. Mendimi më i preferueshëm është ai që e ka përkrahur Shejhul Islami ibnu Tejmije, se dënimi i atij që pi është me dyzet shkopinj dhe lejohet shtimi deri në tetëdhjetë.

E katërta: Homoseksualiteti dhe dënimi i tij

Homoseksualiteti është i dënuar me argumente të Kur'anit, Syneetit dhe Ixhmait. All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

وَلَوْطًا إِذْ قَالَ لِقَوْمِهِ أَتَأْتُونَ الْفَاحِشَةَ مَا سَبَقَكُمْ بِهَا مِنْ أَحَدٍ مِنَ الْعَالَمِينَ
إِنَّكُمْ لَتَأْتُونَ الرِّجَالَ شَهْوَةً مِنْ دُونِ النِّسَاءِ بَلْ أَنْتُمْ قَوْمٌ مُّسْرِفُونَ

“(Kujto) edhe Lutin kur iu drejtua popullit të tij: A punoni të shëmtuarën, që asnjë nga popujt e botës nuk e bëri para jush. Vërtet, ju kryeni ephet tuaja tek burrat në vend tek gratë? Jo, por ju jeni një popull që po i kaloni të gjithë kufijtë.” (7:80-81).

Pejgamberi a.s. thotë:

“All-llahu e mallkoftë atë që e bën punën e popullit Lut. Këtë e përsëriti tri herë.” (Transmeton ibnu Hibbani).

Kurse sa i përket Ixhmait, janë pajtuar të gjithë sahabët e Pejgamberit a.s. se personi që kryen akt homoseksualiteti duhet të ekzekutohet.

Lidhur me dënimin e tij dijetarët kanë tri mendime.

Mendimi i parë: Një grup i sahabëve, dhe ky është medhhebi i imam Shafiut dhe një version i Ahmedit: duhet të ekzekutohet subjekti dhe objekti qofshin ata të martuar apo jo, duke u mbështetur në thënien e Pejgamberit a.s.:

“Cilindo që e gjeni duke kryer veprimin e popullit Lut (kryen aktin e homoseksualitetit), mbyteni subjektin dhe objektin.”

Mendimi i dytë: Veprohet me ta ashtu siç veprohet ndaj lavirit dhe lavires, vritet me gurë i martuari dhe dënohet me njëqind shkopinj, i pamartuari me internim për një vit. Ky është mendimi i Seid ibnu Musej-jebit, i Atait, Hasanit, Nahit, Thevriut, Evzaiut dhe një version i Ahmedit. Argument për këta është fjala e Pejgamberit a.s.:

“Nëse mashkulli me mashkull ka marrëdhënie seksuale ata kanë bërë adulteri (zina).”

Mendimi i tretë: Homoseksuali dënohet vetëm me të rëna me shkopinj. I këtij mendimi është imam Ebu Hanife. Argument i tyre është se Kur’ani nuk ka paraparë haptazi ndonjë dënim të caktuar. Gabimi në falje është më i lehtë se gabimi në dënim, duke u mbështetur në thënien e Imam Aliut r.a.:

لئن اخطيء في العفو خير من ان اخطيء في العقوبة

“Gabimi në falje është më i lehtë se gabimi në dënim.”

Unë preferoj mendimin e dytë.

E pesta: Dënimi i shpifjes

All-llahu xh.sh. në kaptinën “Nur” thotë:

وَالَّذِينَ يَزُمُونَ الْمَخْصَنَاتِ ثُمَّ لَمْ يَأْتُوا بِأَرْبَعَةِ شُهَدَاءَ فَاجْلِدُوهُمْ ثَمَانِينَ جَلْدَةً

وَلَا تَقْبَلُوا لَهُمْ شَهَادَةً أَبَدًا وَأُولَئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ

“Dhe ata që bëjnë shpifje për gra të dëlira dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, t’i rrihni me tetëdhjetë kamxhikë, dhe mos ua pranoni kurrë më atyre dëshminë.” (24:4).

Shpifja që sjell dënimin, mund të jetë në dy mënyra:

E para: Kur shpifjen e bën për marrëdhënie jashtëmartesore (zina).

E dyta: Mohimi i plotë i prejardhjes.

Shpifja duhet të jetë në mënyrë të qartë deklarative, e jo në mënyrë indirekte si p.sh. fjala e shpifësit o lavir.

DËNIMI I SHPIFËSIT

Dënimi i shpifjes sipas shariatit është tetëdhjetë shkopinj. Pejgamberi a.s. i kishte dënuar grupin e shpifësve me nga tetëdhjetë të rëna me shkopinj për ngjarjen e trillimit të njohur në historinë islame.

E gjashta: Dënimi i plaçkitësve

Ata janë që u dalin njerëzve në rrugë dhe ua plaçkitin pasurinë e tyre.

Dënimi që ka paraparë Islami për ta, është: 1) Ekzekutimi me vdekje, 2) gozhdimi, 3) Prerja e pjesëve të trupit, 4) Internimi.

Këto katër dënime janë përmendur në Kur'an me pjesëzen او Dijetarët kanë mendime të ndryshme rreth kuptimit të saj, nëse është për lirinë e zgjedhjes apo për lloj-llojshmërinë që pastaj dënimi të zbatohet sipas llojit të krimit.

E vërteta është se ajo është për llojllojshmërinë dhe radhitjen, do të thotë radhitjen e dënimit sipas nivelit të krimit. All-llahu xh.sh. thotë:

إِنَّمَا جَزَاءُ الَّذِينَ يُحَارِبُونَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَسْعَوْنَ فِي الْأَرْضِ فَسَادًا أَنْ يُقَتَّلُوا أَوْ يُصَلَّبُوا أَوْ تُقَطَّعَ أَيْدِيهِمْ وَأَرْجُلُهُمْ مِنْ خِلَافٍ أَوْ يُنْفَوْا مِنَ الْأَرْضِ ذَلِكَ لَهُمْ خِزْيٌ فِي الدُّنْيَا وَهُمْ فِي الْآخِرَةِ عَذَابٌ عَظِيمٌ. إِلَّا الَّذِينَ تَابُوا مِنْ قَبْلِ أَنْ تَقْدُرُوا عَلَيْهِمْ فَأَعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ

“Dënimi i atyre që luftojnë (kundërshtojnë) All-llahun dhe të Dërguarin e Tij dhe bëjnë shkatërrime në tokë, nuk është tjetër vetëmse të mbyten ose të gozhdohen, ose (të gjymtohen), t’u priten duart e këmbët e tyre të anëve të kundërta, ose të dëbohen nga vendi. Kjo (masë ndëshkuese) është poshtërim për ta në dynja, dhe në botën tjetër ata do të kenë dënim të madh.” (5:33).

Kështu kishte vepruar Pejgamberi a.s. me Azijinët, të cilët i kishin plaçkitur devetë e sadakasë, i kishin mbytur barinj të tyre dhe kishin ikur.

Disa dijetarë janë të mendimit se ata ekzekutohen me vdekje nëse këtë e parasheh imami, apo gjymtohen, duke u prerë gjymtyrët e kundërta të trupit, duart e këmbët, apo i dëbon ata nga vendi. Është e drejtë e imamit (prijësit të shtetit) të zgjedhë njërin prej këtyre dënimeve.

E shtata: Dënimi i atij që braktis fenë

Braktisës i fesë është ai që e lë fenë islame dhe kalon në ndonjë fetjetër në Krishterim apo në Hebraizëm. Dënimi i tij është: I jepet afat prej tri ditësh të kthehet në fenë islame; nëse pranon, falet, e nëse jo, atëherë ai ekzekutohet duke iu prerë koka me shpatë. Ky aktgjykim mbështetet me hadithin e Pejgamberit a.s.: *“Nuk lejohet derdhja e gjakut të myslimanit vetëm në tri raste: kur i martuari ka marrëdhënie seksuale jashtëmartesore, mbytja e njeriut dhe ai që e braktis fenë e vet duke u ndarë prej komunitetit.”*

Në raste të ekzekutimit me vdekje, atij personi nuk i falet xhenazja, ai nuk varroset në varrezat e myslimanëve dhe nuk trashëgohet.

Prej atyre ndaj të cilëve zbatohet dënimi me vdekje, janë: magjistari dhe ai që ka braktisur namazin.

Marrë nga revista: Rabitatul Alem El-Islami, nr. 6, Xhumadil Ahire, 1403. Prill 1983

*Përktheu nga arabishtja:
Qemajl Morina*

HISTORI

Nexhat S. Ibrahimi

PREJARDHJA DHE VENDOSJA E PEÇENEGËVE NË TROJET ILIRO-SHQIPTARE E NË BALLKAN DHE ROLI I TYRE NË PËRHAPJEN E ISLAMIT NË KËTO TROJE

Hyrje

Zhvillimi i vrullshëm dhe përhapja e shpejtë në sasi e cilësi e Bashkësisë muslimane (Ummetit) kulmoi me zgjerimin e kufijve të shtetit musliman në të gjitha anët. Prej tyre, shumë popuj e shumë grupe të mëdha prej tyre, të shtrënguar nga dhuna e ushtruar mbi ta nga popujt e tjerë të ndryshëm të asaj kohe, apo nga grupet e popujve të ndryshëm, pra të shtrënguar nga kushtet e vështira të jetës e në kërkim të kushteve më të mira për jetë, si pasojë e luftërave të vazhdueshme e shkatërrimtare, herë-herë të shtrënguar nga mbretërit e ndryshëm u detyruan të migronin, të lëviznin nga një vend në një vend tjetër.

Varësisht nga numri i tyre, varësisht nga shkalla e tyre arsimore e kulturore, popujt apo grupet e popujve në lëvizje e sipër, sillnin me vete besimin, kulturën, mënyrën e jetesës, besëtytnitë, kulturën e

mirësjelljes, të ushqimit, të banimit e të punës, dhe ndikonin ndërsjelltazi tek njëri-tjetri, duke këmbyer vlera të ndryshme me kulturat në fërkim apo në koekzistencë. Me fjalë të tjera, me kalimin e kohës zhvillohej procesi i akulturimit reciprok.¹

Ndër popujt e tillë, që lanë vragë e gjurmë gjatë pjesës më të madhe të mesjetës, krahas kazarëve, kumanëve, bullgarëve, ilirëve - janë edhe peçenegët, historia e të cilëve është fare pak e studiuar dhe tejet e errët.²

Prejardhja e peçenegëve dhe vendlindja e tyre e parë

Nuk e dimë saktë as domethënien e fjalës “peçeneg”, as vendlindjen e tyre të parë. Të dhënat nuk janë të dorës së parë, ndaj disa pohime që pasojnë, duhen pranuar me rezervë. Historiani e filozofi anglez me famë botërore Th. W. Arnold, pohon se “Peçenegët janë shpërngulur nga brigjet e Uralit nga fundi i shekullit IX, për t’u vendosur në tokat që shtriheshin ndërmjet Danubit dhe Donës.”³ Disa pohojnë se peçenegët janë popull me prejardhje turke,⁴ të cilët rreth shekullit

¹ Shih: Barbara Jelavich, Historia e Ballkanit, I, Tiranë, 1999, fq. .

² Megjithë rezultatet në hulumtimin dhe ndriçimin e periudhës së Mesjetës, shumë çështje nga kjo periudhë ende janë të errëta, jo mjaft të hulumtuara dhe të prezantuara në mënyrë jorelevante. Një ndër to është edhe populli peçeneg: prejardhja e peçenegëve, shtrirja gjeografike, aktiviteti i tyre në kontekstin kohor e hapësinor, besimi dhe niveli i tyre kulturor etj. Me këtë punim të shkurtër nuk pretendojmë t’u përgjigjemi të gjitha pyetjeve të mësipërme, sepse ky angazhim do t’i kapërcente mundësitë momentale, por do të përpiqemi që, në bazë të literaturës që disponojmë, çështjen e peçenegëve ta inicojmë për studime e hulumtime më të hollësishme. Një studim i mirëfilltë do të ndihmonte edhe për ndriçimin e raporteve historiko-shoqërore të peçenegëve dhe popujve të tjerë të asaj kohe, si ilirët, bullgarët, pastaj sllavët e të tjerë.

³ Karamasin, vol. I. p. 180-181, cituar sipas: Thomas W. Arnold, “Povijest islama - Historijski tokovi misije”, botimi III, Sarajevo, 1990, fq. 507.

⁴ Maliq Osi, Prizren drevni grad..., Prizren, 1996, fq. 66.

VIII jetuan rreth detit Kaspik, kurse në shekullin IX depërtuan në Detin e Zi.⁵

Udhëpërshkruesi i njohur mesjetar, hebraiku verioafrikan, Ibrahim ibn Ja'kub, i cili më 965 vizitoi Pragën në Çeki, pohon se në vitin 965, fiset e mëdha veriore flasin sllavisht ... me ç'rast përmend edhe badshnakët (dmth. peçenegët).⁶

Udhëpërshkruesi tjetër, Ibn Dasta, në veprën "Libri i thesarit të çmueshëm" në fillim të shekullit X pohon se "ndërmjet vendit të peçenegëve dhe të sllavëve janë dhjetë ditë ecje këmbë."⁷

Sipas Laszlo Razinyo, peçenegët dhe kumanët nga viti 890 deri 1238 kanë jetuar në bashkësi me popullatën e Rumenit; ata njëkohësisht kanë qenë sundues të tyre.⁸

J. G. Herder në veprën e tij "Ide për historinë e njerëzimit" thekson se peçenegët, krahas popujve të tjerë si hazarët, avarët e të tjerë, kanë bërë mjaft në krijimin e Perandorisë Romake të Lindjes, e pjesërisht dhe të Perëndimit,⁹ sigurisht duke menduar në kontributin e tyre ushtarak dhe aleancat e tyre herë lindore, herë perëndimore.

Sipas "Itinerarit" të Benjamin di Tudel në shekullin XII, në Konstantinopolin e atëhershëm tregtonin tregtarët e të gjitha llojeve nga Babilonia, Persia, India, Egjipti, Kanania, Rusia, Hungaria, nga vendi i peçenegëve dhe i kazarëve etj.¹⁰

⁵ Maliq Osi, *Prizren ...*, fq. 66.

⁶ Marko Šunjić, *Hrestomatija izvora za opštu istoriju srednjeg vijeka*, Sarajevë, 1980, fq. 126, fusn. 18.

⁷ Ibid., fq. 125.

⁸ Tuna Kopruleri, fq. 132, 112, sipas: M. Osi, fq. 84.

⁹ J. G. Herder, *Ide për historinë e njerëzimit*, Leipzig, 1868, vëll. III, fq. 90, sipas: Nelson Cabej (ed), *Autoktonia e Shqiptarëve në studimet gjermane*, Prishtinë, 1990, fq. 49.

¹⁰ Shënim nga *Itinerari*, Dokumenti III, në: Marko Šunjić, *Hrestomatija izvora za opštu istoriju srednjeg vijeka*, Sarajevë, 1980, fq. 249.

Kurse Aleks Komneni peçenegët dhe kumanët i konsideron kushërinj.¹¹

Sipas shkencëtarit të madh boshnjak, N. Smailagiq “peçenegët qysh më 560 e.r. i hasim në siujdhesën e Krimesë, bashkë me hazarët dhe kumanët.”¹²

Kronistët e historianët arabë konsiderojnë se peçenegët kanë prejardhje arabe. Udhëpërshkruesi musliman nga Spanja / Andaluzia muslimane, Ebu Hamid El-Garnati, peçenegët i quan “El-Megarib” që d.t.th. “marokenë”.¹³

Vendosja historike e peçenegëve në trojet iliro-shqiptare dhe në Ballkan

Rreth kohës së vendosjes së peçenegëve në Ballkan dhe në trojet iliro-shqiptare, kemi edhe mendime kontraverse. Ky kontraversizëm mendoj se është rezultat i një mostudimi sistematik e konsistent të kësaj problematike, prandaj edhe ka mendime se peçenegët në Ballkan janë paraqitur në shekullin VIII, e disa të tjerë mendojnë se janë paraqitur nga fundi i shekullit IX. Disa të tjerë shkojnë edhe më tutje dhe paraqitjen e peçenegëve e shtyjnë në shekujt e mëvonshëm.

Në mbështetje të provave historike, konsiderojmë se hulumtuesit që paraqitjen e peçenegëve në Ballkan e vënë në shekullin VIII, kanë më shumë të drejtë. Këtë e themi për arsye se formimi i themave filloi nga fundi i shekullit VIII, kurse peçenegët, po ashtu, i hasim në këtë kohë, pikërisht të kufizuar në Jug me Themën e Maqedonisë,

¹¹ Georges Castellan, *Histori e Ballkanit*, Tiranë, (-), fq. 44. Sipas tij, Kumanët janë popull joslav, turk, nomad. Ibid., fq. 14.

¹² Nerkez Smailagić, “*Leksikonislama*”, Sarajevo, 1990, fq. 600.

¹³ Puticestvie Abu Hamid al-Garnati, pub. D. Bol’šahova dhe A. Mongajta, Moskë, 1971, fq. 27, cituar sipas: Rade Božović, “*Arapi u usmenoju narodnoj pesmi na srpskohrvatskom jezickom području*”, Beograd, 1977, fq. 183. (Disertacion doktorate i autorit).

Strumës, në veriperëndim me sllavët, në lindje me Detin e Zi, në veri me hungarezët e Bizantin e të tjera.¹⁴ Të dhënat dëftojnë se peçenegët, por edhe popujt tjerë, pas ardhjes në Bullgari, Maqedoni dhe vende të tjera të Ballkanit, kanë formuar qytetet dhe fshatrat e tyre.¹⁵

Në favor të pohimit se peçenegët u vendosën në Ballkan në shekujt VIII e IX, shkon edhe e dhëna që shtroi G. Ostrogorski, i cili thotë se “Uçët, nën presionin e kumanëve në vitin 1064, sikur më herët peçenegët nën presionin e uçëve, kaluan në Ballkan,¹⁶ që na jep të kuptojmë se ky kalim i peçenegëve do të ketë ndodhur nga fundi i shekullit VIII dhe gjatë shekullit IX.

Historiani e kulturologu - etnologu i njohur boshnjak M. Haxhijahiç, megjithatë paraqitjen e peçenegëve në Ballkan e vë nga gjysma e shekullit XI.¹⁷ Po këtë e pohon edhe M. Spahiq, boshnjak, duke thënë se “paraqitja e muslimanëve – peçenegëve, ismailinjëve dhe agarenjve ndodhi nga mesi i shekullit XI në Ballkan, nga qyteti i bullgarëve në Vollgë, duke popullëzuar Hungarinë dhe Sllavoninë.¹⁸

Disa hulumtues rusë mbajnë qëndrimin se “aradhat e para të peçenegëve janë paraqitur në Hungarinë fqinje në shekullin X”¹⁹. Kjo, po ashtu, vërehet edhe nga fakti se cari bullgar, Simeoni, peçenegët i shfrytëzoi për mbrojtje kundër hungarezëve, po në këtë kohë, në shekullin X.²⁰

¹⁴ Grup autorësh, “*Historia e popullit shqiptar*”, I, botimi III, Prishtinë, 1979, fq. 148-149. Po aty shih kartën III, fq. 148. Krahaso: Miroslav Brandt, “*Srednjovjekovno doba povijesnog razvitka*”, I, Zagreb, 1980, fq. 559.

¹⁵ Shih: Maliq Osi, op. cit., fq. 84.

¹⁶ Georges Ostrogorski, *Historia e Perandorisë Bizantine*, Tiranë, 1997, fq. 241.

¹⁷ Muhamed Hadžijahiç i drugi, “*Islam i muslimani u Bosni i Hercegovini*”, Sarajevo, 1977, fq. 24 - 25.

¹⁸ Mustafa Spahic, *Povijest islama*, vëll. IV, Sarajevë, 2000, fq. 136.

¹⁹ “*Putisestvie Abu Hamid al-Garnati*”, op. cit., fq. 97; Gy. Szekely, “*Les contact entre Hongois et Musulmans aux IX-XII sicles*”, nga libri “*The Muslim East*”, Budapest, 1974, cituar sipas: R. Božović, op. cit., fq. 183.

²⁰ Ibid

Pohimin e mësipërm e ndeshim edhe te G. Ostrogorski, i cili pohon se “Simeoni, i shtrënguar nga Bizanti dhe hungarezët, iu drejtua për ndihmë popullit luftarak nomad të peçenegëve të ultësirës së Ruisë jugore. Me ndihmë të peçenegëve arriti t’i mundte Hungarezët ... korri fitore kundër Bizantit në vitin 896.”²¹

Të dhënat e tjera na dëshmojnë se “nën presionin e hazarëve dhe peçenegëve, hungarezët në vitet gjashtëdhjetë të shekullit IX shkuan edhe më larg drejt Perëndimit.”²²

Peçenegët, sipas hulumtuesve rusë, që në shekullin XI në numër të madh i lëshonin stepet ruse dhe u vendosën në Hungari dhe në Bizant.²³ Sipas disa të dhënave të tjera, krahas peçenegëve, në Ballkan u vendosën edhe muslimanë arabë e bullgarë.²⁴

Gjeografi e shkencëtari musliman nga Spanja, El-Bekriu (shek. XI), na sjell të dhëna me rëndësi kapitale, duke i përshkruar peçenegët në Ballkan si etnitet me rëndësi dhe sjell faktin ku shënohet kalimi i një misioni nëpër Kroaci për në Evropën Lindore, ku gjenden të dhëna se fqinjët e sllavëve - gjermanët, peçenegët e slezianët i njohnin gjuhët sllave.²⁵

Në anën tjetër, shkencëtari Lj. Hauptman thekson se ka sinjale qysh para vitit 948 që dëftojnë për fqinjësinë kroato-peçenege.²⁶

Praninë e peçenegëve e hasim edhe nga të dhëna onomastike, antroponimike e toponimike, kur krahas emrave Andrea Saracenus, Cum-

²¹ G. Ostrogorski, op. cit., fq. 175.

²² Miroslav Brandt, fq. 249.

²³ “*Putisestvie Abu Hamid al-Garnati*”, op. cit., fq. 97; Gy. Szekely, “*Les contact entre Hongois et Musulmans aux IX-XII sicles*”, nga libri “*The Muslim East*”, Budapest, 1974, cituar sipas: R. Božović, op. cit., fq. 183.

²⁴ V. Klaić, *Slike iz slavenske povijesti*, Zagreb, 1903, fq. 497, cituar sipas: Rade Božović, op. cit., fq. 183.

²⁵ Tadeusz, “*Zdrola arabskie do dziegow slowianszczyzny*”, I, Wroclaw - Warszawa - Krakow, 1956, 1969, fq. 121, cituar sipas: R. Božović, op. cit. fq. 183.

²⁶ Lj. Hauptman, “*Seoba Hrvata i Srba*”, *Jugoslovenski istoriski časopis*, III, 1-4, 1937, fq. 35, cituar sipas: R. Božović, op. cit., fq. 183.

anus, Sracino, Sarachinus, hasim edhe emrin Peçenegus nëpër vendet tona, që tregojnë, pos të tjerash, edhe lidhjet me arabët muslimanë.²⁷

Aktiviteti ushtarak dhe lëvizjet e tjera peçenege në trojet iliro-shqiptare në Ballkan

Rrethanat politiko-shoqërore e kulturore-religjioze që nga koha e paraqitjes së popullit peçeneg e deri në fikjen e tyre nga skena historike, ishin në shenjë të lëvizjeve, ngritjeve dhe rënive të shumë popujve e perandorive. Iliria, Bullgaria, Maqedonia, Bizanti, Trakia, Greqia e të tjera nga shekulli VII e deri në shekullin XIII, qoftë ndërmjet vetes, qoftë të atakuara nga sulmet e shpeshta e të furishme të fiseve sllave, avare, bullgare, vllahe, peçenege, oguze, kumane, - u shkretëruan në masë të konsiderueshme.²⁸

Për ta paraqitur më qartë këtë gjendje, do të përpiqemi që peçenegët t'i vendosim në raport të drejtpërdrejtë me popujt kryesorë të asaj kohe, ndonëse një qasje e tillë ka rrezikun e përsëritjes së disa të dhënave.

Peçenegët dhe rusët

Kontaktet dhe lidhjet e para tregtare e ushtarake peçenego-ruse i hasim herët.²⁹ Nuk posedojmë datë të saktë, por historikisht duket se lidhjet e para ndodhën rreth shekullit VIII kur peçenegët jetuan rreth detit Kaspik, kurse në shekullin IX depërtuan rreth Detit të Zi.³⁰ Historiani i njohur kroat M. Brandt, njohës i mesjetës, pohon se në

²⁷ Konstantin Jireček, "Die Romanen in den Staden Dalmatiens des Mittelalters", 1, Teil Wien, 1902, cituar sipas: R. Božović, *op. cit.*, fq. 183.

²⁸ Shih: Skender Rizaj, *Shqiptarët dhe Serbët në Kosovë, Prishtinë, 1991*, fq. 10, 14; G. Ostrogorski, *op. cit.*, fq. 241.

²⁹ Shih: Marko Šunjić, *op. cit.*, fq. 249.

³⁰ Maliq Osi, *op. cit.*, fq. 66.

decenien e gjashtë të shekullit IX Rusia e Kievit ka luftuar me Bizantin, por edhe me peçenegët e me popuj të tjerë,³¹ kurse nga fundi i shekullit IX stepet rusojugore nën pushtetin e tyre mbanin peçenegët, të cilët deri në shekullin XI paraqitnin rrezikun kryesor për rusët e Kievit.³² Nga gjysma e dytë e shekullit IX, në rrethana të pasqaruara, të mjegulluara, e mbase me nxitje të Bizantit, ndodhi sulmi i peçenegëve, që atëherë ishin në stepe ndërmjet Donjecit dhe Bugit jugor, ndaj Kievit. Në këtë luftë peçenegët pësuan humbje.³³ Në këtë periudhë kemi luftëra të vazhdueshme. Kështu, më 867 knezi Askold luftoi kundër peçenegëve që në atë kohë vinin në trojet e Donës dhe Donjecit të mesëm.³⁴ Më 969 Svjatoslavi, që atë kohë luftonte në Bullgari, përkohësisht u kthye që të zmbrapste sulmet peçenege ndaj Kievit.³⁵

Luftërat e ndërsjella peçenego-ruse ishin të shpeshta me suksese relative herë për njërin palë herë për palën tjetër. Më 1019 peçenegët humbin nga Kievi.³⁶ Më 1036 Peçenegët pësuan humbje në muret e Kievit nga princi i Kievit, Jaroslavi i Urtë. Në shenjë të kësaj fitoreje, Rusia ndërtoi Kishën e Shën Sofisë, e në anën tjetër ndihmoi mjaft në zhvillimin e tregtisë së lirë.³⁷

Është me vlerë të theksohet se peçenegët nuk ishin vetëm në armiqësi me rusët, por edhe në aleancë ushtrish apo një pjesë e peçenegëve atëbotë ishte në përbërje të shtetit rus. Kështu, më 943 princi rus, Igor, në ushtrinë e vet kishte rusë e peçenegë.³⁸

³¹ Miroslav Brandt, *Srednjovjekovno doba povijesnog razvitka*, I, Zagreb, 1980, fq. 552.

³² *Ibid.*, fq. 567.

³³ *Ibid.*, fq. 559.

³⁴ *Ibid.*, fq. 552.

³⁵ *Ibid.*, fq. 439.

³⁶ *Ibid.*, fq. 564.

³⁷ *Ibid.*, fq. 566; Maliq Osi, *op. cit.*, fq. 66.

³⁸ G. Ostrogorski, *op. cit.*, fq. 187.

Peçenegët dhe bizantinët:

E theksuam se nga shekulli VII e tutje Perandoria Bizantine ishte e rrezikuar nga disa anë dhe nga disa fise e popuj. Peçenegët janë ndër popujt më aktivë për disa shekuj në Ballkan, që kanë ndikuar në fatin e tij. Fillimisht, luftërat bizantino-peçenege u zhvilluan jashtë Ballkanit, e më vonë ato u zhvilluan edhe në vetë Ballkanin.³⁹ Nga shumë burime lexojmë se Bizanti nga veriu ishte i shtrënguar nga peçenegët, dhe kjo do të vazhdonte për shumë shekuj.⁴⁰ Kështu, gjatë kohës së Teofililit (829 – 842), ndonëse Bizanti ishte forcuar ekonomikisht, bente shpenzime në luftërat në Krime me bullgarët, pastaj në luftërat me peçenegët dhe rusët, të cilët i dëmtonin interesat bizantine, dhe me abasinjtë nga Lindja.⁴¹ Në vitin 969 kemi sulmin peçeneg mbi Bizantin.⁴²

Konfliktet ushtarake bizantino-peçenege vazhduan me intensitet të lartë edhe në shekullin XI. Kështu, më 1064, peçenegët hyn në koalicion me fiset e afërta të uçëve dhe rrezikuan Perandorinë Bizantine.⁴³ Më 1049, 1050 dhe 1051 gjejmë luftime të rrepta bizantino-peçenege, me fat luftarak relativ. Mirëpo, në këtë kohë peçenegët hynin në Maqedoni e Traki, e madje deri në Konstatinopol, pa frikë, sipas Franjo Raçkit “duke plaçkitur e shkretëruar.”⁴⁴ Pra, siç dëftojnë burimet historike, peçenegët janë ndër ata popuj që provuan, por nuk arritën ta pushtonin Konstantinopolin.⁴⁵ Mirëpo, nga viti 1052 peçenegët i gjejmë më pasivë. Kjo nuk i mjaftoi mbretit Konstantin i cili mblo-

³⁹ Skender Rizaj, Shqiptarët dhe Serbët, op. cit., fq. 10 – 14.

⁴⁰ Grup autorësh, Historia e popullit shqiptar, I, botimi III, Prishtinë, 1979, fq. 161 dhe 169.

⁴¹ M. Brandt, op. cit., fq. 337 – 338; Grup autorësh, Historia e popullit shqiptar, I, bot. III, fq. 161 dhe 169.

⁴² G. Ostrogorski, op. cit., fq. 195.

⁴³ G. Ostrogorski, op. cit., fq. 241.

⁴⁴ Franjo Rački, Borba Južnih Slavena, fq. 132 – 133.

⁴⁵ M. Osi, op. cit., fq. 59.

dhi ushtarë nga Lindja e Perëndimi për t'i sulmuar ata. Udhëheqjen e ushtrisë ia besoi patrikut Mihajlo dhe Vasiliut bullgar. Kagani Tyrak kuptoi për përgatitjet e Bizantit dhe filloi të përgatitej, duke zënë pozitë strategjike. Pavarësisht nga sulmet e rrepta dhe rrethimi që ua bënë, peçenegët nuk u dorëzuan. Në të kthyer, ushtria greke u sulmua anash dhe u shpartallua. Vasiliu vdiq, kurse Mihajlo mezi shpëtoi dhe iku. Pas kësaj lufte u lidh paqe trevjeçare.⁴⁶

Sipas të dhënave që ofron P. Thëngjilli, në vitin 1085 ndodhën konflikte të armatosura ndërmjet Bizantit, në një anë dhe normanëve e peçenegëve në anën tjetër.⁴⁷ Pasi e largoi rrezikun nga normanët, Bizanti filloi edhe një luftë kundër peçenegëve, të cilët me vite po i rrinin si shpata e Damokleut mbi qafë. Gjendja u acarua edhe më shumë pasi që hordhitë peçenege kishin gjetur përkrahjen e bogumilëve. Kriza ndërmjet Bizantit dhe peçenegëve arriti kulmin, kur pas luftimeve të shumta, më 1090, peçenegët iu afruan mureve të Konstantinopolit. Po atë kohë, në vitin 1090, me peçenegët lidhën aleancë edhe muslimanët e halifatit islam, të cilët iu afruan Konstantinopolit me flotë nga deti dhe e rrethuan atë.⁴⁸

I shtrënguar nga luftërat e shpeshta me peçenegët, Bizanti, Aleks Komneni, i ftoi dhe i hodhi kumanët në luftë kundër peçenegëve, siç ceket në disa burime, pra, kundër kushërinjve të tyre.⁴⁹ Lufta ndodhi më 29. 04. 1091, dhe sipas G. Ostrogorskit, “Peçenegët u vranë deri tek i fundit.”⁵⁰ Ana Komnena këtë ngjarje e përshkruan në mënyrë dramatike: “Një popull i tërë, që llogaritej me dhjetëra mijëra njerëz, u shua në një ditë të vetme.”⁵¹

⁴⁶ Franjo Rački, *Borba Južnih Slavena*, fq. 133.

⁴⁷ Petrika Thëngjilli, *Historia e Popullit shqiptar* (-), Tiranë, 1999, fq. 82.

⁴⁸ Shih: G. Ostrogorski, *op. cit.*, fq. 256.

⁴⁹ Georges Catelan, *op. cit.*, fq. 44.

⁵⁰ G. Ostrogorski, *op. cit.*, fq. 257.

⁵¹ *Ibid.*, fq. 257.

Pas tri dekadash, më 1122, një mori e re peçenegësh kaluan Danubin dhe u shtrinë në Maqedoni e Traki, duke plaçkitur e shkretëruar ngado që shkelnin. Mirëpo, në luftën e vitit 1122 peçenegët humbën luftën. Ka mendime se pas luftës së vitit 1122 peçenegët nuk ekzistinin si tërësi etnike, po u tretën në fise të tjera mongolo-tatare, duke u shndërruar në robër.⁵²

Siç shënohet në disa burime, kjo luftë ishte e fundit për peçenegët, sepse Jovani II, pasi ngadhënjeu ndaj peçenegëve, robërit i vendosi nëpër provinca si ushtarë.⁵³

Peçenegët dhe hungarezët

Burimet historike shënojnë se në shekullin X e XI peçenegët: pos rusëve e bizantinëve, patën sulmuar edhe hungarezët. Hungarezët nga presioni i tyre u detyruan të iknin drejt Perëndimit dhe të vendoseshin ndërmjet Dnjeprit, Karpateve dhe Danubit të poshtëm,⁵⁴ përkatësisht u vendosën në hapësirat që, pak a shumë, i banojnë edhe sot.⁵⁵

Nga burimet e tjera lexojmë se hungarezët nëpër Karpate ikën drejt Panonisë në vitin 896, sepse u sulmuan dhe humbën luftën kundër Simeonit bullgar, Bizantit por edhe kundër peçenegëve.⁵⁶

Madje, konsiderohet se një kohë peçenegët kanë qenë faktor politik edhe në Hungari, sepse me ta zyrtarisht në Hungari komunikonte edhe Bizanti.⁵⁷

⁵² G. Ostrogorski, op. cit., fq. 267; M. Osi, op. cit., fq. 67 dhe 127.

⁵³ G. Ostrogorski, Istorija Vizantije, Beograd, 1959, fq. 355 – 367.

⁵⁴ M. Brandt, op. cit., fq. 428; G. Ostrogorski, op. cit., fq. 175.

⁵⁵ G. Ostrogorski, op. cit., fq. 175.

⁵⁶ M. Brandt, op. cit., fq. 428; G. Ostrogorski, op. cit., fq. 175.

⁵⁷ J. Ferluga, Vizantijsko carstvo i južnoslovenske države od sredine IX do sredine X veka, Zbornik radova Vizantološkog Instituta, knjiga XIII, Beograd, 1971, fq. 84, cituar sipas: Rade Bozović, op. cit. fq. `83.

Peçenegët dhe bullgarët:

Kontaktet e para peçenego - bullgare në trojet iliro-shqiptare e në Ballkan i hasim qysh në shekullin IX e më pas, varësisht nga sukseset ushtarake të njërës apo të tjetrës palë. Qëndron konstatimi i F. Raçkit se në fatin e Ballkanit rol të rëndësishëm ka luajtur populli peçeneg. Këtë e pamë edhe në raport me popujt e tjerë të asaj kohe, por ngjashëm ishte edhe në raport me bullgarët, herë si palë rivale, e herë si palë aleate. Kështu, bullgarët, për shkak të konflikteve të herëpamërisht me Bizantin, kanë zhvilluar bisedime për paqe me hungarezët, peçenegët dhe me knjazin serb Petar Gojkinoviq⁵⁸.

Themat ballkanike të Bizantit në shekullin XI nuk ishin të qeta, pos të tjerash, edhe për shkak të aktiviteteve peçenego. Një vit pas vdekjes së carit bizantin Vasiliu II, më 1026, peçenegët kaluan Danubin në Bullgari, dhe sipas F. Raçkit, “shumë njerëz, vojvodë e çeta i mbytën dhe i robëruan.”⁵⁹ Arkoni i Sremit Konstantin Diogeni iu kundërvu këtij sulmi dhe vetëm pas disa betejave peçenegët u larguan përtej Danubit. Pas kësaj lufte, peçenegët për disa vjet pushuan nga aktivitetet ushtarake, kurse robërit i kthyen me kompensim.⁶⁰ Por, sërish, më 1032, peçenegët i gjejmë në Bullgari.⁶¹

Edhe gjatë viteve 1048 – 1054 populli bullgar përjetoi shumë tmerr nga peçenegët. Në këtë kohë bullgarët ishin në anën e Bizantit.⁶²

Se çështja e Ballkanit nuk ishte problematike aktualisht, e tregon edhe fakti historik vijues: Tiraku dhe Kegeni ishin princër bullgarë. Për shkak të rivalitetit ekstrem në mes tyre, Kegeni u largua nga Bullgaria dhe hyri në shërbim të carit bizantinas, Konstantini IX. Ky

⁵⁸ M. Brandt. Op. cit., fq. 429.

⁵⁹ Franjo Rački, op. cit., fq. 113.

⁶⁰ Ibid., fq. 114.

⁶¹ Ibid., fq. 114.

⁶² Ibid., fq. 133.

së pari e kryqëzoi Kegenin dhe si kundërshpërblim i dha në administrim dy qytete në bregun e Danubit dhe shumë toka të tjera, por edhe monarkun Evthimi, që t'i kryqëzonte peçenegët që në numër të madh ishin aty. Pas shumë luftimeve që zhvilloi Kegeni me çetat e veta kundër peçenegëve, i theu dhe ngadhënjeu ndaj tyre.⁶³

Peçenegët dhe serbët

Në kohën bizantine peçenegët i hasim si element etnik edhe përgjatë kufirit të atëhershëm serb. Cari bizantinas Aleksije, pasi i mundi ushtarakisht peçenegët, i vendosi në të gjitha rrugët, duke i obliguar me shërbim ushtarak. K. Jireçeku konsideron se toponimet – emrat vendorë të fshatit Peçeneg në Gruzhi dhe Peçenovci tek Leskovci në Serbi, janë dëshmi të pranishme peçenega të asaj kohe.⁶⁴

Në shekullin XIV, në kohën e car Dushanit, peçenegët përmendeshin ende aktivë. Car Dushani vendosi në afërsi të Prizrenit 3000 peçenegë, kurse si dëshmi kemi toponimet – emrat e fshatrave Peçan në Therandë-Suha Rekë dhe peçenoviç në Prizren.⁶⁵ Në Fermanin e Stefan Dushanit lexojmë të dhënë se peçenegu – turku – tatari, me emrin Basaraba, është kryekomandanti i Kara-Tatarëve në betejën e Velbuzhdit, në vitin 1330,⁶⁶ që dëshmon se peçenegët kanë qenë aktivë deri vonë.

Se populli Peçeneg ka luajtur rol me rëndësi edhe në shekullin XIV në Ballkan, tregojnë edhe të dhënat se “gjatë kohës së mbretit Stefanit II (Peçenegët – N. I.) kishin pozita të privileguara në pallat.”⁶⁷

⁶³ Shih: Ibid., fq. 131.

⁶⁴ Konstantin Jireček, Istorija Srba, I, Beograd, fq. 124.

⁶⁵ M. Osi, op. cit., fq. 126.

⁶⁶ Konstantin Jireček, Istorija Srba, I, Beograd, fq. 110.

⁶⁷ Rade Božović, op. cit., fq. 183.

Peçenegët dhe shqiptarët:

Ndonëse peçenegët aktivitetin e tyre ushtarak e kulturor në Ballkan e zhvilluan kryesisht në territoret iliro-shqiptare, ata i hasim fare pak në raporte të drejtpërdrejta. Kjo është pasojë e faktit se shqiptarët me shekuj ishin të pushtuar nga popuj të ndryshëm. Dhe të gjitha marrëveshjet ushtarake, tregtare e kulturore, ndonëse në trojet iliro-shqiptare, lidheshin me pushtuesit e iliro-shqiptarëve e jo me vetë iliro-shqiptarët. Megjithatë, kemi ca fërkime, direkte dhe indirekte.

Shqiptari i parë në hierarkinë bizantine përmendet nga Skilices – Kedronosi, në vitin 1001, në kohën e sundimit arab mbi Kolesirinë. Në këtë dokument shkruhet: “Perandori do të kishte hequr Niqifor Uranasin nga qeverisja e Selanikut dhe do ta zëvendësonte atë me Patricin David Arjanitin.”⁶⁸

Në vitin 1050 përmendet edhe një Arjanit i dytë në fushatë kundër peçenegëve.⁶⁹ Në dokumentet bizantine, kemi edhe një ushtarak shqiptar në rangjet e larta ushtarake bizantine me mbiemrin Komiskarti nga Arbanasi,⁷⁰ që konsiderohet të ketë vepruar kundër peçenegëve.

Duke marrë parasysh shtrirjen gjeografike të peçenegëve dhe të iliro-shqiptarëve, mendojmë se kontaktet e ndërsjella kanë ekzistuar në fushë të religjionit, kulturës, civilizimit, tregtisë, kontakte ushtarako-diplomatike, e jo vetëm në fushën ushtarake, ndonëse këto të fundit janë më të studiuarat dhe në pajtim me këtë realitet edhe më të theksuarat.

Cari bizantinas, më herët i theksuar, Konstantini IX, i shtrënguar nga rreziqet nga të huajt dhe veçanërisht nga turqit, angazhoi 15.000

⁶⁸ *Dokumente të periudhës bizantine për Historinë e Shqipërisë*, Tiranë, 1978, fq. 87, sipas: Irakli Koçollari, *Arvanitët*, Tiranë, 1996, fq. 15.

⁶⁹ Irakli Koçollari, *op. cit.*, fq. 15.

⁷⁰ Kostas Biri, *Arvanitas-i tori tu neoteru elenizmu*, Athina, 1967, sipas: Irakli Koçollari, *op. cit.*, fq. 11.

peçenegë, dhe i armatosi kundër turqve. Mirëpo, peçenegët këtë luftë nuk e shihnin si të veten dhe shfrytëzuan rastin e ikën në drejtim të Prizrenit, në Sredskë, te pjesa tjetër e peçenegëve, më herët të vendosur aty. Të unifikuar e të nxitur nga rreziku që u kanosej, ata kaluan në hakmarrje ndaj sunduesve dhe për një kohë sundonin në gjithë Ballkanin.⁷¹

Të dhënat vijuese argumentojnë edhe më shumë të dhënat e mësipërme. Me urdhrin e vojvodës bullgar Vasile, pas humbjeve të peçenegëve nga Bizanti dhe Bullgaria në shekullin X e XI, peçenegët e mbetur u vendosën në zonat e Sredskës në Prizren, të Nishit dhe të Ovçepoljes në Serbi.⁷²

Faktet e mësipërme do t'i ilustrojmë dhe argumentojmë edhe me disa emra, patronime që rrjedhin nga Mesjeta e re, nga periudha parasllave e sllave në Prizren etj. që i kanë rezistuar kohës, me prejardhje peçenege, kumane e kapçake si: Ballabani dhe Bilibani, Tatarsi, Coplan, Gurban, Kara, Karaba, Kuman, Shishman, Tokman, Caqan, Babun etj.⁷³ Këto fakte tregojnë praninë peçenege në Prizren e Kosovë një kohë të gjatë.

Peçenegët dhe popujt e tjerë:

Prania e peçenegëve në Ballkan e Evropë bëri që ata të ndesheshin si aleatë apo rivalë, si sundues apo të sunduar, me popujt të ndryshëm, pos tyre që cekëm më lart. Kështu, peçenegët i hasim nëpër tërë Ball-

⁷¹ Franjo Rački, op. cit., fq. 131.

⁷² Ibid.

⁷³ M. Osi, op. cit., fq. 86.

kanin Lindor, Sllavoni e Kroaci,⁷⁴ Traki e Maqedoni⁷⁵, Rumani⁷⁶ e madje edhe në Poloni.⁷⁷

Këto raporte mbesin të hulumtohen.

Peçenegët dhe besimi e kultura e tyre islame

Depërtimi i peçenegëve dhe i popujve të tjerë në Ballkan dhe prania e tyre me shekuj të tërë, solli edhe disa ndryshime të caktuara etnike, konkretisht në viset në veri të Nishit të sotëm, në Danub.⁷⁸ Këtë e thekson në njëfarë mënyre edhe K. Jireček.⁷⁹

Udhëpërshkruesit e shekullit XI e XII flasin se ato vise të pasura bujqësore ishin kryesisht të shkreta, ku si të vetmit banorë gjendeshin “cuba të popullit endacak”, duke shtuar se ata “bëhen synet (cirkumizohen).”⁸⁰ Krahas këtyre ndryshimeve të caktuara etnike, ardhja dhe vendosja e peçenegëve në Ballkan dhe Evropë gjatë mesjetës solli ndryshime të caktuara edhe në sferën e religjionit si botëkuptim jete, në sferën e traditave politiko-shoqërore, tregtare etj. Uiliam Tirski shprehimisht pohon se këta janë peçenegët.⁸¹

Historiani, kulturologu e etnologu i njohur boshnjak, M. Haxhijahiç pohon se peçenegët ishin muslimanë, që provohet edhe nga buriemet e tjera. Sipas tij, nga të tjerët, peçenegët, janë quajtur edhe ismailitë, pastaj edhe agarenë.⁸²

Ekzistojnë mendime se peçenegët, duke komprometuar islamin dhe muslimanët e mirëfilltë, në vitin 1048 e 1049 kanë vrrarë e plaç-

⁷⁴ M. Spahić, op. cit., fq. 136; M. Osi, op. cit., fq. 126.

⁷⁵ M. Osi, op. cit., fq. 67.

⁷⁶ M. Barndt, op. cit., fq. 567.

⁷⁷ Ibid., fq. 564.

⁷⁸ M. Hadžijahić, Islam i muslimani..., op. cit., fq. 26.

⁷⁹ K. Jireček, Istorija Srba, II, Beograd, 19__, fq. 154.

⁸⁰ M. Hadžijahić, Islam i muslimani..., op. cit., fq. 26.

⁸¹ Sipas: Ibid., fq. 26.

⁸² Sipas: Ibid., fq. 24–25; M. Spahić, Povijest islama, IV, op. cit., fq. 136.

kitur nëpër tërë Ballkanin Lindor. Udhëpërshkruesit sllavë flasin me plot pezm për peçenegët si “tiranë”, “të paligjshëm” dhe “të pafe”.⁸³

Orientalisti serb Rade Bozhoviç në disertacionin e tij, sikur edhe shumë studiues të tjerë botërorë, pohon: “Peçenegët muslimanë janë bartës të mundshëm të kulturës arabo-islame” në Ballkan”,⁸⁴ që të vazhdojë e të pohojë: “E duke e marrë parasysh arsimimin e tyre të shkëlqyeshëm, që shumë historianë e theksojnë, gjithsesi se kanë qenë bartës adekuatë të kulturës dhe natyrës arabo-islame.”⁸⁵

K. Jirečeku, dhe në mbështetje të tij M. Osi, thekson se me anë të peçenegëve në Ballkan është përhapur herezia e religjioneve të tjera aziatike – maniheizmi, paulicianizmi dhe mesalianizmi, së pari në Thraki e Maqedoni e pastaj në Serbi e më gjerë.⁸⁶ Ndërsa Vikli, kur përshkruan peçenegët dhe jetën e tyre endacake, pohon se “kanë jetuar nëpër tenda dhe kanë sulmuar herë këtë territor e herë atë territor të fqinjëve.” Sipas tij, hordhitë peçenege “derdheshin nëpër krahinat e afërta, duke marrë e shkatërruar çdo gjë që u vinte në dorë.” Më tej pohon se armikun “ose e vrisnin, pa marrë parasysh moshën, ose e robëronin dhe e torturonin,” të rriturit i mbytnin, gratë dhe fëmijët i burgosnin, digjinin dhe shkretëronin.”⁸⁷ Mirëpo, këto pohime duhen shikuar në prizmen e kohës kur kanë jetuar e vepruar me tërë atë që nënkupton mesjeta.

Zhdukja e peçenegëve nga skena historike

A ekzistojnë sot peçenegët? Përgjigjja më e drejtë do të ishte se sot peçenegë nuk ka, por ekzistojnë gjurmët e tyre. Ardhja e Perand-

⁸³ M. Hadžijahić, Islam i muslimani..., op. cit., fq. 24 - 25.

⁸⁴ Rade Bozović, op. cit., fq. 183.

⁸⁵ Ibid., fq. 183.

⁸⁶ K. Jireček, op. cit., II, fq. 254; dhe M. Osi, op. cit., fq. 67.

⁸⁷ Franjo Rački, op. cit., fq. 133.

orisë osmane në Ballkan nuk e gjeti këtë popull si musliman masivisht, madje as gjurmë direkte, të dukshme të tyre, së paku jo sipas arritjeve shkencore të deritashme. Luftërat kundër Bizantit, hungarezëve, bullgarëve, serbëve dhe popujve të tjerë kanë qenë fatale për ta, kështu që peçenegët humbën nga skena historike ballkanike, duke u shfarosur, asimiluar apo duke u shpërnguluar në drejtime të tjera.

K. Jirečeku konsideron se “me ardhjen e Turqisë, pjesa më e madhe e peçenegëve kalon në Islam, e pjesa tjetër në kristianizëm.⁸⁸ Kurse Georges Castellano konsideron se “Gagauzët, pasardhës të peçenegëve, u konvertuan në kristianizëm dhe mund të ndeshen rreth Varnës.”⁸⁹

Të panjohurat, pak të njohurat, por edhe të njohurat për ta, duhet të hulumtohen edhe më tej, historikisht të valorizohen dhe opinionit shkencor dhe atij të përgjithshëm t’i prezantohen në të ardhmen.

Përfundimi

Paraqitja e peçenegëve në Ballkan dhe në trojet iliro-shqiptare për disa shekuj, qoftë si forcë nominuese ushtarake, qoftë si të mundur nga të tjerët, si popull endacak si i quajnë disa nga paragjykimet, solli me vete edhe paraqitjen e Islamit në këto troje, në mënyrë masive, të qëndrueshme dhe, sipas shumicës dërrmuese të fakteve nga fundi i shekullit VIII e mbrapa, herë në ngritje e herë në rënie.

Sipas të dhënave nga burimet bizantine, serbe etj., peçenegët posedonin arsimim e kulturë të lartë islame dhe me të drejtë mund të quhen pishtarë të Islamit në këtë pjesë të Ballkanit dhe në trojet iliro-shqiptare veçanërisht. Këtë konstatim nuk e ulin as insinuatat e vlerë-

⁸⁸ K. Jireček, op. cit.,II, fq. 254.

⁸⁹ Georges Castellano, op. cit., fq. 23.

simet e kundërshtarëve të tyre kristianë e paganë se peçenegët janë “të pafë”, se “cirkumizohen”, se janë shkatërrues e shkretërues.

Aktiviteti ushtarak, por edhe fetar, kulturor e civilizues i peçenegëve duhet shikuar dhe valorizuar në kontekstin e kohës dhe hapësirës kur dhe ku kanë jetuar.

Para shkencës përgjithësisht, kurse para shkencëtarëve shqiptarë veçanërisht, mbetet obligim që çështja peçenenge të bëhet objekt hulumtimi e studimi në një nga projektet kërkimore – hulumtuese tek ne. Për këtë na obligon bashkëjetesa shumëshekullore iliro-shqiptare-peçenenge në këto troje dhe sjellja e Islamit në trojet tona. Njëkohësisht do të ndriçohej e kuptohej drejt prania e Islamit në periudhën paraosmane, por edhe osmane në trojet ballkanike e iliro-shqiptare.

LITERATURA

1. Arnold, Thomas, “Povijest Islama - Historijski tokovi misije”, III izdanje, Sarajevo, 1990.
2. Božović, Rade, “Arapi u usmenoj narodnoj pesmi na srpskohrvatskom jezičkom području”, Beograd, 1977.
3. Brandt, Miroslav, “Srednjovjekovno doba povijesnog razvitka”, I, Zagreb, 1980.
4. Castellano, Georges, Histori e Ballkanit, Tiranë, (-).
5. Çabej, Nelson, Autoktonia e Shqiptarëve në studimet gjermane, Prishtinë, 1990.
6. Grup autorësh, “Historia e popullit shqiptar”, I, botimi III, Prishtinë, 1979.
7. Hadžijahić, Muhamed i drugi, “Islam i muslimani u Bosni i Hercegovini”, Sarajevo, 1977.
8. Ibrahim, Nexhat, Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve, Prishtinë, bot. III, 2000.
9. Ibrahim, Nexhat, Islami në Ballkan në periudhën paraosmane, Prizren, bot. II, 2000.
10. Jelavich, Barbara, Historia e Ballkanit, I, Tiranë, 1999.
11. Jirecek, Konstantin, Istorija Srba, I-II, Beograd, 1952.
12. Koçollari, Irakli, Arvanitët, Tiranë, 1994.
13. Ostrogorski, Georges, Historia e Perandorisë bizantine, Tiranë, 1997.
14. Osi, Maliq, Prizren drevni grad ..., Prizren, 1996.
15. Rizaj, Skender, Shqiptarët dhe Serbët në Kosovë, Prishtinë, 1991.
16. Smailagić, Nerkez, “Leksikon islama”, Sarajevo, 1990.

17. Spahić, Mustafa, Povijest islama, IV, Sarajevo, 2000.
18. Šunjić, Marko, Hrestomatija izvora za opštu historiju srednjeg vijeka, Sarajevo, 1980.
19. Thëngjilli, Petrika, Historia e popullit shqiptar (-), Tiranë, 1999.

Akademik Jashar Rexhepagiq

**FALTORE, INSTITUCIONE DHE QENDRAT ISLAME
NË KOSOVË¹ (XHAMI, TEQE, KUTUBHANE, VAKËFE)**

Hyrje

Xhamitë, teqetë, kutubhanet, vakëfet si institucione dhe faltore kanë përhapur fenë dhe kulturën islame. Duhet shtuar se disa prej tyre njëkohësisht ndikuan në zhvillimin e gjuhës dhe letërsisë turke, shqipe, arabe dhe persiane, si për shembull bibliotekat dhe disa teqe. Këto objekte kanë ndikuar pa dyshim në vetë popullatën, në kulturën e saj, në zhvillimin moral, në zakonet, në arsimin fetar e artistik dhe në aspekte të tjera. Me një fjalë, nuk mund të pranohet mendimi se gjatë disa shekujve nën sundimin osman, në këto treva nuk është bërë asgjë. Kultura është kulturë, si ajo nga Lindja, ashtu edhe ajo nga Perëndimi.

Xhamitë, mesxhidet dhe teqetë janë përmendore fetare dhe në njëjtën kohë ato, si dhe bibliotekat publike, u takojnë objekteve arsimore. Kutubhane (bibliotekat) dhe kiraethane (sallat e leximit) në

¹ Ligjëratë e mbajtur në xhaminë e Mehmet Pashës në Prizren, më 30 prill 1994.

radhë të parë u takojnë institucioneve kulturo-arsimore. Këtë funksion pjesërisht e kanë edhe teqetë.

Në Kosovë kanë ekzistuar dhe institucionet social-humanitare dhe themelata mirëbërëse, si: musafirhanet, imaretet, vakëfet etj. U ndër-tuan edhe objekte shëndetësore-higjienike: shatërvane, çezme, hama-me, pastaj sahat-kulla, ura e të tjera. Këto objekte u kanë shërbyer të gjithëve, pa marrë parasysh cilit komb a fe i takon individi dhe çfarë gjuhe flet ai.

Gjatë disa qindëra vjetësh, që nga shekujt 14/15, këtu kanë jetuar dhe janë ndërruar shumë gjenerata. Secila prej tyre ka lënë pas një pjesë të trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore, e cila në asnjë mënyrë nuk duhet të nënçmohet. Këtu duhet përmendur veçmas pjesëmarrja e mirëbërësve nga radha e sulltanëve, vezirëve, njerëzve të pasur, të arsimuar dhe për mirësi të njohur, pra njerëzve që kanë ndihmuar dhe mbrojtur edhe këtë shkrimtarët, artistët, shkencëtarët e të tjerë.

1. Xhamitë si monumente fetare – kuptimi dhe përhapja e tyre

Xhamia shpjegohet si faltorja më e madhe myslimane, faltore e rendit të parë me një apo disa minare, për shembull xhamia e kaltër e sulltan Ahmetit në Stamboll është me gjashtë minare, ndërsa xhamitë e Kosovës janë zakonisht me një minare ose pa të. Ato të vogla dhe më të shumtën e herës nëse janë pa minare, quhen mesxhide.

Të flasësh për xhaminë, domethënë ta kuptosh drejt funksionin e saj, jo vetëm fetar, po edhe të kaluarën që kishte të ngjajshme me fatin e njeriut, pjesërisht dhe me përhapjen e saj sot. Numri i tyre është i konsiderueshëm. Vetëm në Kosovë ka mbi 480. Për këtë arsye nuk është e mundur t'u bëhet një vështrim i plotë atyre.

Rrjeti i xhamive tek ne është më i volitshëm, në krahasim me Shqipërinë, ku prej 1600 faltoreve (para v. 1941), në vitin 1990 kanë ngelur vetëm 50 xhami.

Termi xhami vjen nga fjala arabe “xhamaa”, “xhami”, që do të thotë faltore, gjë që i tubon njerëzit. Këto faltore kanë historinë e vet. Në këtë pjesë të Ballkanit dallohen disa më të vjetra dhe jashtëzakonisht të bukura, siç janë: xhamia e sulltan Muratit II, në Shkup (1434), xhamia e Ishak-begut e Shkupit (1438), ajo e sulltan Mehmedit II Fatih në Prishtinë (1461), që quhet Xhamia e mbretit, ose Xhamia e madhe, pastaj xhamia e Gazi Isa-begut e Shkupit (1475), xhamia e Gazi Husrevbegut në Sarajevë (1530), allaxha xhami e Foçës (1550), një ndër xhamit më të bukura, e cila si dhe mbi 800 të tjera të BH u zhdukën, xhamia e Mustafa-pashës në Shkup (1492), e cila është më e bukura në Maqedoni, etj. Në Prizren pas pushtimit të qytetit (nga mesi i shek. XV, përmendet viti 1450) është ndërtuar po ashtu një xhami e vjetër (në anën e djathtë të udhës për Gjakovë).

Në vende të ndryshme të botës, po edhe në Kosovë, në ish-Pashallëkun e Beogradit, në Sanxhak, në Bosnjë e Hercegovinë dhe në vendet e tjera, xhamitë u bënë shkolla të para. Pra, ato janë faltore, po njëkohësisht edhe mësonjëtoret e para dhe më të vjetrat islamike dhe qendra të rëndësishme kulturo-arsimore. Sipas autorit Filip Hiti, “shkolla fillore (kuttap) i ishte bashkuar xhamisë, nëse ajo nuk ishte vetë xhami.² Në “Leksikonin e Islamit”³ dëshmohet se “nuk kishte ndryshime parimore midis shkollës dhe xhamisë së zakonshme”. Hulumtuesit theksojnë se në shek. XV dhe XVI, deri nga gjysma e dytë e shekullit XVII, mësimi organizohej në xhami ose në afërsi të saj. (P.sh. në Prizren, Jeni-Pazar, Nish, Beograd, Uzhicë dhe në vende të tjera).

² Filip Hiti, *Istorijska Arapa*, Sarajevë, 1983, fq. 370.

³ Nerkez Smailagic, *Leksikon islama*, Sarajevë, 1990, fq. 150.

Që nga fillimet e para (në fillim të shek. VI) me paraqitjen e Islamit, është ndier nevoja për shkrim-leximin dhe arsimin, së pari e të rriturve, e më vonë edhe e fëmijëve. Objektet e para që shërbenin për arsim, ishin xhamitë dhe shtëpitë e banimit. Më vonë afër xhamive u ndërtuan godina për arsimin fillor, të ashtuquajturit *kuttab* ose *mekteb* (nga fjala arabe “mektab”, do të thotë shkollë, vendi ku shkruajnë, prej *ketebe*, *kitab*, që domethënë: shkruaj. Pati edhe domethënien: “dhomë e punës”, “kabinet” etj. Tek ne e ka kuptimin e shkollës fillore dhe janë quajtur sibjan mektebi (shkollat për fëmijë). Në këtë kohë xhamitë shërbenin për arsimin e mesëm dhe të lartë. Aty nga mbarimi i shekullit X u hapën edhe shkollat e mesme dhe të larta të posaçme, *medresetë* (ar. “medrese”, prej “derese, dersun” (studim, të mësuar) për përgatitjen e teologëve, gjyqtarëve dhe mësuesve të besimit. Pra, historikisht vija e këtyre institucioneve ishte kjo:

1. xhamitë, ku zhvillohej mësimi,
2. mektebet afër xhamive, mandej edhe në pjesë të tjera të qytetit,
3. paraqitja e medreseve të para.

Përmenden selxhukët nga mbarimi i shek. X, ndikimi i tyre në arsim dhe hapja e medresesë së parë në Nishapur, në gjysmën e parë të shekullit XI.

Shembujt konkretë do të na bindin për funksionin shkollor të xhamive të para tek ne. Kështu vakëfnama e Kukli-beut nga viti 1538, i cili n’at kohë kishte 117 dyqane, 6 mullinj dhe një karvan-saraj, dëshmon për xhamitë në gjysmën e parë të shekullit XVI në Prizren që ishin, njëkohësisht shkolla për fëmijë myslimanë, me mësimin në gjuhën turke.⁴

Nga mesi i shekullit XVI në Prizren Mehmed-pasha ndërtoi një ndër xhamitë më të bukura në këto treva, dhe afër saj themeloi edhe

⁴ Kosova dikur e sot, monografi, Beograd, 1973, fq. 992.

medresenë e parë, e cila kishte kuadro solide dhe dallohej nga përmbajtja dhe niveli i arsimit. Dhe vakëfnama e Suzit e vitit 1513 na tregon se shkollat e para (mektebet dhe medresetë) janë krijuar në xhamitë e porsa ndërtuara ose në afërsinë e tyre, e më vonë edhe në ndonjë mëhallë dhe në pjesë të tjera të qytetit.

Veprimtarinë shkollore të xhamive e ilustrjnë edhe dokumente të tjera, p.sh. në Mitrovicë, ose në Jeni-Pazar, ku deri në gjysmën e dytë të shek. XVII zakonisht kishte aq mektebe, sa kishte edhe xhami.

Dhe në Beograd “çdo xhami kishte edhe mektebin e vet”⁵. Evlija Çelebi përmend se në vitin 1660 në Beograd – qytet me 100.000 banorë, (nga të cilët 75% të fesë islame), kishte 270 xhami, po aq edhe mektebe. Beogradi atëherë kishte 8 medrese, 17 teqe dhe 9 qendra për studimin e Hadithit. Hadithi ishte në të njëjtën nivel me Kur’anin.

Mund të përfundohet se pak a shumë, në çdo mjedis mysliman numrit të xhamive për afërsisht i përgjigjej numri i mektebeve, sado që në disa shekuj më vonë kanë ekzistuar ndryshime gjithnjë më të mëdha.

Në çdo qytet të Kosovës, po ashtu edhe në vendet më të vogla, dhe në shumë fshatra, është ruajtur një numër i madh i xhamive të vjetra dhe janë ndërtuar godina të reja. Të shënojmë së paku disa xhami që dallohen sipas vjetërsisë, sipas arkitekturës, bukurisë etj.

Në Gjakovë dallohet *xhamia e Hadumit*, që u ndërtua në dekadën e fundit të shekullit XVI (në vitin 1594/95). Donatori i saj, i cili ka lënë një pasuri me testament, ka qenë *Hadum Sulejman-aga Bizaban*, shërbëtor në oborrin e sulltan Muratit të III. Në qytet prej monumenteve fetare dallohet dhe *teqeja e sheh Eminit*, e shekullit të kaluar, e cila është ekzemplar i rrallë i arkitekturës islame.

⁵ Divna Djuric – Zamolo, Beograd kao orijentalna varos pod Turcima 1521-1867, Beograd, 1977, fq. 109.

Në Gjilan prej objekteve më të vjetra të kulturës islame më me rëndësi është *Xhamia e vjetër me shatërvan*, e ndërtuar më 1772. Këtu është ruajtur edhe *teqeja*, që u themelua nga vitet tetëdhjetë të shekullit XIX, e cila i takon tarikatit dervish “Sadi”.

Në Kaçanik në fund të shek. XVI u themelua *xhamia e Sinan-pashës*, më saktë, në vitet 1594-1595, që dëshmohet nga mbishkrimi në derë. Është një godinë e bukur në pikëpamje të arkitekturës dhe një objekt mjaft i ruajtur. Këtë e themeloi Rexha Sinan-pasha, veziri i madh i pasur, me orgjinë shqiptare. Në mbishkrimin e xhamisë Valihi, poet nga Shqipëria, thotë: “Tempulli i bukur, vendi i lëvdëruar”.

Në Rahovec janë ndërtuar katër xhami, po edhe sahat-kulla dhe 4 teqe. Sidomos dallohen *teqeja e halvetinjve*, më e moçme se 390 vjet, dhe ajo e *melaminjve*, nga shekulli i kaluar, dhe *shkolla në gjuhën shqipe*, pranë kësaj teqeje.

Në Pejë dallohet *Bajrakli (Çarshi) xhamia*, nga gjysma e dytë e shek. XV. Ky monument është një ndër më të vjetrit që ndërtoi sulltan Mehmedi II Fatih. Është i njohur dhe *hamami i vjetër i Pejës*, nga shek. XVI, i cili është i ngjashëm me hamamin e Mehmed-pashës në Prizren. Në Pejë dallohen edhe disa ndërtesa të bukura, sidomos *kona-ku i Tahir-beut*, nga shekulli XVIII, dhe *kulla e Jashar-pashës*, e cila u ngrit në fund të shekullit të kaluar. Në afërsi të hamamit është vendosur *Hamam-xhamia* e vjetër, e cila ka një mbishkrim sipër portës kryesore, ku është kjo fjali: “*Sa e bukur je!*”

Në Pejë është një numër i madh xhamish. Ndër këto është edhe *Kurshumli xhamia*, e cila ka qenë e mbuluar me plumb. Në qytet ka edhe një varg teqesh dhe tyrbesh. Shumica e tyre është e periudhës së re.

Në Prishtinë është e njohur sidomos *Xhamia e mbretit* (Fatih), një ndër xhamitë më të vjetra, (viti 1461). Sulltan Mehmedi II Fatih e ngriti këtë xhami vetëm tetë vjet pas pushtimit të Stambollit. Xhamia

e mbretit është një ndër më të bukurat të arkitekturës islame të shekullit XV. Godina e saj është me proporcione harmonike me kube të lartësisë prej 13,5 metrash dhe me minare të hedhur. Para kësaj xhamie sulltan Bajaziti, menjëherë pas luftës së Kosovës, urdhëroi – për nder të fitores – të ndërtohej *çarshi xhamia*, në Prishtinë. Sipas një shpjegimi ky objekt “është kryer në kohën e Muratit II (1404-1451).”

Në Prishtinë janë edhe 11 xhami dhe dy hamame: *hamami i madh* me shatërvan i ndërtuar para Xhamisë së mbretit, në fillim të shekullit XV. Hamami ka 15 kube që janë të ruajtura. Aty është edhe *hamami i vogël*, ndërsa në ballë të Xhamisë së mbretit në fund të shekullit XIX u ndërtua *Sahat-kulla*, e lartë 15 metra.

Prej monumenteve fetare padyshim më i moçmi është *tyrbja e Muratit*, e ngritur mbi fshatin Mazgit, aty ku e humbi jetën sulltan Murati I (menjëherë pas betejës së Kosovës në vitin 1389). Tyrben e ndërtoi sulltan Bajaziti, i biri i Muratit.

Ekzistojnë edhe mbeturinat e një *xhamie të vjetër*, që e përmend poeti Suzi Çelebi, në vakëfnamen e tij (1513). Ajo do të jetë xhamia e parë e gjysmës së dytë të shek. XV.

Në vitin 1549 u ngrit *xhamia e Gazi mehmed-Pashës* në Prizren, e cila është e njohur si *Bajrakli xhami*. Afër xhamisë Mehmed-pasha themeloi *medresenë*, ndërtoi *tyrben* dhe *bibliotekën*, dhe një *hamam*. Në territorin e ish-Jugosllavisë dallohen tre hamame të mëdha: hamami i Daut-pashës, në Shkup, i Husrevbegut në Sarajevë dhe hamami i Gazi Mehmed-pashës në Prizren.

Në vakëfnamen e përmendur të Kukli-begut (1538) përmendet se ai këtu ndërtoi *dy xhami* dhe një *karvan-saraj*.

Më 1615 u ngrit monumenti i ri fetar, i madh - *xhamia e Sinan-pashës*, gjithsesi një nga monumentet më të bukura të arkitekturës islame në Kosovë. Ndërtuesi i saj ishte Sofi Sinan-pasha, me origjinë shqiptar, i lindur në Lumë (katundi Vilë). Disa burime dëshmojnë se

në Prizren ka ekzistuar edhe medreseja e Sinan-pashës.⁶ Në këtë kohë Prizreni ishte ndër qytetet më të mëdha të Ballkanit. Në xhami ekzistonte muzeumi i dorëshkrimeve orientale. Po ashtu në Kalanë e vjetër të Prizrenit, gjatë sundimit të Mehmed-pashës Rotull, u ndërtua një *xhami* dhe *Sahat-kulla* me kabanë të bukur nga Smedereva,

Në anën e majtë të Bisticës, poeti i njohur dhe historiani *Suzi nga Prizreni* (vdiq më 1524) ndërtoi *mesxhidin*, i cili më vonë u shndërrua në xhami. Në vitin 1513 ai këtu themeloi edhe *bibliotekën* e vet.

Më e njohura ka qenë *biblioteka e Gazi Mehmed-pashës*, në oborrin e xhamisë së tij. Biblioteka ka mbi dy mijë libra të botuara dhe dorëshkrime (teologjike, filozofike, të matematikës, gjeometrisë, historisë, astronomisë, mjekësisë dhe të disiplinave të tjera shkencore). Sipas një shënimi, Sinan-pasha në vitin 1588 i dha bibliotekës një Kur'an në persisht. Aty është edhe një vepër "El-kanunu Fittibbi" (Kanuni i mjekësisë), nga mjeku, filozofi dhe poeti persian *Ibn Sina* (Avicena). Ka edhe dorëshkrime të tjera të vlefshme.

Në fund të shekullit XIX Prizreni kishte 23 xhami, 8 teqe, dy hamame, 13 hane, një bibliotekë me afro 1000 libra, 15 tyrbe, po ashtu 563 dyqane, 125 mullinj dhe më se 150 çezme.⁷

Prej vendeve të tjera, në Mitrovicë, përveç disa xhamive, është ruajtur *hamami i vjetër*, i ndërtuar me gurë. Në kohën e udhëheqësit ushtarak Gazi Isa-beg, këtu janë ngritur *xhamia*, *sahat-kulla*, *medreseja* dhe *hani*. Më vonë u ndërtuan: *xhamia qelep-verdi*, një *mesxhid* dhe një *ruzhdie* (gjimnaz i ultë).

Të përmendim edhe Vushtrrinë, ku ekziston *Çarshi xhamia*, aty ku më parë ishte xhamia e vjetër nga periudha e sulltan Muratit II. Pas

⁶ Dr. Hasan Kaleshi, Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku, Pristina, 1972, fq. 327.

⁷ Shënimet janë marrë nga Salnama e Vilajetit të Kosovës, e vititi 1892).

vitit 1444 u formuan edhe dy xhami: e *Gazi Ali-begut* dhe ajo e *Karman Ogullarit*. Edhe në Vushtrri është ruajtur *hamami i vjetër*.

Prej xhamive nëpër fshatra, dallohet *xhamia e Hasan-agës në Rogovë*, e cila që nga themelimi deri më sot, pati disa ndryshime. Ajo u bë faltore tipike fshatare me teknikën e thjeshtë, e ndërtuar më 1580. Në mbishkrimin e saj thuhet se në Rogovë, vend që i ngjet Xhennetit, Hasan-aga ndërtoi një godinë për falje, ndërsa poeti Valihi (Ahmed Çelebi), nga Shkupi, shtoi disa vargje, dhe për këtë (xhami) thotë se është “Qabeja e dytë”⁸

2. Teqetë si objekte të tarikateve të dervishëve

Monumenteve fetare u takojnë edhe teqetë si objekte të dervishëve. Këto objekte, në krahasim me xhamitë dhe me mektebet e medresetë e para, janë të kohës më të re, disa nga shekulli 12. (p.sh. Kaderie, Rufaia), disa të shek. 13 (Mevlevije-Kalendarie), disa në shek. 14 (Bektashitë, Halveti, Nakshibendie) etj.

Më parë teqetë kanë qenë “vatrat e arsimit, ndërsa shehlerët e tyre filozofë dhe dijetarë”.⁹ Psa një kohe janë transformuar në institucione për kryerjen e ceremonive fetare të dervishëve, në suaza të parimeve islame.

Dervishët (per. “dervish” ka domethënie themelore: njeri i varfër) janë pjesëtarët e ndonjë rendi, sekti apo tarikati (Fjala tarikat vjen prej termit arab “tarikë” dhe domethënë rrugë, drejtim). Shpjegimi i dytë është “njeri modest, i tërhequr dhe besimtar”.¹⁰ Njeri që gjatë shekujve është munduar të gjej shpëtim në vetmi dhe persiatje të mundshme.

⁸ Andrej Andrejevic, *Islamska monumentalna umetnost XVI veka u Jugoslaviji*, Beograd, 1984, fq. 42-43.

⁹ Glasnik VIS, Sarajevo, 1950, fq. 249.

¹⁰ A. Skaljac, *Turcizmi u srpskohrvatskog jeziku*, Sarajevo, 1985, fq. 214.

Dervishët janë mbrojtës të drejtimit religjioz-filozofik të misticizmit islam. Më së shumti kanë ndikuar në Maqedoni dhe në Kosovë. Në Kosovë rendet dervisha dhe vetvetiu disa teqe, në bazë të disa burimeve, u paraqitën të parën herë nga fundi i shek. XV dhe në fillim të shek. XVI, por asnjëra prej tyre nuk është ruajtur.

Në teqe ose *zavije* (ar. tekstualisht: këndi i ndonjë ndërtese për dervishët). Ndonjëherë kështu është quajtur ndërtesa për mësimin fetar. Nganjëherë *zavija* (ishte sinonim për teqe) mblidheshin anëtarët e ndonjë sekti të caktuar të dervishëve, për të mësuar leximin dhe shkrimin (p.sh. halvetinjët dhe bektashinjët), ose mësonin këngë religjioze (ilahije) përmendsh. Ato i këndonin së bashku. Disa nga këto sekte, si rendi dervish mevlevije, merreshin me shpjegimin e veprave nga mistika. po ashtu në disa teqe kopjonin libra të ndryshëm, e disa individë, hartonin vargje dhe vepra në prozë me karakter letrar dhe filozofik, teologjik e pedagogjik.

Dervishët më të ngritur, si në *teqenë e Melaminjve në Rahovec*, shehu *Hilmi Maliqi*, i cili këtu e hapi shkollën, kanë shkruar edhe vepra në gjuhën shqipe, duke përdorur alfabetin arab. Sheh Mala mësoi për 12 vjet medresenë e Mehmed-pashës në Prizren, dhe ishte një ndër nxënësit më të talentuar. Ai më vonë në Rahovec punoi si arsimues dhe si besimtar (vdiq më 1928). Sidomos dallohen “Divani” i tij, (përmbledhje vjershash në gjuhën shqipe me germa arabe), mandej përkthimet e tij e të tjera.

Teqenë Halvetie të Prizrenit, e cila vepron nga shekulli XVII, e themeloi *Rexhep-efendiu*, sheh dhe mësues. Teqeja qendrore e Halvetijve ekzistonte në *Uzhicë*. Në të vepronte sheh *Muslihudin Uzhiçel*, shkencëtar i njohur në Botën Islame (vdiq më 1642). Tarikati i Halvetinjve çmonte shumë veprën e njohur “Mesnevi” të klasikut persian, Xhelaludin Rumi.

Teqenë qendrore Halvetije (*degën Karabashije*), e hapi në Prizren, në vitin 1699/1700 sheh *Osman baba*, nga Serezi. Me degën e Prizrenit kanë qenë të lidhur teqetë në *Gjakovë, Rahovec* dhe *Mitrovicë*, dy teqe të *Shkupit*, një në *Veles*, dhe në Shqipëri: në *Tiranë, Elbasan* dhe *Shkodër*.

Ekzistonte edhe një degë e Halvetinjve: *dy teqe sinanije*, në Prizren. Njërën në vitin 1589/90 e themeloi Musa-efendiu, dhe të dytën në vitin 1706/1707 e themeloi *Ali bin Rexhep-aga Koro*.

Në teqenë e Prizrenit vepronte edhe poeti i madh, prizrenas, autori i punimeve në prozë, dijetari dhe krijuesi kulturor *Ymer Lutvi Paçarizi*, të cilin e çmonin si “një ndër myslimanët më të ngritur”. Ai ishte shumë përparimtar, për të “mëmëdheu ishte tërë bota”. Ishte njohës i arabishtes, persishtes dhe i turqishtes dhe është marrë me përkthime të veprave filozofike, sidomos nga arabishtja e persishtja. Vepra e tij voluminoze (disa libra dorëshkrim) dhe për disa lëmë (për shkencën, kulturën, gjuhën, teologjinë, filozofinë etj.) me rëndësi të madhe, ende nuk është botuar e as interpretuar në mënyrë të gjithanshme.

Nga tarikatet e dervishëve, sipas themeluesve të tyre, janë të njohur: *Kaderie, Halvetie, Bektashie, Mevlevie, Rrufaie, (Sadie)* etj. Ai që bëhet anëtar i ndonjërit nga 12 tarikateve, quhet dervish. Disa nga këto tarikate kanë ndikuar më shumë në Kosovë.

Tarikati i halvetinjve i kishte teqetë në Prizren, Gjakovë, Rahovec, Gjilan e në disa fshatra të tij, dhe në Pejë, themeluar mjaft vonë (më 1935).

Teqeja e Kaderinjve ekzistonte në *Prizren* (1655), *Gjakovë* (nga fundi i shekullit XVII ose fillimi i shekullit XVIII), *Prishtinë* (1903) dhe *Pejë* (1907).

Teqeja e bektashinjve në Kosovë u përhap në disa qytete: në Gjakovë, Mitrovicë, Kaçanik dhe në Maqedoni: Shkup, Tetovë, Shtip, Veles dhe Strumicë.

Teqetë kanë rol *historik, kulturor dhe rëndësi arsimore*, e shpesh edhe *karakter humanitar*. Teqetë më të mëdha, përpos lokaleve të përbashkëta për organizimin e ceremonive (simahana), kishin dhoma të veçanta për shehun e dervishët. Kishin edhe *tyrbe* dhe *musafirhanen* (dhomat për udhëtarë që merrnin ushqim dhe fjetje pa pagesë). Sipas *Halil Inalxhikut*¹¹ zavija ishte themelatë bamirëse, për strehimin e udhëtarëve në qytete ose, më shpesh, buzë rrugëve të gjata dhe larg vendbanimeve, të cilat (zavijet) i themelonin shehlerët ose dervishët. Në fillim të periudhës osmane zavijet kanë luajtur rol vendimtar në kolonizimin e banorëve gjatë kufijve dhe në krahinat që kishin zaptuar osmanlinjtë. Dervishët vinin nga Anadulli në treva porsa të pushtuara, zgjidhnin një pjesë toke dhe aty organizonin teqe.¹²

Përveç anëve të shumta pozitive, teqetë ose zavijet kanë edhe do njëanshmëri dhe teprime, si ato rituale. Në të kaluarën p.sh., bukur shumë teqe kultivonin dhe përhapnin besëtytni të ndryshme, sidomos misticizmin. Qeveria turke në kohën më të re persekutoi sekte dervishës dhe në vitin 1925 ato u shpërndanë.

Shumë teqe kanë pasur edhe biblioteka të veta. Është dalluar në këtë pikëpamje tarikati *Mevlevije*, i cili gëzonte respekt të madh. Themeluesi i tij ishte poeti më i njohur mistik persian, *Mevlana Xhelaludin Rumi* (shek. XIII). Ndikimi i këtij tarikati dhe i vetë Rumiut është ndier në Kosovë, sidomos në Bosnjë e Hercegovinë. Në Kosovë ai ndikoi nëpërmjet teqesë së Melaminjve, e pjesërisht edhe të tjerave.

Teqeja më e madhe është teqeja e *Sersen Ali-babës në Tetovë*, e cila ka shumë godina.

Në Kosovë janë të njohur, pos teqesë së melaminjve të Rahovecit, *teqeja e madhe* dhe kryesore të saadinjve, degës të Rufaive, në *Gjakovë*, mandej *teqeja e sheh Emin* dhe ajo e *bektashinjve*, po ashtu në

¹¹ Osmansko carstvo, klasicno doba 1300-16 Beograd, 1974

¹² Po aty, fq. 211-212.

Gjakovë, të dyja nga shekulli i kaluar, pastaj *teqeja e rendit dervish të Saadinjve në Gjilan që nga vitet 80-ta, teqeja halvetije e Rahovecit*, e cila është e vjetër mbi 390 vjet, disa *teqe në Pejë, në Mitrovicë* e gjetiu. Disa teqe kanë organizuar ceremoni të veta edhe në shtëpi private, si p.sh. rendi dervish të *Rufaive të Gjilanit* etj.

Në mesin e shqiptarëve në Kosovë, po edhe në Shqipëri, sidomos në Frashër, Elbasan, Berat etj, ndikim të madh patën *bektashinjtë*. Ata, si çështjet konfesionale, ashtu edhe ato laike, i shqyrtonin në lidhje me gjendjen reale në ambientin konkret dhe në mënyrë origjinale. Padyshim *tarikati i bektashinjve këtu ndikoi më së shumti*. Arsyeja është se ky rend ka qenë i përshtatshëm për të gjithë dhe me një tolerancë më të madhe, kështu që ndikoi edhe në zhvillimin e ideve kulturore dhe në literaturën në gjuhën shqipe. Le të na kujtohet se edhe poeti, pedagogu dhe filozofi shqiptar, *Naim Frashëri* (veproi në gjysmën e dytë të shek. XIX, vdiq më 1900), është edukuar dhe ka vjersha në frymën e bektashinjve dhe nën ndikimin e poezisë persiane. Në vendlindjen e tij (Frashër) përmenden disa shkrimtarë të këtij rendi. Dallohet *Nasib Tahir babai*, i cili në Frashër themeloi teqenë e madhe, shkroi gazelet (vjershat lirike) në gjuhën turke e persiane dhe njëkohësisht popullarizoi bektashinjtë. Edhe *Haxhi Ali Haqi Babai* (i lindur në Elbasan më 1827) përhapi bektashizmin në Gjirokastër (ku ngriti teqenë), në Delvinë, Kurvelesh, Permet etj.

Në *Gjakovë* dalloheshin disa bektashinjë: *Adem Vexhhi babai* (i lindur më 1841), njohës i arabishtes, persishtes dhe turqishtes, *Baba Hamzai*, autor i vjershave në gjuhën turke e persiane, *sheh Baba Qazim Bakalli*, i cili disa vjet ishte mësues në Gjakovë.

Prizreni në vitet tetëdhjetë të shekullit XIX kishte 8 teqe, qyteza e Rahovecit – 4 teqe (rufainjtë, halvetinjtë, kaderinjtë dhe të melaminjve). Këto ekzistojnë edhe sot. Ndër teqetë më të bukura të Prizrenit veçohet *teqeja në Marash*, buzë Bistricës. Afër saj gjendej *tyrbja e*

Sylejman-efendisë. Sheh Sylejman-efendiu në fillim të shekullit XVIII, edhe në Gjakovë ndërtoi një teqe të madhe. Në Prizren Sylejman-efendiu, i njohur me emër letrar *Axhize Baba*, është marrë me poezi dhe prozë. Ka shkruar divane dhe një vepër të njohur mbi moralin. Me origjinë është nga Shkodra. Vdiq në Prizren më 1738. Gjatë jetës Axhize Baba (axhiz domethënë “i pafuqishëm”, “modest”, “i tërhequr”) përhapi të mësuarit e tarikatit dervish saadije, dhe është themelues i këtij rendi, i cili është dega e rufainjve. Në Prizren është e përmendur edhe teqeja e rendit halvetije të sheh Hasanit, e ndërtuar në qendrën e Prizrenit, në shekullin XVII.

Në Kosovë, përveç degës së saadijve, ndikoi edhe dega tjetër, ajo e rufainjve: *Sajaditë*, si p.sh. në *Gjakovë*, teqene e themeloi sheh Musa në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Për teqenë e Gjakovës ishin të lidhura filialet e teqeve në Prizren, Pejë, Mitrovicë, Rahovec etj. Këto teqe u themeluan në fund të shek. XIX.

Rëndësia kulturo-historike e teqeve është, sepse këto qendra kanë përhapur kulturën islame-orientale.

Për teqetë dhe rendet e dervishëve kanë shkruar Džemal Čehajić (Derviški redovi u jugoslovenskim zemljama, Sarajevo, 1986), *Kadri Halimi*¹³ Hasan Kaleš e tjerë.

3. Kutubhane

Termi kutubhana është me origjinë arabe persiane (ar. kutub, kitab, domethën: librat, libër, dhe pers. “hana” – shtëpi, ndërtesë) që do të thotë “bibliotekë”. Dikur ato së bashku me shkollat islame, kanë qenë fidanishte të shkencës dhe të artit. Këtë e ilustron numri i

¹³ Derviški redovi i njihova kultna mesta na Kosovu i Metohiji, “Glasnik Muzeja Kosova i Metohije”, Prishtina, 1954.

veprave në bibliotekat publike. Kështu, për shembull, biblioteka e Bagdadit kishte 400.000 vepra dhe ajo e Kordovës 600.000.

Tek ne u hapën në kohën e sundimit osman. Në disa vende afër kutubhaneve, në lokale të veçanta, që nga gjysma e dytë e shekullit XIX, u themeluan edhe *sallat e leximit*, që quheshin *kiraethane* (ar. “qiraa” – të lexuar, dhe pers. “hana” – shtëpi). Në këto institucione kishte ndonjë libër didaktik (instruktiv) dhe gazeta.

Kutubhanet si institucione kanë ndikuar shumë në zhvillimin kulturor dhe në ngritjen arsimore të popullatës myslimane të këtyre rajoneve. Zakonisht kutubhania ishte pranë medresesë, xhamisë a teqesë dhe në disa familje të pasura dhe të arsimuara. Ato institucione posedonin libra dhe dorëshkrime.

Biblioteka orientale e parë, e madhe dhe më e vjetra tek ne u themelua në Shkup në vitin 1445, pranë medresesë së Ishak-beut. Mbi njëzet vjet më vonë (1469) edhe Gazi Isa-beu themeloi në Shkup, pranë medresesë së vet, bibliotekën me 230 libra nga fusha të ndryshme shkencore. Biblioteka e Isa-beut, sipas Glisha Elezoviçit, ishte një ndër më të mëdhatë të shek. XV në trevat tona.¹⁴ Shumë të vjetra janë edhe bibliotekat, si ajo e Manastirit të Sarajevës, e Prizrenit dhe e Mostarit.

Biblioteka e Prizrenit u themelua pranë xhamisë së Mehmed pashës, në vitin 1537, dhe ekziston edhe sot. Posedon një fond prej 2.000 ekzemplarësh të librave dhe afërsisht 200 dorëshkrime orientale. Për ato dorëshkrime shkroi veçanërisht Mehmed Mujezinovic¹⁵. Përpos të tjerave këtu gjendet Kanuni mjekësor nga Ibn Sinai, një koment i “Gulistanit” të Sadiut dhe vepra të tjera të rralla. Këtu janë veprat e disa myderrizëve të medresesë së Mehmed-pashës, si p.sh. biblioteka

¹⁴ Elezovic, Turski spomenici u Skoplju, Glasnik SND, I, sv. 1, Skoplje, 1925, fq. 168.

¹⁵ Kolekcija orijentalnih rukopisa biblioteke Mehmed-pašine džamije u Prizrenu, Priština, Starine Kosova i Metohije, II-III, 1963.

e vlershme që e dha hafiz Abdullah ef. Hizra, myderrizi i fundit i kësaj medreseje. Në vitin 1733, në *Gjakovë*, u hap një bibliotekë buzë xhamisë së Hadumit.

Në Pejë u themelua biblioteka e Atik medresesë. Zakonisht këto objekte janë ndërtuar prej guri, ose prej guri e tulle dhe janë të mbuluara me qeramika. Biblioteka të këtij lloji kishte edhe në vende të tjera. Në Nish, për shembull, valiu Midhat pasha, në fillim të viteve gjashtëdhjetë të shekullit XIX themeloi bibliotekën myslimane në Burmal xhami. Kjo bibliotekë punoi gjer më 1877.

Sot në bibliotekën e Medresesë së mesme “Alauddin” të Prishtinës, e cila ekziston që nga vitit 1952, gjenden dorëshkrime të llojllojshme, sidomos nga disiplina të ndryshme teologjike, ato dorëshkrime më përpara kanë qenë pranë bibliotekës së Kryesisë së Bashkësisë Islame, në Prishtinë.

Kutubhanet u shërbenin nxënësve të medreseve dhe nga gjysma e dytë e shek. XIX edhe të shkollave shtetërore, siç ishin ruzhdijet (gjimnazet e ulëta), idadijet (gjimnazet) etj. U shërbenin edhe qytetarëve të shkolluar, sidomos personave që merreshin me shkencë, arsim dhe kulturë. Njerëzit e arsimuar lexonin vepra në arabisht, turqisht dhe persisht, e më vonë dhe libra në gjuhën shqipe dhe në ndonjë gjuhë tjetër të Ballkanit. Nga fakti se tek ne kishte një numër të madh shkrihtarësh (veçanërisht në qytete) të cilët shkruanin në ndonjë gjuhë orientale, del përfundimi se kishte edhe njerëz që i lexonin ato vepra.

Rolin e bibliotekave islame e dëshmojnë autorë të ndryshëm, ndër ata dhe mendimtari kroat Eduart Kalle, në veprën e tij mbi historinë e civilizimit¹⁶.

¹⁶ Kale, Povijest civilizacija, Zagreb, 1988.

4. Vakëfi dhe rëndësia e tij

Shpjegimi i shkurtër i termit vakëf (ar. “Wakf” ka kuptim themelor: ndal, të ndalur, mbaj), do të ishte “pasuria ose pronë fetare dhe e patundshme”, ose shkurtazi institucion bamirës për qëllime të përgjithshme fetare, sociale dhe humane. Prona të patundshme, sipas Sheriatit janë: shtëpitë, banjat, karvan-sarajet, mullinjtë, kopshtet, toka etj. Shpjegimi do të ishte i pamjaftueshëm nëse nuk do ta plotësonin edhe me një element, që është: cilat janë qëllimet që u shërbejnë ato themelata mirëbërëse? Faktikisht, vakëfi është pronë të cilën ai që ka bërë një testament, ia jep vullnetarisht bashkësisë për qëllime të dobishme, sipas rregullave të bashkësisë islame ose të ndonjë institucioni humanitar.¹⁷

Vakëfet u paraqitën në epokën feudale dhe u shërbejnë qëllimeve fetare islame, kulturo-arsimore dhe humane, në rend të parë për zhvillimin dhe ekzistimin e institucioneve dhe objekteve, siç janë: shkollat fetare-arsimore (p.sh. medresetë), xhamitë, teqetë, spitalet, bibliotekat publike, urat, kullat, çezmet, jetimoret etj. Këtë e vërtetojnë shumë mirë *vakëfnamet* ose *vakfijet* – dokumente të institucioneve bamirëse.

Disa vakëfe në territorin e Pashallëkut të Beogradit janë zhdukur qysh në shekullin XVIII, e në Kosovë dhe në Sanxhak pjesa e madhe e tyre u shuan gjatë shek. XIX, gjë që ka ndikuar negativisht në fatin e disa shkollave, bibliotekave, *imareteve*, si p.sh. në imaretin i Gazi Is-hak-beut në Shkup, imareti i Prishtinës, i Jeni-Pazarit etj. Imaretet kanë hapur edhe teqe të mëdha, si ajo e Tetovës dhe Teqeja e madhe e Gjakovës. Zakonisht janë ngritur pranë xhamive apo medreseve. Në disa vende nxënësit edhe banonin falas dhe përveç imareteve, për këto qëllime shërbenin edhe shumë institucione mirëbërëse – *mysafirhane* dhe institucione të tjera arsimore e kulturore.

¹⁷ Opće enciklopedija, Zagreb, 1982, fq. 436.

Në Ballkan në kohën e Turqisë u themeluan me mijëra vakëfe. Kishte edhe të ashtuquajtura *evladijet* – *vakëfe*, vakëfe familjare, sepse në shtetin osman spahinjët pronat e veta feudale (timaret) i linin vetëm pjesërisht me testament; pra me kusht që pjesa e të ardhurave të tyre t'u jepej trashëgimtarëve të vet.

Në Jugosllavinë midis dy luftërave botërore (1918-1941), vakëfet kanë qenë të legalizuara dhe ishin në qeverisjen e Bashkësisë Islame. Edhe sot pasuria e patundshme (toka, ndërtesat etj.) dhe fondet që u janë lënë bashkësive islame, quhen vakëfe.¹⁸

Dy-tre shembuj nga mesi i Kosovës do ta rirforcojnë rolin e vakëfeve dhe rëndësinë e vakëfnameve. Sipas regjistrit të vakëfeve të vitit 1450, në Mitrovicë Mehmed Çelebiu, nga Edrena ndërtoi një mekteb, ndërsa i biri i Hasanit – Hyseni themeloi një teqe¹⁹. Regjistrat e mëvonshëm dëshmojnë se gjer nga mbarimi i shekullit XVI Mitrovica përfitoi katër faltore islame: tri mesxhide dhe një xhami²⁰. Edhe regjistrat e tjerë të vakëfeve, si ai i vitit 1489, japin shënime interesante. Përpos të tjerash, përmendet meceni i Mitrovicës, Gazi Ali-bej, i cili me pasurinë e vet ndërtoi objekte arsimore: medresenë (objekti ekziston edhe sot) dhe mektebin²¹.

Shembulli i dytë është vakëfnamja e vitit 959 hixhri, do të thotë e vitit 1550. Sipas saj, mirëbërësi Muslihudin Abdyl Gani al-Madini, përpos të tjerash, përcaktoi:

“Katër dërhëmë në ditë për shërbimin hatib, dhe gjashtë dërhëmë në ditë për imamin në xhaminë e ndershme, e cila gjendet në qytetin e ruajtur nga zoti, Jeni-Bazar”.²²

¹⁸ Pravna enciklopedija, Beograd, 1979, fq. 1573.

¹⁹ Sipas monografisë: Kosovska Mitrovica, 1979, në fq. 68.

²⁰ Ibid.

²¹ Po aty, në fq. 71.

²² H. Kalesi, Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku, Pristina, 1972, fq. 251.

Në dokument flitet edhe për *mualim* (mësuesin) e mektebit të njohur pranë xhamisë Altun-allem:

“Mualimit ia caktoi katër dërhëmë në ditë, ndërsa zëvendësit një dërhëm dhe si kusht paraqiti që mualimi të jetë i besuar, më i miri ndër të mirët, i qëndrueshëm, i aftë për të dhënë mësim dhe për të mësuar e edukuar nxënësit.”²³

Të rikujtojmë të paktën vakëfet e vjetra të Prizrenit, si ai të cilin sulltan Mehmed Fatihu ia dhuroi kishës së Levishës, të cilën në gjysmën e shek. XV e transformoi në xhami. Edhe poeti i madh *Suzi* themeloi vakëfin e vet në Prizren, në vitin 1513, e një ndër vakëfet më të mëdha tek ne ka qenë ai që e themeloi prizrenasi Kukli-beu në vitin 1538.

Vakëfet dhe vakëfnamet, së bashku me dëfterët, janë burimet më të rëndësishme për të njohur këto prona dhe themelata mirëbërëse në çdo vend ku kanë ekzistuar, p.sh. në Prizren, Mitrovicë, Jeni-Pazar, Smederevë, Beograd, Mostar, Sarajevë, Taslixhe, Nish, Prishtinë etj. Në bazë të vakëfeve, kemi njohuri më të plota se sa individë bamirës ndihmonin shkollën, arsimin, mjekësinë, kulturën islame, religjionin dhe vetë monumentet fetare. Vakëfi (lënie me testament) përveç mjeteve për institucione dhe objekte të ndryshme, kishte edhe mjete të posaçme për të ndihmuar pleqtë, të varfërit, vejushat, për ndihmë mëhallës, esnafit etj. Për vakëfet është i saktë ky vlerësim:

“Në asnjë fe, në asnjë shoqëri, institucioni i vakëfeve nuk ka luajtur një rol aq të rëndësishëm sa në fenë dhe shoqërinë islame.”²⁴

²³ Po aty, ibid.

²⁴ Dr. Hasan Kaleshi, Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku, Priština, 1972, fq. 13.

Dr.sc.Fejaz Drançolli

ÇARSHI, BAJRAKLI XHAMIA E PEJËS

Peja, një ndër qytetet më të vjetra të Kosovës gjendet, përkatësisht shtrihet në veri të Rrafshit të Dukagjinit rrëzë Alpeve Shqiptare.¹ Jeta në Pejë dhe rrethinën e saj në vijimësi vazhdon që nga periudha më e hershme deri në ditët e sotme. Kjo e dhënë dëshmohet me vlerat e kulturës materiale e shpirtërore, me trashëgiminë, monumentet ekzistuese të qytetit dhe rrethinës. Këto dëshmi të kulturës materiale na prezantohen si gjurmë, rrënoja deri diku të ruajtura, apo edhe si objekte, komplekse në tërësi ekzistuese.² Monumentet, trashëgimia etnokulturore e Pejës, pos që janë dëshmi, burime lëndore, ato njëkohësisht flasin, tregojnë rrethanat kulturo-historike, politike, ekonomike, sociale e fetare në të cilat u realizuan. Këto monumente, qofshin figurative a aplikative, pos të tjerash, veçohen për llojllojshmërinë dhe karakterin e funksioneve, dedikimeve, stileve, cilësive dhe

¹ BIK. Barbaria serbe ndaj monumenteve islame në Kosovë (Shkurt'98-Qershor '99), Prishtinë, 2000, 94.

² F. Drançolli, Peja historia në gur (dorëshkrim), Prishtinë, 1997, 1.

rëndësive kulturo-historike të tyre. Kjo e bën edhe më të pasur kulturën dhe historinë e artit shqiptar.

Që në fillim duhet theksuar se në kulturën materiale, trashëgiminë e Pejës vërehen edhe ndikime të kulturave të etnikumeve të tjera, si romake, bizantine, perëndimore e lindore, përkatësisht osmane. Elementet e kulturave, ndikimet në veprat e artit të këtij qyteti në asnjë formë e mënyrë nuk dobësuan realizimet figurativo-aplikative të popullatës autoktone, përkatësisht shqiptare. Përkundrazi këto elemente, siç janë mjeshtërit dhe artistë shqiptarë arritën që në veprat e tyre me mjeshtëri të sintetizonin me dhe në motive autoktone. Kjo gjë nuk është karakteristike vetëm për artin shqiptar, por, edhe për kulturën dhe artin e popujve të tjerë të Ballkanit dhe më gjerë. Ndikimet në fjalë ishin të karakterit reciprok dhe këto tregojnë se kultura dhe arti shqiptar u zhvilluan në kontakt të ngushtë me kulturën dhe artin e të tjerëve që jetuan në Gadishullin Ballkanik e më gjerë, në Lindje e Perëndim³

Në Pejë e rrethinë jeta vazhdon nga neoliti, por, ka indikacione se në këtë rajon është jetuar edhe në periudhën e paleolitit⁴

Me depërtimin e turqve osmanlinj në Gadishullin Ballkanik në shekujt XIV e XV, edhe Kosova ra nën sundimin e tyre. Me depërtimin turko-osman dhe vendosjen e regjimit feudal ushtarak, u vendos administrata e tyre dhe nisi ndërtimi e zhvillimi i qyteteve me ndikim oriental, si dhe gjetkë në trojet shqiptare.

Të theksojmë se me përhapjen e Islamit, të besimit në një Zot në dekadat e para të shekullit VII, filloi edhe ndërtimi i objekteve fetare islame. Arti islam a musliman fillon me dinastinë e Umevinjve (661-

³ F.Drançolli, Peja... 1.

⁴ Izveštaj sa rekognosciranja terena na teritoriji AKMO, Priština, 1957, 6-7. Mirëpo, në këtë punim nuk kemi për qëllim të ndalemi në artin e periudhës parahistorike, antike e as mesjetare, por në atë të kohës osmane, të kohës kur Peja ra nën sundimin e osmanlinjve dhe u ndërtuan objektet e para islamo-shqiptare në Pejë, në shek. XV.

750). Kjo ishte koha kur u ndërtuan edhe xhamitë e para si objekte sakrale.⁵ Arti islam apo musliman së shpejti bëhet dominues në mesin e shumë popujve me kultura të ndryshme⁶ Njëherësh duhet cekur se arti islam është një art i madh dhe i fundit në Lindje. Arti në fjalë kishte lidhje të ngushtë me krijimin e Perandorisë Arabo-islame si dhe me përhapjen e fesë së re-Islamit. Islami si fe më tepër se çdo religion lidhi besimtarët e vet dhe frymëzoi thellësisht e në mënyrë të gjithanshme me artin oriental islamik. Në artin oriental islamik ndikoi arti romak e posaçërisht dhe në veçanti arti sasanit dhe bizantin. Vetë karakteristike e këtij arti është përdorimi dekorativ i alfabetit arab, dhe arkitektura si mjet kryesor shprehës. Piktura dhe skulptura, si dhe veprat artizanale (qilimi, tekstili, qeramika dhe armët) shërbyen dhe dekoruan hapësirat arkitektonike⁷

Pra, në rrethana të reja të lidhjes së Ballkanit me Lindjen, në kushte të bashkëjetesës së shqiptarëve me osmanlinjtë, filluan të depërtonë edhe elemente të artit dhe të kulturës materiale islame tek shqiptarët në Kosovë si dhe në qytetin e Pejës, por duke u sintetizuar dhe duke u modifikuar me motive etnike nga mjeshtrë vendorë shqiptarë.

Gjatë periudhës disashekullore të sundimit osman në Kosovë e Pejë u ndërtuan një numër veprash arkitektonike tipesh dhe karakteresh të ndryshme, si sakrale, ashtu edhe profane të karakterit utilitar, publik dhe individual, siç janë:

xhamitë klasike monumentale, tyrbet dhe teqetë, hamamet, urat, karvan-sarajet, hanet, kullat e sahatit, medresetë, komplekset urbano-arkitektonike të çarshive të vjetra, ekzemplarë të shtëpive të banimit etj. Për fat të keq, një numër i madh i ndërtimeve të kësaj periudhe tani nuk ekzistojnë, u rrënuan nga koha, për shkak të materialit të

⁵ Si ta njohim artin islam, Prishtinë, 2000, 3.

⁶ Si ta njohim artin islam... 3

⁷ D. T.Rice, Islamska umetnost, Beograd,1968, (Parathënie)

dobët të ndërtimit e faktori njeri në kushte të okupimit serb, gjatë “realizimit“ të planeve urbanistike të qyteteve të Kosovës⁸ posaçërisht dhe në veçanti gjatë Luftës serbo-shqiptare të viteve 1998-1999, kur serbët kishin për qëllim edhe zhdukjen e gjurmëve të kulturës shqiptare të proveniencës islame.

Ndërtimet arkitektonike si objekte të kulturës materiale, të realizuara në rrethana të caktuara kulturo-historike, politike, ekonomike shoqërore, sociale e fetare, kanë një rëndësi të madhe për hulumtimin e studimin e së kaluarës së popullit shqiptar etnik në këto troje. Në kuadrin e këtyre ndërtimeve me vlera monumenti bëjnë pjesë edhe disa xhami klasike monumentale të ndërtuara në shekujt XV, XVI e XVIII.

Këto vepra monumentale të realizuara gjatë këtyre shekujve, për nga ndërtimi i tyre i takojnë “stilit grupor të Kosovës.” Xhamitë monumentale janë vepra të rëndësishme arkitekturale që u realizuan me qëllim të përshpejtimit të përhapjes së fesë islame në qytetet kosovare e në rrethina. Ndërtimi i xhamive për këto qëllime ishte intensiv veçanërisht në qytete, që kishte qëllim islamizimin e tyre.

Xhamitë monumentale të realizuara nga mjeshtër vendorë përbëhen nga këto pjesë: salla e lutjeve (faljeve), hajati (portiku) dhe minarja. Pra këto janë pjesët kryesore që i karakterizojnë xhamitë si vepra sakrale islamo-shqiptare në territorin e Kosovës. Duhet cekur se karakteristika e veçantë ishin edhe varret në kuadrin e komplekseve të xhamive, ku në të kaluarën varroseshin anëtarët e familjeve të njohura të qytetit, si dhe shatërvanet.

Në realizimin e këtyre objekteve sakrale si material ndërtimor konstruktiv përdorej guri i latuar. Ndërkaq, faqet e brenshme të mureve

⁸ Mr. Fejaz Drançolli, Disa ndërtime arkitektonike islame të shek. XV në Prishtinë, KBIK, Feja, kultura dhe tradita islame ndërshqiptarët (Simpozium ndërkombëtar), Prishtinë, 1995, 167-173.

bëheshin me tulla të suvatuara. Sa u përket dekoracioneve plastike, ato janë mjaft modeste, saqë ato në një masë të vogël në formë të profilizimeve, relieveve të imëta prezantohen në disa elemente të xhamisë, si në minare, shtyllat e hajatit dhe të mafilit, mihrab, mumber etj.

Në këtë punim do të ndalemi në historikun, pikturën, plastikën si dhe në analizën e pjesëve përbërse të Çarshi-Bajrakli Xhamisë së Pejës.

Xhamia në fjalë është vepër klasike monumentale, me karakter dhe dedikim fetar. Ky objekt u ndërtua në periudhën kur Peja ishte nën sundimin e osmanlinjve, përkatësisht kur qyteti që në kuadër të Sanxhakatit të Dukagjinasve (1462-1482), pra në gjysmën e dytë të shekullit XV. Me interes është të theksohet se me rënjen e Pejës (1462) nën sundimin e osmanlinjve, disa anëtarë të dinastisë së Dukagjinasve përqafonin besimin Islam.⁹ Në këtë mënyrë Dukagjinasit ruajtën pozitën, pushtetin dhe territoret e veta. Për këtë tregon edhe fakti i formimit të sanxhakatit. Të cekim se një numër i aristokracisë shqiptare, përkatësisht pejane, duke pranuar besimin Islam, u inkadruan në aparatën shtetërore të Perandorisë Osmane. Duke përqafuar fenë dhe kulturën islame, këta shqiptarë më pas luajtën rol me rëndësi në çdo aspekt, duke qenë donatorë të shumë veprave monumentale si të kultit, ashtu edhe të atyre laike, të karakterit shoqëror e arsimor, në veçanti. Në kohën në fjalë në Pejë, prej 174 familjeve ekzistuese, 33 kaluan në besimin islam, ndërsa 141 ishin të krishterë. Në periudhën në fjalë asnjë familje në rrethinë në fshatrat e Pejës nuk përqafoi fenë islame. Në kohën e Sanxhakatit pos Çarshi-Bajrakli Xhamisë, u ndërtuan edhe medreseja (mbi themelet e kësaj medreseje është ndërtuar shkolla e parë shqipe nga rilindësi Haxhi Zeka në fund të shekullit

⁹ S. Rizaj, Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII, Prishtinë, 1982, 230-242.

XIX) në afërsi të Hamam Xhamisë si dhe Hamami i Haxhi Beut. Kjo qe periudha kur Peja kishte vetëm 18 mëhallë.¹⁰



Çarshi, Bajrakli Xhamia (Foto. 1)

Çarshi, Bajrakli Xhamia (Foto. 1, 2) paraqet objektin e parë fetar të ritit islam në Pejë. Donator i kësaj vepre ishte Mehmeti II Fatihu. Nga donatori i njëjtë u ndërtua edhe Xhamia e Mbretit në Prishtinë. Xhamia e Pejës njihet edhe me emrin

Ebylfet-Pushtues.¹¹ Pra, si shihet kjo vepër u realizua në dekadat e para të okupimit osman, në kohën e zhvillimit ekonomik të tyre, kur Peja ishte qendër i Sanxhakatit të Dukagjinit (1462-1485). Posaçërisht duhet theksuar dhe është tejet me rëndësi të flitet dhe të ceket e dhëna se aty ku u ndërtua xhamia, ishte vendi i tregut. Kjo gjë, pra tregu, ishte një karakteristikë specifike për qytetet shqiptare të kohës.



Çarshi, Bajrakli Xhamia (Foto. 2)

Këtë element nuk e njohin qytetet osmano-turke. Tregu, Çarshi, Bajrakli Xhamia në dekadat e fundit të shekullit XV si dhe në shekujt të mëvonshëm XV, XVII, XVIII, XIX luajtën rol të rëndësishëm në karakterin urbanistik të qytetit, përkatësisht të Çarshisë së vjetër të Pejës. Me këtë lidhet edhe ndërtimi i kompleksit urbano-arkitektonik,

¹⁰ S. Rizaj, Kosova ..., 230-242

¹¹ S. Rizaj, Kosova ..., 230-242

të cilin, deri para luftës së fundit e kishim pjesërisht të ruajtur. Gjatë Luftës serbo –shqiptare të vitit 1999, nga forcat paramilitare e policia serbe tërë kompleksi u plaçkit, u dogj dhe u rrënuar. Çarshi, Bajrakli Xhamia dhe ndërtimet e mëvonshme arkitektonike të ish-kompleksit të Çarshisë së vjetër paraqitnin një tërësi unike dhe bërthamën e pjesës së vjetër të qytetit të urbanizuar të periudhës osmane.

Çarshi, Bajrakli Xhamia¹² është një ndërtim klasik sakral me një rëndësi të veçantë kulturo-historike, arkitektonike, piktorale e plastike jo vetëm për historikun e Pejës, por, në përgjithësi, edhe për historinë e artit shqiptar. Qëllimi i ndërtimit dihet,-përshpejtimi i përhapjes së fesë islame në Pejë e rrethinë. Sa i përket silitit, materialit ndërtimor dhe teknikës së ndërtimit këtu nuk do të ndalemi veçse do të ndalemi në pjesët përbëse të kësaj xhamie, e në analizën e tyre, që janë identike edhe për vepra të tjera sakrale monumentale të qytetit të Pejës, të Kosovës dhe më gjerë.

Në skemën kompozicionale të saj xhamia përbëhet prej sallës së lutjeve, hajatit, minares, shatërvanit dhe varrezave në kuadrin e kompleksit të ndërtimit fetar. Kompleksi i xhamisë është i rrethuar me mur dhe parmakë të metaltë

Salla e lutjeve-faljes ka vëllim unik dhe është e mbuluar me kube. Kjo sallë ka planimetri katrore. Në te hyhet nga porta, që është e mbuluar me arkitra. Mbi portën kryesore ekzistonte edhe mbishkrimi i gravuar në plastikë lineare, por sot ai nuk është i lexueshëm, sepse është shkatërruar fizikisht nga persona të pandërgjegjshëm dhe tani për tani të paidentifikuar. Salla me vëllimin e saj unik është e mbuluar me kube të konstruktuar drejtpërsëdrejti mbi të nëpërmjet pandantiveve në qoshe. Salla ndriçohet nga hapjet, dritaret që gjenden në fasadat dhe tamburin e objektit.

¹² F. Drançolli, Peja historia..., 12-14

Duhet cekur se dysHEMEJA ekzistuese e sallës së lutjeve është ngritur më lart nga gjendja fillestare për 80 cm. DysHEMEJA burimore ka qenë e shtruar me pllaka (dheu të pjekur) të kuqërremta në formë gjashtëkëndore.¹³



Foto 3

Si në çdo xhami klasike monumentale, edhe këtu, përballë hyrjes, përbri murit jugor është mibrabi që prezantohet në formë unike. Besimtarët gjatë ritualit të faljes ktheheshin nga mibrabi, meqë ky element (natyrisht edhe xhamia) është orientuar drejt kibles, Mekës. Në të djathtë po të murit të cekur, është mimberi (Foto. 3, 4), i cili paraqet një element konstruktiv-arkitektonik duke qenë i ngritur me shkallë dhe ka rol të rëndësishëm për ligjërata fetare. Në të majtë të mibrabit është qyrsi. Mafili-galeria (Foto. 5) është vendosur mbi hyrje të sallës së lutjeve në tërë gjërësinë me një gjatësi prej afro tre metrash.

Hajati (portiku) i Çarshi, Bajrakli Xhamisë ka një zgjidhje tradicionale të këtyre ambienteve. Hajati mbulohet me tri kube të vogla dhe të njëjta. Kubetë e hajatit janë në nivel më të ulët se kubeja



Foto 4.

¹³ IMMK. Raport nga vizita e Çarshi Xhamisë në Pejë, qershor 2000.

kryesore dha ato me dinamikën dhe kontrastet, e tyre ndikojnë në lojën e dritë- hijes dhe në vlera estetike të objektit. Katër kubetë e xhamisë janë të mbuluara me mbulesë plumbi.

Si pjesë e pa-ndarë dhe me rëndësi në skemën kompozicionale të objektit, është edhe minarja, e cila ndikon dhe i jep karakterin objektit. Minarja si zakonisht zë vend në të djathtë të sallës së lutje-



Foto 5

ve në pjesën perëndimore të xhamisë. Ky element, pjesë konstruktivo-arkitektonike dhe funksionale cilësohet për poligonalitytin dhe elegancën e vet. Si pjesë, element i minares është edhe sherefeja-kazani, që në formë ancaku del nga konstruksioni perimetral i minares. Sherefeja a galeria shërben për kryerjen e ceremonive të caktuara fetare, për thirrjen e ezanit, për tenbih etj.

Kjo xhami, sa u përket dekorimeve plastike, është mjaft modeste, por ato në një masë dhe mënyrë na paraqiten në kapitelet dhe bazamentet e shtyllave të hajatit (motivet kanë forma gjeometrike të trekëndëshave të dyfishta dhe janë të realizuara në plastikë sipërfaqësore), në portalin kryesor (ku prezantohet motivi i rozetës i realizuar në gjysmë-plastikë), në mimber (ku kemi lule të stilizuara), në bazamentet e shtyllave poligonale të mafilit (ku kemi motive gjeometrike të realizuara në plastikë sipërfaqësore). Duhet cekur se edhe

hapjet, dritaret, portali kryesor janë të realizuara nga mermeri dhe kanë profilizime.

Pos për plastikën, kjo vepër cilësohet edhe për piktura murale, dekorative, arabeskat e saj. Kjo pikturë na paraqitet në enterierin e objektit, përkatësisht në muret e sallës së lutjeve. Pikturat janë të realizuara në teknikë seko, pra në teknikën që është karakteristike për këso objekte fetare. Piktura e kësaj xhamie veçohet nga elemente të botës bimore, lule të stilizuara, figura gjeometrike dhe citate nga Kur'ani.

Në saje të elementeve konstruktivo –arkitektonike, trajtave të pas-tra arkitekturale, proporcioneve dhe vlerës kulturo-historike, estetike të objektit, kjo xhami si realizim sakral bën pjesë në rendin e ndërtimeve më të vjetra të këtij lloji të ndërtimit arkitektonik të konfesionit islam shqiptar jo vetëm në Pejë e në Kosovë, por edhe më gjerë në territoret etnike shqiptare.

Mr. Tefik Morina & *Resul Rexhepi*

TRASHËGIMIA KULTURORE ISLAME DHE AJO SHQIPTARE NË SHËNJESTËR TË BARBARISË SERBE

Populli i lashtë shqiptar në trevat ballkanike (dhe kosovare) në çdo hap ka me se të verifikojë autoktoninë dhe lashtësinë e tij. Në këto troje anembanë gjenden kala ilire, vendbanime të fortifikuara, të zbuluara dhe të hulumtuara nga arkeologët tanë. Gjendet një numër i madh varrezash tumulare, në të cilat hasen gjësende, armë e stoli nga materiali i ndryshëm, që dëshmojnë një shkallë të lartë të kulturës. Ilirët, në bazë të të dhënave arkeologjike dhe burimeve të shkruara, i gjejmë në këto vise para më se tre mijë vjetësh. Populli shqiptar ka dhënë shumë personalitete të mëdha gjatë historisë. Në krye të Perandorisë Romake qëndruan me sukses disa perandorë me origjinë nga këto vise. Perandorinë Osmane e udhëhoqën një numër i madh sadriazemësh shqiptarë.

Ekzistenca jonë në trojet tona, lashtësia dhe trashëgimia kulturore e historike me institucionet arsimore e kulturore, gjithnjë e më tepër bëhej halë në sy e soldateskës pushtuese serbe-milosheviçiane, e cila me fillimin e fushatës ajrore kundër caqeve ushtarako-policore në

RFJ, gjeti rastin më të volitshëm për realizimin e aspiratave çubrillo-vicjanë: të fshinte nga faqja e dheut çdo gjë shqiptare. Të asgjësonte qenien shqiptare.

Soldateska ushtarako-policore me paramilitarët, vrau dhe arrestoi dhjetra mijëra, dëboi nga shtëpitë e tyre më se tetëqind mijë shqiptarë, të cilët u strehuan përkohësisht në Shqipëri, Maqedoni, Bosnjë e Hercegovinë, Malin e Zi dhe në vende të treta në botë, deri në Amerikë e Australi, por, pas fitores, u kthyen shumë shpejt.

Soldateska dogji fshatra e qytete. U dogjën arat me grurë. U dogjën hambarët, mullinjët, u dogjën magjet me bukën tonë. Armiku dogji shkolla dhe ambulanca. Iu vu flaka kullave shqiptare. U dogjën xhamitë, mejtepet, teqetë, tyrbet, bibliotekat dhe dorëshkrimet islame dhe në përgjithësi monumentet, kulturo-historike të mbrojtura me ligjet ndërkombëtare. Piromanët i vunë flakën çdo gjëje shqiptare, çdo gjëje që mban vulen e kulturës islame. Prej mbi 500 xhamive sa gjendeshin në Kosovë, gjatë luftimeve (1999) në Kosovë, u dogjën, u dëmtuan apo u rrënuan plotësisht 218 xhami, ndër të cilat edhe gjashtë xhami që ishin nën mbrojtjen e ligjit.

Do të përmendim vetëm disa nga objektet e rëndësishme kombëtare e islame dhe rëndësinë e tyre për kulturën shqiptare dhe historinë, që gjatë luftës u dogjën, u dëmtuan apo u rrënuan tërësisht.

Kompleksi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit shtrihet në ndërtesat e ish Medresesë së Mehmet Pashës, pranë Xhamisë së Mehmet Pashës që quhet edhe Bajrakli Xhami. Nga mbishkrimi në xhami shihet se ajo është ndërtuar në vitin 1573¹ (981/2 hixhri). Përafërisht në këtë kohë janë ndërtuar edhe medreseja, mejtepi, hamami, tyrbeja dhe bibliote-ka. Ndërtesa që shërbente si dhomë mësimi e medresesë (ders'hana), është luajtur nga vendi për disa metra dhe është restauruar me rastin e

¹ Madzida Bećirbegović, Prosvetni objekti islamske arhitekture, Starine Kosova VI-VII, Priština, 1972/3, f. 84.

kremtimit të Njëqindvjetorit të Lidhjes së Prizrenit. Ndërsa kishte pjesën përdhese dhe një kat. Nga kjo ndërtesë ishin shpallur vendimet e Lidhjes së Prizrenit (10.06.1878), të cilat u kundërviheshin vendimeve të Kongresit të Berlinit për ndarjen e trojeve shqiptare për fqinjët ballkanas – Serbinë dhe Malin e Zi, dhe kërkesat për autonominë shqiptare në suazën e Perandorisë Osmane deri në pavarësi.

Vlera arkitektonike dhe historike e kompleksit ishte verifikuar edhe në raportin e UNESCO-s (nr. PP-1975-76/3.411.6). Gjatë vitit 1995 këtu do të vendoseshin refugjatët-kolonët serbë nga Krajina e Kroacisë, edhe pse nuk kishte kurrfarë kushtesh për banim. Disa herë u zhdukën eksponatet me vlerë shumë të madhe kombëtare nga ekspozita e Lidhjes. Gjatë luftës në Kosovë (prill 1999) kompleksi u rrafshua me tokë. Ishte ky rast i pritur gjatë dhe i mirëseardhur për soldateskën serbe, kundër kulturës dhe historisë shqiptare.

Mulliri i Haxhi Zekës në Pejë. Gjendet në pjesën veri-lindore të qytetit, në rrugën “Muharrem Sahara” nr. 17. Godina e mullirit me objektet shoqëruese arkitektonike, datohen në dhjetëvjetëshin e fundit të shek. XIX.² Ka qenë mjaft interesant si kompleks arkitektonik. I ndërtuar nga gurë, tulla dhe drurë. Mulliri në fillim për energji përdorte fuqinë e ujit e më vonë rrymën elektrike. Deri vonë ka qenë ruajtur makineria për bluarjen e drithit.

Themeluesi i mullirit ka qenë Mulla Haxhi Zeka, i njohur si prijës i Lidhjes së Prizrenit dhe themelues i Lidhjes së Pejës “Besa-Besë” (26-30.01.1899) në Pejë.

Edhe pse ishte nën mbrojtjen e ligjit, mullirit së pari iu vu flaka (prill 1994), e më vonë u demolua plotësisht. Ndërsa, nën rrethanat e njohura, as institucionet as Shoqata, as personalitete të interesuara

² Të dhëna nga dosja në Entin Krahinor të Monumenteve të Kulturës, Prishtinë.

nuk qenë në gjendje të ndërmerrnin çfarëdo për mbrojtjen e tij. Sot kemi mbetur edhe pa një objekt, pionier i industrisë ndër qytetet tona.

Kompleksi urban – **Çarshia e Madhe e Gjakovës** shtrihet në anën e djathtë të lumit Prroni i Gjakovës. Çarshia paraqet fenomen unik të aglomeracionit historik-urban në Kosovë. Shumë herë ka qenë temë diskutimi e shqyrtimi mbrojtja e Çarshisë si një kompleks unikat urban zejtar e tregtar ndër qytetet tona. Hapat e parë konkretë në këtë drejtim qenë marrë gjatë vitit 1970, kur filloi xhirimi arkitektonik, përpilimi dhe mbledhja e dokumentacionit teknik. Janë xhiruar afro 200³ objekte të bërthamës së Çarshisë. Në bazë të dokumentacionit, pati filluar restaurimi, konservimi dhe rivitalizimi i Çarshisë së Madhe. Kemi qenë në rrugë të mbarë për të shpëtuar nga dhëmbi i kohës këtë margaritar si edhe Çarshinë e Gatë të Pejës, por urrejtja ishte më e madhe. Ajo errësoi logjikën e shëndoshë. Piromanët serbë, ia vunë zjarrin, dhe vlerat e paçmuara të trashëgimisë kulturore u zhdukën pa kthim. Çarshia e Madhe e Gjakovës dhe Çarshia e Gatë e Pejës më nuk ekzistojnë, janë rrafshuar me tokë. Me këtë nuk u asgjësuan një objekt a dy objekte nën mbrojtje, po u zhdukën më se një mijë objekte karakteristike, u zhdukën dy qendra unikate të dy qyteteve tona.

Ndërtesa e Kryesisë së Bashkësisë Islame, e cila gjendej në kompleksin e Xhamisë së Madhe (Fatih) të Prishtinës, e mbrojtur me ligj, më nuk ekziston. Ajo u dogj së bashku me dokumentacionin administrativ, arkivin, inventarin dhe tërë pasurinë. Shpëtoi xhamia dhe dorëshkrimet e vlefshme islame, që nuk ishin në këtë objekt.

Xhamia e Hadumit në Gjakovë, e ndërtuar në vitin 1594/5 (1003/4 hixhri). E kishte ngritur Bizeban Sylejmani, një shërbëtor nga oborri mbretëror i Stambollit, i lindur në fshatin Guskë afër Gjakov-

³ M. Folić – M. Lukić, Pregled konzervatorskih radova, Starine Kosova VI-VII, Priština, 1972/3, f. 256.

ës⁴. Pranë xhamisë kanë qenë ndërtuar biblioteka, mejtepi, hani dhe hamami, si bërthamë e parë e Gjakovës. Xhamia është objekt i bukur, i ndërtuar në mënyrë klasike osmane të ndërtimit të xhamive njëhapësinore me trem të thjeshtë dhe të mbuluar me tri kube të vogla. Karakteristika kryesore e konstruksionit të saj është që kubeja kryesore, e mbuluar me plumb, me diametër 13,50 m. fle mbi tetë pilastre dhe trompe të forta në anën e brendshme të mureve. Një zgjidhje e këtyllë e konstruksionit ndër ne është përdorur vetëm këtu.

Brendia e xhamisë është pikturuar me dekorime interesante, me peizazhe të stilizuara me qiparisë. Në objekt janë bërë intervenime në vitin 1844/5, kur i është ndajmbathur tremi, i cili i kishte humbur bukurinë paraprake, për të zgjeruar hapësirën për falje. Minarja, që shquhet për hollësinë e saj, ka nevojë për sanimin e gurit konstruktiv, i cili është dëmtuar mjaft.

Punimet konservuese-restauruese në objekt janë zhvilluar në vitet 1968, 1972 dhe 1973. Janë ndërruar gurët e dëmtuar në fasadë, është bërë bllobimi i murit të minares, ndërrimi i konstruksionit të çatisë me mbulesë të re plumbi, është freskuar piktura murale. Ndërkaq dokumentacioni teknik është përpiluar në kuadër të Projektit për sanimin dhe rivitalizimin e Çarshisë së Madhe⁵, e djegur po ashtu gjatë luftimeve në Kosovë (1999).

Xhamia është djegur dhe është dëmtuar në masë të madhe.

Xhamia e Hasan Agës në Rogovë të Gjakovës, është ndërtuar në vitin 1580 (988/9 h.). Kubeja e saj ka konstruksion identik me atë të Xhamisë së Hadumit të Gjakovës. Interes të posaçëm zgjojnë dritaret

⁴ Përmendoret e arkitekturës islame dhe dorëshkrimet orientale, Kosova, dikur dhe sot, Prishtinë, 1973, f. 473.

⁵ T. Morina, Monumentet e kulturës islame në Kosovë dhe mbrojtja e tyre (1945-1992), Simpoziumi Feja, Kultura dhe tradita islame ndër shqiptarë, Prishtinë, 1995, f. 520.

me parmakët e tyre. Tremi ka qenë mjaft karakteristik, por ka qenë rimurosur më vonë, kështu që ka humbur mjaft nga pamja paraprake.

Xhamia ka qenë mjaft e dëmtuar, por ka qenë ruajtur tërësia e objektit. Gjatë vitit 1983 është përpiluar dokumentacioni teknik, në bazë të të cilit më pastaj u zhvilluan punimet në konservimin dhe rikonstruimin e minares si dhe rimbulimi i kubesë së saj.⁶ Varreza e vjetër pranë xhamisë ka qenë shkatërruar nga ana e pushtuesit serb qysh në vitin 1932. Tani u dëmtua xhamia dhe gati u shkatërrua plotësisht.

Xhamia e Gazi Ali Beut në Vushtrri është ndërtuar nga mesi i shekullit XV. Evlia Çelebiu në shek. XVII përmend se në Vushtrri kishte 2000 shtëpi, një xhami në çarshi, një medrese, disa teqe dhe mejtepe e një hamam.⁷ Ali beu ishte donator, të cilit sulltani në vitin 1455⁸ ia kishte besuar qeverisjen mbi një pjesë të Kosovës. Andaj Gazi Ali beu ishte ndërtuesi i xhamisë, me siguri pas vitit 1455 si dhe i objekteve përreth, të cilat përveç mejtepit mbijetuan shumë luftëra, por jo edhe këtë të fundit. Nuk u rrënuar nga pasojat e luftimeve. Xhaminë e Gazi Ali beut e rrënoi urrëjtja serbe ndaj kulturës dhe trashëgimisë islame dhe shqiptare në këto troje. Xhamia u dogj, u rrënuar dhe u bë rrafsh me tokë me ekskavator. Këtë fat e pati edhe Medreseja e Gazi Ali beut, që gjendej pranë xhamisë. Është dëmtuar mjaft edhe hamami i qytetit.

Xhamia e Çarshisë (Bajrakli) në Pejë, mendohet të jetë ndërtuar në gjysmën e dytë të shekullit XV, kur Peja ishte seli e sanxhakatit.⁹ Godina është e mbuluar me kube të madhe plumbi, ka minare të hollë dhe trem me tri kube të vogla. Bën pjesë ndër objekte të rëndësishme

⁶ T. Morina, vep. e cituar.

⁷ E. Çelebija, Putopis, Sarajevo, 1967, f. 274.

⁸ M. Becirbegovic, vep. e cituar, f. 87.

⁹ Kosova, dikur dhe sot, f. 936.

të arkitekturës islame, të ruajtura deri tash. Me rëndësi të posaçme është portali i mermertë dhe tremi, i cili më vonë ka qenë mbyllur me mur tullash.

Në oborr ndodhet varreza e vjetër dhe ka varre të personaliteteve të njohura, siç janë varret e Haxhi Mulla Zekës, e Ali Pash Gucisë dhe shatërvani i Jashar pashës (1908).

Gjatë vitit 1971 janë zhvilluar punimet restauruese-konservuese në trem, duke hapur mbylljet e mëvonshme. Janë bërë sanime edhe në konstruksionin e çatisë.¹⁰ Tremi është mbuluar me plumb të ri.

Me plane parashiheshin punime të mëtejme, por xhamia u dogj dhe u dëmtua në masë të madhe nga forcat ushtarako-policore serbe.

Xhamia e Defterdarit në Pejë është ndërtuar gjatë shekullit XVII. Ajo gjendet në pjesën verilindore të qytetit në afërsi të stacionit hekurudhor. Në këtë kompleks përveç xhamisë gjendej tyrbja-mauzoleu¹¹ germadhë dhe një numër i mirë përmendoresh mbivarrore. Xhamia kishte konstruksion interesant, sepse pjesa qendrore nuk ishte e mbuluar me kube, por me çati druri në formë piramide.

Tavani ka qenë i mveshur me drugdhendje shumë interesante. Është me interes përmendorja mbi varrin e Defterdarit Muhamed efendi (1624, 1034/5 h.)

Gjatë vitit 1970 janë zhvilluar punimet restauruese-konservuese, janë zëvendësuar lëndët bartëse të çatisë dhe është meremetuar tavani. Janë zhvilluar edhe disa punime për restaurimin dhe rikonstruktimin e tyrbes. Por, zjarri i vënë nga piromanët serbë e shkatërroi tërësisht.

Xhamia e Hamamit në Pejë është mjaft e vjetër dhe gjendet në afërsi të hamamit. Nuk kemi të dhëna për kohën dhe ndërtuesin e saj. Kemi të ruajtur një mbishkrim, i cili ka të bëjë me rindërtimin e xha-

¹⁰ M. Folic – M. Lukic, vep. e cituar, f. 252.

¹¹ M. Folic – M. Lukic, vep. e cituar, f. 252.

misë (16.08.1861).¹² Sipër portës gjendet edhe një mbishkrim tjetër: “Sa e bukur është”. Kjo tregon se ndërtimtarët që bënë restaurimin, ishin mahnitur nga bukuria dhe kishin dhënë ç’ishte e mundur nga vetja që objektit t’i rikthenin bukurinë e mëparme.

Piromanët dhe katilët nuk arritën të asgjësonin as qenien kombëtare shqiptare, as trashëgiminë shumëshekullore të këtyre trojeve. Populli shqiptar do të dijë t’i rindërtojë objektet e shkatërruara dhe të ndërtojë të reja, që do t’u kushtohen ngjarjeve të mëdha të viteve të fundit.

¹² Kosova, dikur dhe sot, f. 837.

INTERVISTË

Intervistë me dr. Muhamed Mufakun, drejtor i Institutit Bajt al-Hikma për shkenca politike pranë Universitetit Al Al-Bajt në Aman

KOSOVA PO SHKON DREJT PAVARËSISË



Dr. Muhamed Mufaku

Dr. Muhamed Mufaku është njohës i mirë i rrethanave në Kosovë, ku kaloi 13 vjet, poashtu edhe në Botën Arabe ku jeton dhe vepron që nga vitit 1987. Është drejtor i Institutit Bajt Al-Hikma për shkenca politike pranë Universitetit Al Al-Bujt në Aman të Jordanit. Gjatë agresionit serb në Kosovë është zëdhënësi më besnik në Botën Arabe për ate se çka po ndodhte në Kosovë. Ai bëri shumë për ta plasuar të vërtetën edhe për shqiptarët e Kosovës Lindore dhe shqiptarët e Maqedonisë. Ai ishte prezent në të gjitha mediat arabe qofshin ato elektronike apo të shkruara. Ai bëri shumë dhe po bënë edhe sot e kësaj dite për ta njohur Botën Arabe me të arriturat tona kulturore. Për këtë dhe shumë gjëra tjera zhvilluam një bisedë për lexuesit e "Edukatës Islame" me Dr. Muhamed Mufakun.

Edukata Islame: Kush është Muhamed Mufaku shkurt?

Muhamed Mufaku: Jam lindur në Damask më 1952, në një familje të shpërngulur nga Kosova. Babai, si i vetëm, sepse tërë familja kishte mbetur në Kosovë, ka ruajtur pasaportën e ish-Jugosllavisë,

dhe kishte dëshirë të madhe ta shihte përsëri atdheun. Kuptohet, ai më nxiti gjithnjë të mendoj për Kosovën e të kthehem më në fund më 1974. Ndërkohë, me 1970 na vizitoi në Damask një dajë (Isë Maxharaj), i cili më tërhoqi me shpirt nga Kosova.

Në Kosovë kam vazhduar studimet në histori dhe jam doktoruar dy herë, në filologji dhe në histori. 13 vjet kam punuar në Degën e Orientalistikës të Fakultetit Filologjik të Prishtinës. Në Kosovë jam formuar në ato vite të stuhishme (1974-1987), dhe kurrë më nuk jam ndarë prej Kosovës, megjithëse jam detyruar të largohem më 1987. Në Siri kam pushuar një vit, kurse më 1989 kam shkuar në Jordani, ku ndodhem edhe sot. Që nga 1995 jam drejtor i Institutit Bajt al-Hikma për shkencat politike, ku deri më tani janë magjistruar më se 50 studentë. Ndërkohë jam marrë vazhdimisht me punë shkencore, me përkthime e punime të ndryshme, dhe deri më tani kam botuar nja 40 libra të ndryshme. Paraqitem vazhdimisht në shtypin arab, në dy gazeta të njohura al-Hayat dhe al-Mustakbal, dhe në shumë revista shkencore. Deri më sot kam botuar qindra artikuj, në mesin e tyre nja 100 vështrime për libra të ndryshme, në lidhje me Kosovën dhe shqiptarët e Ballkanin në përgjithësi.

***Edukata Islame:** Cilat janë përshtypjet e tua pas vizitës suaj të fundit në Kosovë?*

Muhamed Mufaku: Për shumë arsye nuk kam mundur të vij në Kosovë më herët, pra menjëherë pas çlirimit. Megjithatë, më në fund erdha! Më duket si në ëndërr! Kishte momente gëzimi e momente pikëllimi. Kam vizituar të mitë në Pejë, Vrellë e Burim (ish-Istog) dhe jam prekur shumë për ato përjetime të rënda që kishin përjetuar gjatë luftës. Nuk do të besoj po t'i kisha dëgjuar atje jashtë! Megjithatë, jam gëzuar shumë se si kanë arritur aq shpejt ta kalojnë gjendjen mizore e të ngjallen ashtu si i pashë. Ja ç'do të thotë liria! Kisha

dëshirë të madhe të rri më shumë, të ngihesha më shumë me përjetime të ndryshme, por tani, pasi jam regjistruar do të kthehem së shpejti në nëntor për të marrë pjesë në zgjedhje e për të ndjekur më shumë gjendjen. Kosova është tani tjetërfare, nuk mund të krahasohet me të kaluarën e nuk mund të kthehet më në të kaluarën. Ajo është histori dhe tani duhet të mendohet veç për ardhmen.

***Edukata Islame:** Sa ka qenë e pranishme çështja shqiptare në mediat arabe, sidomos gjatë agresionit serb në Kosovë, si dhe krizës së fundit në Maqedoni?*

***Muhamed Mufaku:** Çështja shqiptare ka qenë e pranishme kohë pas kohe në media arabe, varësisht nga situata vendore e rajonale. Kuptohet, për shkak të mbylljes së Shqipërisë, ajo lidhej më shumë me Kosovën, pra Kosova ishte në një kuptim gjeneratore e çështjes shqiptare në përgjithësi. Kjo filloi të rritej qysh nga 1989, nga anulimi i autonomisë, dhe arriti kulmin më 1998-1999 me luftën dhe çlirimin e Kosovës. Po ashtu, ajo vazhdoi me zhvillimet e reja në Luginën e Preshevës dhe në Maqedoni. Kuptohet, kishte dy qëndrime, një proshqiptar dhe një antishqiptar. Për fat të keq, ka ca gazeta arabe të lidhura me regjimet e ish-Jugosllavisë, që lancuan vazhdimisht pikëpamje e "të vërteta" të marra nga kuzhinat serbe e maqedonase. Gjatë asaj kohe kam botuar shumë shkrime e reagime në shtypin arab, që besoj kanë kontribuar deri diku për një paraqitje më reale të çështjes shqiptare.*

***Edukata Islame:** Cili është niveli i të arriturave shkencore dhe arsimore në Botën Arabe dhe në Jordani?*

***Muhamed Mufaku:** Të flas së paku për Jordaninë. Arsimi në Jordani ka arritur një nivel të lartë në nivelin arab dhe botëror, së paku nga përqindja e maturantëve që regjistrohen në universitete. Jordania*

ka vetëm 5 milionë, por ka 20 universitete! Për krahasim, Siria ka 18 milion dhe ka vetëm 5 universitete.

Në një atmosferë të këtillë mund të thuhet se në Jordani më shumë tani synohet nga shkencat teknologjike, që përgatitin kuadro për të ardhmen.

Kështu, nuk është çudi se në Jordani u bë një zhvillim i dukshëm në saje të përhapjes së internetit. Në qytetin ku jetoj, në Irbid, rruga kryesore hyri në Enciklopedinë e Ginisit, sepse ka kafe-internet më shumë se cilado rrugë tjetër në botë. Më gëzon gjithnjë fakti kur i shoh këto kafe-internete plot me të rinj. Në një atmosferë të këtillë mbahen vazhdimisht konferenca shkencore e botohen kontribute të reja. Në universitetin tonë, për shembull, janë mbajtur dhjetëra konferenca ndërkombëtare, në të cilat morën pjesë edhe ca shkencëtarë shqiptarë, si nga Kosova ashtu edhe nga Shqipëria. Tani po përgatitemi për një konferencë ndërkombëtare për orientalistikën në shek. XX, ku shpresoj të marrin pjesë disa kolegë nga Prishtina.

Edukata Islame: Sa mund të përfitojnë të rinjtë tanë që gjenden në studime në universitetet e Jordanisë?

Muhamed Mufaku: Të rinjtë shqiptarë mund të fitojnë shumë, njësoj si të tjerët që studiojnë tani në Jordani. Me rastin e themelimit të universitetit tonë (Al Al-Bajt) u pranuan 30 të rinj nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia. Shumica e tyre kanë mbaruar studimet dhe janë kthyer në vendet e tyre. Ka shumë që kanë kryer studimet për kompjuter, drejtësi, ekonomi, gjuhë e letërsi arabe, histori e arkeologji, si dhe studimet islame. Ka prej tyre që janë magjistruar dhe tani japin kontributin e tyre në Prishtinë. Me mburrje mund të them se shumë prej tyre kanë arritur sukses të dalluar. Njëri prej tyre, i cili kur erdhi nuk dinte asnjë fjalë arabisht, mbaroi gjuhën e letërsinë arabe dhe

mbrojti me sukses një temë që kishte të bënte me Kadarenë! Ishte vërtet një studim origjinal i shkruar në një arabishte origjinale.

***Edukata Islame:** Cilat janë shkaqet e mosstabilitetit politik në Lindjen e Mesme?*

Muhamed Mufaku: Mosstabiliteti në Lindjen e Mesme ka shumë burime. Së pari grushtshtetet që ndodhën në vendet arabe në vitet pesëdhjetë e gjashtëdhjetë, çrregulluan proceset demokratike dhe sollën në pushtet grupe me parulla joreale. Pas shumë vjetësh gjendja ekonomiko-shoqërore, e përcjellë nga një gjendje politike antidemokratike, solli shoqërinë arabe në një krizë të thellë. Regjimet ekzistuese kërkounin gjithnjë "fajtorë" të jashtëm për dështimet e brendshme: Izraeli, Amerika, Perëndimi etj. Kuptohet, këtu kishte ndikimin e vet edhe lufta e ftohtë. Për shumë arsye, dhe jo me dashjen e vet, regjimet arabe po detyrohen të lëshojnë pe, të "demokratizohen". Mirëpo, tani ka më shumë nevojë për demokracinë e vërtetë e jo për "demokratizime" formale.

***Edukata Islame:** Cilat janë shkaqet e rritjes së valës së ekstremizmit në Botën Arabe?*

Muhamed Mufaku: Ekstremizmi i ri ka shumë burime, por mbi të gjitha mungesën e demokracisë. Në ca vende arabe nuk ka shumë liri politike, për ç'arsye disa grupe ndiqen e burgosen dhe detyrohen të punojnë nën dhe. Deri vonë ka dominuar mendimi (i formuluar në Perëndim) se ekstremizmi burimin e vet e ka në varfëri. Kjo ndoshta vllente një kohë, për kampet palestineze e për paralagjet algjeriane e egjiptiane. Mirëpo, sulmet e fundit terroriste në Nju-Jork e Washington kanë dëshmuar diçka tjetër: shumica e terroristëve janë nga Gjiri, ku standardi është më i larti në Botën Arabe, pra nuk janë as palestinezë dhe as algjerianë. Kjo tregon shumë. Për fat të keq, në Botën

Arabe-islame në çerekun e fundit të shek. XX, u shtua shumë qëndrimi antiamerikan, i cili është shumë i rrezikshëm. Kuptohet, në këtë drejtim kanë kontribuar disa faktorë: naserizmi, lufta e ftohtë, politika amerikane ndaj konfliktit arabo-izraelit etj. Tani, me këtë "luftë kundër terrorizmit", është koha të rivlerësohen ca mendime e të hulumtohen ca zgjidhje, sepse mbi të gjitha duhet të ndalet ky qëndrim antiamerikan dhe antiislam që po paraqitet tani në forma të ndryshme.

***Edukata Islame:** Si reagues masat arabe dhe mediat me rastin e tragjedisë që ndodhi me 11 shtator në SHBA?*

Muhamed Mufaku: Arabët, së paku në rrethin ku jam, u habitën shumë nga sulmet që ndodhën më 11 shtator, sepse menjëherë u pa se arabët e muslimanët janë ata që mund të humbin më shumë për këto vepra terroriste që po ndodhin me "emrin" e vet. Arabët e muslimanët gëzonin shumë respekt në Perëndim, kurse tani shikohen ndryshe. Kuptohet, këtu në Aman, sikurse në Beograd, kishte ndonjë me qëndrim antiamerikan, që nuk u mërzi fare, por shumica tani mendojnë se këto vepra terroriste që kryhen në emër të "Islamit", nuk janë në interes të Islamit.

***Edukata Islame:** Perëndimi reagoi ashpër në nivelin shtetëror dhe si popull. A ka gjasë të shkaktohet një konflikt përmasash të gjera midis Botës Islame dhe asaj arabe?*

Muhamed Mufaku: Shumica e Botës Arabe-islame u shpreh kundër veprave terroriste që ndodhën më 11 shtator. Kuptohet, SHBA ka të drejtë të mbrohet pas asaj që ndodhi. Mirëpo, lufta kundër terrorizmit nuk mund të zhvillohet me sukses me një shkallëzim ushtarak kundër Afganistanit. Kam drojën se sulmi ushtarak kundër Afganistanit mund të nxisë më shumë qëndrimin antiamerikan në disa pjesë të Botës Islame, kurse kërkohet që vetë vendet arabe-islame të ndërma-

rrin më shumë hapa për zgjidhjen e problemeve të brendshme që krijojnë ekstremizmin/terrorizmin. Pra, nuk është mirë që "lufta kundër terrorizmit" të zhvillohet ushtarakisht dhe vetëm nga Perëndimi.

***Edukata Islame:** Kosova ende nuk ka status të definuar. Çfarë mendoni, cili do të jetë statusi përfundimtar i Kosovës?*

***Muhamed Mufaku:** Për këtë kam shkruar shumë artikuj gjatë viteve 1999-2001. Megjithë respektin për dëshirën e flaktë të shqiptarëve për pavarësi, statusi i ardhshëm i Kosovës nuk varet vetëm nga shqiptarët. Pra, ka ca faktorë rajonalë e ndërkombëtarë që kanë ndikimin e vet për vendosjen e statusit të ardhshëm të Kosovës. Me fjalë të tjera, gjendja rajonale-ndërkombëtare mund të ndryshohet dhe mund të ndryshojë qëndrimin e vet. Tani jemi dëshmitarë për ca përpjekje që shqiptarët e Kosovës të lidhen me terrorizëm e Kosova të prezantohet si gjoja burim i terrorizmit etj. Si thashë në fillim, nuk më duket më se ka kthim në të kaluarën, se shqiptarët kanë fituar tashmë njëfarë pavarësie, kurse tani mbetet që me zgjedhjet e përgjithshme të tregohet vullneti i shumicës në Kosovë në kushtet demokratike, e të ecet drejt negociatave me Beogradin (nën ombrellën e Kombeve të Bashkuara) për rregullimin e lidhjeve midis dy shteteve të pavarura.*

***Edukata Islame:** Kosovarët janë para zgjedhjeve të para kombëtare pa praninë e ushtrisë dhe policisë serbe në Kosovë, cili është mesazhi i juaj për ta?*

***Muhamed Mufaku:** Shqiptarët janë përsëri në një sprovë të madhe në këto kushte të ndërlikuara. Kuptohet, këto zgjedhje kanë domethënie historike, sepse për herë të parë Kosova zgjedh parlamentin e kryetarin e vet me një legjitimitet ndërkombëtar. Vetëm me një paraqitje sa më demokratike, shqiptarët mund ta bindin botën, sikurse në zgjedhjet lokale, se ata meritojnë atë që gëzojnë të tjerët në Evropë.*

Ernest Gellner

DËSHIMI I MARKSIT DHE SUKSESI I MUHAMEDIT*

Ky artikull është i bazuar në skriptën e një ligjërata të Gellnerit, të cilën e ka mbajtur në tetor të vitit 1995, në Heidelberg, në një konferencë, e cila është organizuar nga Deutsch-Amerikanisches Institut me temën “*Religion als Kultur und Antikultur*” (Religjioni, si kulturë dhe si antikulturë). Me gjasë, kjo ishte ligjërata e fundit e Gellnerit, para se të vdesë, në Pragë, në fillim të nëntorit të vitit 1995. Gellneri, si antropolog dhe filozof i famshëm, shërbeu në Katedrën e parë të shkencave sociale dhe humane në Universitetin e Varshavës. Ky artikull është botuar për herë të parë në *Internationale Zeitschrift für Philosophie*

Shekulli ynë ishte i karakterizuar nga disa ndodhi mbresëlënëse – disa prej tyre të lënë më tepër mbresë, disa më pak. Më tepër bën përshtypje sukcesi i jashtëzakonshëm i islamit në mirëmbajtjen dhe forcimin e tij. Shumica e shkencëtarëve të lëmvive sociale kanë pranuar tezën e sekularizmit, e cila përfaqëson mendimin se në shoqëritë moderne apo të industrializuara ka humbur mbizotërimi i religjionit mbi shoqëri dhe mbi zemrat dhe mendjen e njeriut. Si duket, kjo

duhet të jetë, pak a shumë, e vërtetë, me një përjashtim të imponueshëm në botën e islamit, dominimi i religjionit mbi shoqëri dhe mbi njeriun në njëqind vjetët e fundit, jo vetëm se nuk është zvogëluar, por edhe është rritur.

Një ndodhi tjetër, po ashtu e befasishme, ishte edhe rënia e papritur dhe totale e marksizmit. Marksizmi është krahasuar jorrallë, dhe me të drejtë, me religjionin, madje është përshkruar ndonjëherë si religjion sekular, duke u nisur nga vetitë që ka, si ideja e vizionit total, premtimi për drejtësi në botë, e kështu me radhë. Sidoqoftë, i mungonte një veti e mirëfilltë religjioze. Pas themelimit të religjioneve, ato mishëroheshin në zemrat dhe në mendjen e njeriut, dhe nuk dështonin aq lehtë. Por, nëse pësojnë, atëherë vihet deri te një rezistencë dhe luftë, megjithatë, disa njerëz mbetën në fund ithtarë të denjë të religjionit. Marksizmi ia ka arritur qëllimit, të lë pas vetes një numër çuditërisht të vogël të ithtarëve (...)

Një aspekt tjetër i këtij shekulli, jo aq i befasishëm sa i paparaparë në masë të duhur, ishte forcimi i nacionalizmit. Sidoqoftë, rënia e nacionalizmit është paralajmëruar një kohë të gjatë. Silogjizmi, i cili sjell me veti mbijetesën e nacionalizmit, ka dy veti. Pikësëpari, përfaqësohet prej marksistëve dhe liberalëve, dhe, së dyti, është absolutikisht bindës. Argumenti është tejet i thjeshtë: nacionalizmi varet prej diferencave etnike, kulturore, kombëtare, të cilat shndërrohen në tipare të parimeve të anëtarësisë dhe të besnikërisë politike. Kjo është një e vërtetë e pakontestueshme. Së dyti, kushtet e botës së industrializuar, me qasje drejt mobilitetit, shpërbërjes së komuniteteve lokale, jostabilitetit, dhe standardizimit të komunikimit, zbusin diferencat kulturore, linguistike dhe etnike. Kështu që mund të konkludohet se nacionalizmi në botën moderne është përfundimisht duke u rrënuar shkak i themelit të shpërbërë mbi të cilin është ndërtuar.

Fatkeqësisht, konkluzioni nuk përputhet me faktet. (...)

ISLAMI

Përse, vallë, islami ishte aq i suksesshëm? Pse është rezistues nda sekularizmit? Do të ishte mirë që të fillojë me ofrimin e modelit të formës tradicionale të islamit (duke mos e përfillur pjesën e hershme të islamit). Thënë thjeshtë, islami, së paku në zonën e thatë, në mes të Hindu Kushit dhe Atlantikut dhe lakut të lumit Niger, ishte i ndarë në kulturë të lartë dhe të ulët – islam i lartë dhe islam i ulët – dhe koekzistimi i këtyre të dyve ishte labil. Të shumtën e kohës, qëndronin në raporte paqësore mes veti, megjithatë kishte edhe konflikte në intervale të rregullta. Ndryshimi kryesor i tyre është se islami i lartë nuk pranon ndërmjetësues (ekziston edhe emërtimi mëkatës i ndërmjetësimit: Shirk), derisa bota e islamit të ulët është përplot me ta. Islami i lartë e trimëron lidhjen e drejtpërdrejtë në mes të perëndisë së veçantë dhe besimtarit individual, nuk varet prej ritualit, përmban pak magji dhe besim mbinatyror dhe është në masë të madhe moralizues, skripturalist, puritan, monoteistik dhe individualizues. Është islami i të urtëve – islami i lartë ai që pranohet si i vlefshëm te besimtarët, por nuk praktikohet prej tyre. Nuk praktikohet për arsye që nuk përputhet me nevojat e klasës së ulët dhe myslimanëve ruralë, që për arsye të dukshme e kërkojnë më tepër religjionin Durkheimian – dmth., një religjion ku të shenjtët i kanë ndërmjetësuesit e tyre, inkarnacionin, dhe i cili e pasqyron strukturën sociale. Shumica e myslimanëve ruralë ishin të inkorporuar në tubimet autonome apo gjysmëautonome, vëllazëri fshatare, fise, klane etj. Sa i përket organizimit të brendshëm dhe jetesës, ata e kishin religjionin Durkheimian, ku e shenjtja është e mishëruar në rituale periodike, në objekte të shenjta, në veprime të shenjta, në persona të shenjtë. Mund të thuhet se klasa më e lartë, islami urban, i individualizuar, puritan, “protestant” (që është ngusht i lidhur nga teologët dhe juristët që janë bartësit kryesorë të tij, pa

marrë parasysh mungesën e organizimit qendror dhe çfarëdo sekretariateve dhe klerarkisë qendrore) koekzistoi me islamin e fragmentuar “katolik”, i cili ka tipare “katolike” të hierarkisë, ritualizimit, inkudrimit të formës kuptimore të religjionit, ushtrimeve mistike etj. Këtu mund të shihet se këto përputhen mirë me teoritë e Durkheimit mbi religjionin, duke pasur funksionin e garantuesit, riprodhuesit të dukshëm, dhe legjitimuesit të organizimit komunal në të cilin jetojnë myslimanët. Gjatë qasjeve periodike të vetëreformimit, këto dy forma erdhën deri te konflikti, por, në të shumtën e rasteve, koekzistuan në harmoni. Sa i përket kësaj, unë pajtohem me teorinë, më mirë të formuluar nga David Hume, rreth oscilimit në mes të reformimit të pasuksesshëm dhe rikthimeve në zakonet e vjetra kulturore. Natyrisht se, sa i përket kësaj çështjeje, ekzistojnë dallime specifike në mes të islamit dhe krishterimit të Evropës Perëndimore: në Evropën Perëndimore besnikëria – etike, e ritualizuar dhe klerarkike – është në qendër dhe bartet më tepër nga institucionet se sa nga një doktrinë abstrakte, për arsye se versioni individualist, skripturalist, puritan është i fragmentuar dhe relativisht marginal. Në islam ndodh e kundërta, tradita qendrore është individuale dhe e shkruar, dhe devijimet fragmentale janë hierarkike, të ritualizuara – në një formë pasqyrimi.(...)

Teoria ime, në lidhje me forcimin e çuditshëm të fundamentalizmit mysliman, është si vijon: kushtet moderne humbin qasjen e rrotullimit të këtyre oscilimeve labile dhe definitivisht dhe në mënyrë permanente e zhvendosin qendrën e gravitetit prej islamit të ulët në drejtim të islamit të lartë. Natyrisht, arsyeja përse ndodh kjo, është se procesi i modernizimit i ka shkatërruar komunitetet, të cilat kanë siguruar bazën për stilin e ulët të kulturës së islamit. Duke e shndërruar pjesëtarin e klanit, anëtarin e vëllazërisë, fshatarin dhe pjesëtarin e fisit në kurbetçar punonjës dhe banor të qytetit të barakave, e atomizon popullatën duke i detyruar ata që ta kërkojnë identitetin e tyre në religjion

të lartë, në kulturë të lartë, që siguron një identitet të cilin e ndajnë të gjithë myslimanët, duke i bashkuar kundër të huajve (dorëjashtë). Fillimisht, vendet myslimane nuk kishin identitet kombëtar. Shumica e njerëzve ishin, së pari dhe para së gjithash, pjesëtarë të komuniteteve lokale nën autoritetet lokale. Islami vërtetoi kalimin e këtyre njerëzve prej botës rurale në atë urbane dhe siguroi një idiom për shprehjen e ndryshimeve të statusit të tyre prej fshatarëve injorantë në njerëz të cilët synojnë gjindshmërinë urbane. Po ashtu, u siguron – siç shihet tash në konfliktin e hidhur dhe tragjik në Algjeri – arsyen e kritizimit të sunduesve të tyre aktualë.

NACIONALIZMI

Për mendimin tim, lindja e nacionalizmit në Evropë, nuk duhet të merret në kuptim të ngushtë të tij. Vetë imazhi i nacionalizmit dhe realiteti i nacionalizmit qëndrojnë në kundërtënie. Nacionalizmi është fenomen i Gesellschaft (shoqërisë moderne) që e flet idiomën e Gemeinschaft (komunitetit tradicional). Është produkt anësor i situatës së re, jo i ndryshëm prej asaj që thashë mbi islamin. Roli kryesor i kulturës në shoqërinë agrare është të garantojë, të shprehë, të mëvetësojë statusin e njerëzve në strukturën stabile botërore – dmth, atë, të një shoqërie tejet hierarkike. Identiteti i njerëzve është ngusht i lidhur me pozitën e tyre në shoqëri. Kultura këtë e rifuqizon dhe siguron një formë të jashtme të shprehjes, duke e bërë këtë të dukshme dhe kështu më pak të paqëndrueshme. Kjo, po ashtu, ndihmon pjesëtarin e shoqërisë ta mëvetësojë atë dhe ta akceptojë si një pjesë absolute të raporteve njerëzore.

Në botën moderne, shoqëria hierarkike dhe stabile, është zëvendësuar me përfaqësues të industrializimit të shoqëruar me shkencë dhe me teknologji, me shoqëri mobile dhe anonime, pa ndonjë hierarki të

pranuar, dhe në të cilën puna nuk është më fizike por merr trajtë semantike (dmth., puna është komunikim) dhe, për këtë arsye, përnga kultura, homogjene. Në shoqëritë e përparuara, nuk ka më dallim në mes të kulturës së lartë dhe asaj të ulët, për më tepër, kultura e lartë është kulturë e tërë shoqërisë.

Me “kulturë të lartë” para së gjithash, mendoj për kulturën e lidhur për shkrimi dhe të bartur prej edukimit formal – e jo në prehër të nënës. Ajo duhet të standardizohet nëpër sipërfaqe të mëdha, që njerëzit ta kenë të mundur komunikimin në kuadër të një përmbajtjeje të lirë, sepse situata e marrëdhënies së punës së tyre përbëhet prej komunikimit me njerëz që nuk i njohin, gjegjësit që kryesisht nuk i shohin. Kështu që porosia duhet ta ketë mendimin e kuptimtë, të pavarur prej përmbajtjes.

Për herë të parë në histori, edukimi formal përfshin tërë shoqërinë dhe nuk vazhdon të jetë privilegj i një shtrese të vogël të specializuar të skollastikëve, talmudëve, burokratëve apo juristëve. Kjo është një situatë e veçantë. Mirëpo, pasoja e kësaj është se pjesëmarrja sociale dhe ekonomia efektive, nënshtetësia politike dhe kulturore, është gjendje superioriteti e kulturës së caktuar të lartë. Vazhdimësia e kulturës së lartë është veprimtari e shtrenjtë, e cila ose duhet të ndërmerret prej shtetit ose, së paku, të mbrohet prej shtetit. E gjithë kjo shpie deri te lidhshmëria e shtetit dhe kulturës, e që është esenca e nacionalizmit. Kjo paraqet nacionalizmin e njeriut modern. (Në mënyrë këmbëngulëse e kam refuzuar teorinë konvencionale të nacionalizmit, e cila thotë se është fjala për diçka të brendshme në psikën e njeriut dhe të shoqërisë). Natyrisht që nacionalistët e pranojnë faktin se nacionalizmi – edhe pse, sipas tyre, universal dhe i gjithëpranishëm – për ca arsye bizare ishte në të kaluarën në gjumë dhe duhet të zgjohet që të mund të jetë politikisht efektiv (thënia e zakonshme në Evropën Qendrore dhe atë Lindore është emërtimi i zgjimit – Deutschland erw-

ache! (Gjermani zgjohu)). Në realitet nuk mund të zgjohet, sepse nuk ka ekzistuar fare. Është shpikur në kushtet moderne.

Pse procesi i njëjtë i zhvendosjes prej inkuadrimit në komunitete lokale me theksime të tyre hierarkike të së shenjtës, në ato mobile, anonime, dhe shoqëri sentimentalisht të standardizuara, e ka shprehur vetveten si nacionalizëm në Evropë dhe si fundamentalizëm në botën e islamit? Unë nuk kam për këtë ndonjë përgjigje të qartë. Historia e hershme e nacionalizmit të Evropës kishte, pa mëdyshje, lidhje me protestantizmin. Duket sikurse të ishin që të dyjat të reshtuara përgjatë një vije. Bernard Shaw shprehu shumë mirë argumentin në parathënien e St. Joan (Shën Joana), ku thotë se anglezët e dogjën. St. Joan of Arc si një nacionaliste, gjersa kisha e akuzoi atë si protestante, dhe se ishte që të dyjat. Kjo lidhje në mes të lëvizjeve protestante apo proto-protestante dhe vetëdijes kombëtare, si dhe theksimit në gjuhë zyrtare, shihej posaçërisht në lëvizjen Hussite në Bohemi në shekullin XV. Por, pasi që nacionalizmi përparoi, u nda prej religjionit, ose vetëm e përdori për qëllime oportuniste. Polakët u shërbyen me katolicizmin, sepse fqinjët e tyre në të dy anët nuk ishin katolikë, për këtë arsye, të jesh katolik ishte definim i mirë për të treguar se je polak, dhe natyrisht siguroi një kundërshtar të shkëlqyeshëm kundërshtetëror, kundër-organizativ, gjatë kohës së sundimit komunist. Me kalim të kohës, nacionalizmi dhe doktrina religjioze, janë ndarë nga njëra-tjetra.

Por, në islam nuk ndodh e njëjta gjë. Për një kohë të gjatë nuk dihej se a dominonte fundamentalizmi apo nacionalizmi arab dhe cila ishte në shërbim të tjetrës. Mirëpo, tash për tash, është e qartë se fundamentalizmi është më i fortë se nacionalizmi.

Për mua nuk është e qartë përse lidhja në mes të kulturës së lartë universale të individualizuar dhe doktrinës që ka shërbyer si inspirim, duhet të jetë e ruajtur në islam dhe e shpërbërë në Evropë. Me gjasë është, ndoshta, një fatkeqësi historike. (...)

MARKSIZMI

Nga njëra anë, forcimi i islamit është befasi e madhe e këtij shekulli, ndërsa rënia e befasueshme e komunizmit – përkatësisht të gjithë sovjetologët dhe akademikët sovjetikë nuk kanë mundur ta parashohin – ishte tjetra.

Ekzistojnë edhe më tutje ish-komunistë, mirëpo askush më nuk i përбетohet ideologjisë. Njerëzit vazhdojnë t'i përmbahen kontinuitetit, por askush nuk i përmbahet doktrinës. Përse është kështu? Unë e kam një teori për këtë dhe jam i lumtur që mund ta vë në provë para jush. Ajo që e shkatërroi marksizmin nuk ishte sekularizmi, por në të kundërtën, ishte panteizmi që e trashëgoi nga Spinoza përmes Hegelit. Ideali mesianik bazë i marksizmit – që pati apel të posaçëm për shpirtin rus – ishte që ta bëjë ndarjen e të shenjtës prej paganës në jetën e njeriut. Ideja se bota ishte e dënuar të jetë e përlyer dhe në gjendje të mjerueshme, gjersa të mos arrihet kënaqësia në një rregullimi tjetër, ishte kryesisht refleksion i shoqërisë së ndarë. E ardhmja qëndron në botën e njësuar të konsumit total. Natyrisht që paramendimin e Spinozës, të historizuar nga Hegeli, e kishte marrë Marks.

Në teorinë konvencionale thuhet që njeriu nuk mundet pa religjionin. Në teorinë, të cilën e avancoj unë, ai nuk mundet pa paganen. Dështimi i Marksit të ngulitet në zemrat dhe në mendjet e njerëzve që ishin në mënyrë sistematike të nënshtruar prej propagandës monopolistike të tij, ishte pikërisht shkaku i anulimit të paganizmit. Fakti që të lë përshtypje duket të jetë besimi marksist nuk është shkatërruar gjatë vrasjeve masive dhe të paarsyeshme gjatë periudhës staliniste, por më të tepër gjatë periudhës relativisht të butë dhe përgjithësisht të akceptueshme të stagnimit. Mjafton që të lexohen memoaret e Andrei Sakharovit, që janë një nga raportet më të mira mbi botën sovjetike. Sakharov ishte njeri jashtëzakonisht intelegjent, i cili shprehu mëdy-

shje të madhe për shumicën e tezave individuale të marksizmit. Sidoqoftë, siç thotë vetë në memoaret e tij, ai e akcepton vizion e përgjithshëm. Atje ndodhi një ndryshim radikal i kushteve njerëzore, dhe nëse ishte i saktë çmimi i saktësuar – vrasje masive, marrje të lirisë, përdorimi i punës skllavëruese (ai i dinte të gjitha këto, pasi që kur ai punoi për bombë, u shërbye vetë me punë skllavëruese) – atëherë kjo ishte për të të ardhur keq, por e domosdoshme. Nuk mund të pritët që transformimi radikal të mos jetë i përcjellur me ca gjak. Mjerimi dhe skamja gjatë periudhës stagnuese të Brezhnjevitet, ku shokët ndalën vrasjen dhe filluan ta mitosin njëri-tjetrin, që çoi deri te shpërbërja e besimit, kur Gorbachevi ngriti kapakun, ata përnjëherazi kuptuan se ideologjia e tyre ishte me të vërtetë raft i teshave të reja të imperatorit.

Aq sa mund të vërej unë, ndryshimi në mes të suksesit të islamit dhe dështimit të marksizmit është se marksizmi ishte pikërisht unitar dhe panteist dhe dëshironte të kishte përsosje totale në këtë botë. Botën reale e shndërroi në të shenjtë dhe e asgjësoi zakonet e vjetër të prehjes në qiell. Kjo i takonte pjesës shpirtërore të personalitetit të Marksit, ai ishte borgjez i vendosur. Vizioni i tij për botën ishte përgjithësim i një vizioni borgjez, ku esenca e njeriut është puna – jo agresiviteti, jo burrëria, jo statusi. Përsosja arrihet me punë dhe puna është shpërblim i vetvetes. Borgjezia gjithmonë ka shpresuar se në të ardhmen do të ekzistojë një botë në të cilën mbizotërimi i krimit dhe i mashtrimit, i të kuqes dhe i të zezës, do të zëvendësohet me mbizotërimin e njerëzve që me të vërtetë punojnë.

Kështu, Marksi përcaktoi pikërisht atë për çka borgjezia ka shpresuar gjithmonë. Fshehtësia e vërtetë e historisë është transformimi i marrëdhënieve të punës. Marrëdhënia e njeriut me mjetet dhe me prodhimin është ajo që përcakton ngjarjet. Dhuna shërben vetëm për realizimin e ndërrimeve radikale. Ajo i thotë kriminelit: ti mund të krenohesh me shpatë në dorë, por ti nuk i ke bërë ndërrimet radikale,

ti nuk ke kurrfarë rëndësie. Marksizmi është një fantazi borgjeze, që puna është esenca e njeriut, puna i përcakton marrëdhëniet historike, puna është realizim.

Islami i ka meritat e tij. Është akceptuar në botën moderne, shkaku i refuzimit puritan të tij të magjisë. Në të njëjtën kohë, rregullon jetën. Sidoqoftë, nuk e ka shpallur punën asnjëherë si të shenjtë. Gjatë periudhës së redukuar të smirësisë dhe entuziazmit, myslimani mund t'i kryejë bizneset e veta pa pasur nevojë t'i paramendojë si të shenjta. Dhe, nëse jeta e biznesit nuk është e tëra në botë, ani çka tani? Askush nuk ka thënë se e ka qëllimin të jetë.

Cilat janë mësimet shekullore që duhet nxjerrë, nëse shikohet islami, nacionalizmi dhe marksizmi? Për këtë moment, suksese janë shoqëritë plurale, liberale – atë që unë e quaj aleancë e pashenjtë e jobesimtarëve dhe e mbrojtësve të konsumatorëve. Kjo mund të tingëllojë si nënçmuese, mirëpo unë, në fakt, përkrah ato shoqëri që rregullojnë vetveten në emër të konsumit, të shpresës për një prosperitet të gjithëmbarshëm, dhe të privatizimit, të shpëtimit dhe të virtyteve. Esenca e marksizmit është që ia dha përgjigjen e kundërt sekulare absolutizmit të hershëm teologjik, për shpëtim total – e kjo do të thotë, rregullimin social që është menduar të jetë implementim i moralitetit absolut. Shoqëritë plurale dallojnë prej kësaj, ato jetojnë në njëlloj bote dyhijëshe me një pajtueshmëri në mes të besimeve të trashëguara që nuk merren seriozisht, dhe konsideratës pragmatike ndaj mbrojtëse të konsumatorit që, në anën e tyre, kanë autoritetin por, natyrisht, në vete nuk e kanë çfarëdo lloj aure absolute. Unë nuk mund të them se a mundet një shoqëri e tillë të vazhdojë të ekzistojë, apo a mundet ta mbijetojë untinë e lëvizjes për mbrojtje të konsumatorit. Nuk do duhej të nënçmohej vlera e zbulimeve teknologjike, por, për mendimin tim, ekziston pika e pakësimit të rikthimeve (ekonomi). Shumë pjesë të botës janë të uritura për përmirësimin e gjendjes materiale dhe dalli-

met në mes të atyre që kanë dhe të atyre që nuk kanë janë edhe më tutje të mëdha. Unë nuk mendoj se kjo nuk mund të zgjasë përgjithmonë.

Nga anglishtja: Adnan Dragaj

**Marrë nga: "SHESHI"
Nr. 46 / qershor 2001, Prishtinë*

Mustafa Spahiç

PAMJE TË AMERIKËS

Në SHBA mund të hyhet nga jashtë me ndihmën e morfologjisë shoqërore dhe nga brenda me ndihmën e fiziologjisë shoqërore, që të sajuara përbëjnë bazën morfologjike. E thënë me gjuhën e morfologjisë shoqërore, SHBA-ja është shtet federal i përbërë prej 50 shteteve federale me një sipërfaqe të përgjithshme prej 9.363,387 km², që sipas sipërfaqes dhe madhësisë së përgjithshme është i katërti pas Ruisë, Kanadasë dhe Kinës, në aspektin gjeografik në botë, ndërsa me afro 270 milionë banorë pas Kinës dhe Indisë zë vendin e tretë në aspektin demografik. Duke pasur parasysh se morfologjia shoqërore ka të bëjë me demografinë dhe gjeografinë e qendrave qytetare dhe rurale, për situatën e përgjithshme gjeografiko-demografike të popujve dhe organizimit të tyre, numrin e banorëve, dendësinë e vendbanimit të tyre dhe rënditjen në hapësirën, për SHBA-në, të katërtën sipas madhësisë së sipërfaqes në botë, më e vogël vetëm për 376.613 km² se Evropa si kontinent, në të cilën jetojnë mbi 700 000 000 njerëz ose dy herë më shumë se në SHBA, mund të thuhet se është e banuar rrallë. Përsa i përket rënditjes së banorëve në territorin e SHBA-së, banimi është

jashtëzakonisht i parregullt, - bregdeti lindor në Atlantik me qytetet e mëdha si Nju Jorku dhe me dhjetëra qytete të tjera, bregdeti perëndimor në Paqësor me Los Angjelin, San Franciskon e me dhjetra qytete tjera dhe pjesa qendrore e SHBA-së rreth Liqeneve të mëdha me Çikagon e me dhjetëra qytete të tjera të banuara jashtëzakonisht dendur, e brendia e Amerikës si botë e re në të a.q. "Perëndimi i egër" është e banuar rrallë, mirëpo edhe kjo pjesë prej ditës në ditë me emigrues nga e gjithë bota me plan dhe program po vendbanohet.

Edhe pse SHBA-ja me sipërfaqe është e katërta, me numrin e banorëve e treta, ajo, sipas shkallës së zhvillimit, për shumçka është në vendin e parë në botë. Pa mëdyshje, ajo është fuqia e parë në botë në pikëpamje ekonomike, ushtarake dhe politike dhe vendi i parë industrial e tekniko-teknologjik në botë. SHBA-ja zë vendin e parë për prodhimin e çelikut, automobilëve, autobusëve, furgonëve dhe kamionëve. Ky është vendi që ka ekonominë dhe bujqësinë më të zhvilluar në botë dhe prodhimet më të lira bujqësore. Ka komunikacionin më të zhvilluar rrugor, hekurudhor, lumor dhe detar, ndërsa në industrinë e aeroplanëve dhe komunikacionit ajror, me numrin e aeroplanëve, i cili mbase arrin me qindra mijëra, nëse llogariten aeroplanët e vegjël të udhëtarëve e deri tek helikopterët e "xhamboxhetët" e mëdhenj të udhëtarëve, dhe aeroplanëve ushtarakë, njeriut i duket se SHBA-ja ka më shumë aeroplanë dhe aeroporte se e gjithë bota. Pa kurrfarë teprie, ky është vendi i zogjve të hekurt (aeroplanëve) dhe i pistave prej betoni. Ajo që për Evropën është luks, automobili dhe treni i shpejtë, për SHBA-në aeroplani është mjeti kryesor i udhëtimit për të gjithë njerëzit e klasës së mesme e të lartë. Ky është vendi me rrugë të gjera dhe me shumë kors, me magjistrale të mira e të gjata, nëpër të cilat ditë e natë udhëtojnë dhe bartin mallin kamionët e mëdhenj transportues.

Natyrisht, SHBA-ja është fuqia e parë ushtarake në botë, e para në prodhimin e satelitëve hapësinorë, anijeve kozmike, aeroplanëve ushtarakë, të gjitha raketave, kompjuterëve, mikrollogaritësve, në elektronikë dhe në elektro-industri.

THEMELI MBI TË CILIN MBËSHTETET SHBA

Në dallim nga cilido vend dhe populli i Evropës, SHBA në esencë nuk mbështetet as në kombin, as në ideologjinë dhe as në një konfesion të përfytyruar në kishën si organizatë dinosaurësh, as edhe në shtetin, edhe pse në SHBA ka kombe, po jo kurrsesi në kuptimin evropian; ka edhe ideologji po jo dhe assesi në mënyrën evropiane; ka edhe kisha, por kurrsesi dhe jo në mënyrën evropiane; ka edhe shtete, por jo në mënyrën çfarë janë shtetet në Evropë. Në secilin shtet evropian deklarimi nacional i paraprin atij atdhetar dhe përmes shtetit nacional shteti bëhet instrument dhe mjet i veti. Në SHBA përcaktimi atdhetar si universal, gjithamerikan, paraprin dhe ka përparësi në dallim nga Evropa, ndaj cilitdo përcaktim partikular dhe të veçantë, siç janë ai nacional, etnik, gjuhësor, racial dhe konfesional. Kështu, të gjithë amerikanët në të njëjtën mënyrë gëzojnë dhe në plan të parë vendosin përcaktimin atdhetar, në kuadër të civilizimit gjithëpërmbledhës amerikan: flamurin, himnin, paranë, d.m.th. dollarin, pa marrë parasysh vlerën e tij, pasaportën, ushtrinë, lirinë, demokracinë, kapitalin, të drejtën e zgjedhjes dhe gjuhën angleze si të përgjithshme për komunikim në mes njerëzve, -të gjitha mbi përcaktimet partikulare. Asnjëherë njeriu i kombit më të vogël, ose etnisë, racës a grupit konfesional në Evropë, pas shkatërrimit të perandorive kozmopolite, siç kanë qenë Austro-Hungaria dhe ajo Osmane, sikur në SHBA në mënyrë shembullore dhe të barabartë nuk mund të ndiejë pasaportën, flamurin, himnin dhe paranë, për shkak se në Evropë këto së pari janë

shenja nacionale-ideologjike dhe tradicionale-konfesionale të kornizuara në shtetin nacional, e në SHBA këto janë së pari simbole atdhëtare kozmopolite, si dikur në Perandorinë Austro-Hungareze dhe atë Osmane, ku para të gjithave janë vlerat njerëzore. Ky është vetëm argument se të gjitha shtetet evropiane para së gjithash janë nacionale, pa marrë parasysh fuqinë e zhvillimin e tyre dhe të tjerëve, qofshin të drejtat, liritë, himnin, flamurin, punën, hapësirën, arsimin, i ofrojnë ekskluzivisht nga pozicioni i shtetit të vet nacional. Kush i pranon këto asimilohet, e kush nuk i pranon, ai shtypet.

SHBA-ja si perandori e llojit të vet, as nuk asimilon dhe as bën presion mbi njerëzit, por i integron, kështu që të gjithë ata, pa përjashtim, bëhen amerikanë duke ruajtur veçoritë e veta racore: (indianë, zezakë, melezë, të bardhë, të verdhë), konfesionale: (protestanë, katolikë, ortodoksë, myslimanë, hebrenj), nacional-etnike, popullore, kontinentale dhe përkatësinë rajonale, kështu që SHBA-ja në të vërtetë shtohet dhe funksionon si fe, religjion, gjuhë, racë, popull, etnos, traditë, kulturë dhe doke babilonase. Sikur SHBA-ja, si çdo shtet evropian, të mbështetej mbi kombin, domosdo shumë shpejt do të shkatërrohej. E njëjta gjë vlen edhe për konfesionin. Sikundërqë SHBA-ja nuk mbështetet mbi kombin, po ashtu, në dallim nga shtetet evropiane, nuk mbështetet as në konfesion. Edhe pse në SHBA ka më shumë besime dhe relegjione sesa në Evropë, që janë begati për gjithë qytetarët amerikanë, shteti besimtarët dhe njerëzit religjiozë nuk i mbështet në konfesion, respektivisht në kisha dinosaure të gjithëfuqishme, sikur ndodh në Evropë, kështu që ato kisha si organizata të gjithëfuqishme tek njeriu evropian kanë mbuluar e ngrënë në të edhe besimin edhe religjionin, e edhe religjionin dhe njeriun besimtar e kanë bërë thjesht mjet dhe instrument kisha. Ai që nuk i është nënshtruar konfesionit në Evropë, si laiku dhe sekularisti, patjetër është kurthuar dhe pranguar në ideologji. Argument për faktin se sa u

janë nënshtruar konfesionëve njerëzit në Evropë, janë kishat, e sa ideologjive, janë qëndrimet ndaj historisë dhe të gjitha llojet e doktrinave (fashizmi, nacizmi, komunizmi, kryqëzatat më herët, inkuizicioni), - që të gjitha kanë lindur në trevën evropiane. Në SHBA njerëzit të angazhuar në të tashmen dhe të kapluar me vizionin e së ardhmes nuk kanë kohë të jenë idhujtarë të së kaluarës dhe as frankeshtajnë monstruoz të ideologjive.

Shtrohet pyetja esenciale: Në se mbështetet SHBA-ja, në qoftë se nuk mbështetet mbi asnjërën premisë mbi të cilën mbështeten vendet evropiane?

Ekzistimin dhe funksionimin e SHBA-së është më së lehti ta kuptosh me lëvizjen e gjithësisë. Sikur gjithësia, edhe SHBA-ja është një vend në lëvizje të përhershme të kapitalit, i cili shtohet si kapital me lëvizje të përhershme. Ky shtim i përhershëm përmes punës, prodhimit, tregtisë, ndërrimit të mallit, marketingut, biznesit dhe menaxhmentit quhet *profit*. Në këtë lëvizje dhe shtim të përhershëm të kapitalit, që quhet profit, Amerika para së gjithash dhe mbi të gjitha tregohet si vend i mundësive të shumta dhe të pakufizuara, si për sukses, ashtu edhe për disfatë, vend i punës në funksion të lëvizjes dhe shtimit të kapitalit, vend i interesave të gjithëllojshme, vend i tregtisë së pasur, të madhe dhe të llojllojtë, vend i suksesit të shpejtë e të pabesueshëm, por edhe i disfatës, vend i zgjedhjes fitimprurëse, por edhe i huqjes së papërmirësueshme, vend i investimeve financiare dhe transaksioneve shitblerëse, - sërish të gjitha në funksion të lëvizjes dhe shtimit të kapitalit. Për këtë arsye, Amerika është vend i menaxherëve, biznesmenëve dhe njerëzve afaristë nga e gjithë bota. Të gjithë ata, përmes lëvizjes së kapitalit dhe shtimit të tij, dëshirojnë të realizojnë profitin. Të varur nga realizimi i profitit gjatë lëvizjes dhe shtimit të kapitalit, secili njeri në SHBA, për çdo ditë ose e fiton, ose e shton, ose e dobëson, ose e humb funksionin e vet në shoqëri.

Fitorja, humbja, shtimi a humbja e funksionit në shoqëri, - në SHBA jashtë fitimit të profitit përmes lëvizjes dhe shtimit të kapitalit, nuk është e lidhur me asnjë tjetër përcaktim. Për këtë shkak në Amerikë vlerësohet ekskluzivisht dija, puna dhe sukcesi, e askush, madje askush, nuk i merr parasysh, nuk i vlerëson e as që paguan për prejar-dhjen, fisin, kastën, racën, titullin, diplomën, mjeshtrinë, në qoftë se prapa mjeshtrisë, titullit, në të vërtetë nuk qëndron dija e zbatueshme praktikisht dhe funksionalisht.

Përsa i përket numrit të madh të inteligjencies, njerëzve me arsim fakulteti në socializëm, për ata në Amerikë vlen një proverb - të shkol-luar gjatë dhe shumë, pa dije për të punuar punë konkrete dhe të dob-ishme, e vetëm paraja, e cila është rezultat i profitit me anë të lëvizjes dhe shtimit të kapitalit, flet për papunësinë, qoftë edhe me diplomë, pa mbulesë të djersës dhe harxhimit të tyre.

Që ta kuptojmë Amerikën si sistem, si rend e rregull, medoemos duhet ta kuptojmë teorinë e funksionalizmit, përfaqësues më i njohur dhe më i potencuar i së cilës është Talkot Parsons (Talcot Parsons). Funksionalizmi në esencë mbështetet mbi dy premisa të pastudiuara: shoqëria në esencë është organizëm harmonik dhe funksional (jo në pikëpamje ideore, ideologjike, kombëtare, konfesionale, racore, gjuhësore, kulturore, arsimore-shkollore - si në Evropë), ndërsa uniteti është karakteristika themelore e tij. Secili individ, secila pjesë, institut a ent kryen ndonjë funksion pozitiv, që është kontribut për mbajtjen, përparimin, begatimin dhe financimin e strukturës ekzistuese, respektivisht kthimin përherë tek ajo, sikur lëvizja e gjithësisë në gjendjen e mëhershme të ekuilibrit. Funksioni i secilit individ dhe i secilës pjesë është pozitiv, në qoftë se përmes tij në lëvizjen dhe shtimin e kapitalit realizohet një profit më i madh. Shoqëria në esencë është sociale (jonacionale, joideologjike, jokonfesionale - si në Evropë), sistem, i cili sipas Prasonsit, përbëhet nga aksioni social. Aksioni social përbë-

het prej tri elementeve qenësore përbërëse: individit, aksionit dhe situatës e ambientit.

Veçori e aksionit shoqëror është vetëm sjellja dhe veprimtaria që është e motivuar dhe e drejtuar nga ndonjë cak dhe ajo, nga caku brenda kornizave të lirisë, në mesin e shumë alternativave, zgjidhet si më e dobishmja për shoqërinë dhe më e përshtatshme për veten. Më së miri nga mësimet e funksionalizmit shihet se Amerika fillon nga individi dhe aksionet e tij në ambientin e zgjidhjes së lirë, me prioritet dobinë e atdheut me anë të tatimit dhe për të mirën e vet, ndërsa Evropa fillon nga grupet (kombi, etnosi, konfesion) në dobi të shtetit nacional e jo të atdheut për gjithë qytetarët.

Brenda shoqërisë si sociale (joklasore, joracore, joideologjike, jokonfesionale, jonacionale e jo me prioritet ndaj politikës, edhe pse të gjitha këto i ka), sistemin e përbën gjithmonë e njëjta strukturë bazore dhe substancë themelore e pandryshuar dhe e pazëvendësuar, e kjo është lëvizja e përhershme e kapitalit, i cili me anë të lëvizjes, dinamikës, aksionit, investimit, rrezikimit, hulumtimit të tregut, marketingut, menaxhmentit dhe biznesit pandërprerë në bursat e Nju-Jorkut dhe Çikagos, si podiume lëvizëse, skenave e arenave, - shtohet përmes profitit dhe kalon nga njëri në dorën e tjetrit. Atje, siç e vëren Alen Ford, vlen deviza themelore: *në qoftë se dëshiron të fitosh, nuk bën të humbasësh.*

Në një sistem të tillë social kanë të ndërtuar, mbase mekanizma të padukshëm të cilët gjithmonë të kthejnë tek përcaktimi i mëhershëm, cilësorisht në gjendje të njëjtë, në gjendje baraspeshe ose ekuilibri vetëm me kapital të shtuar të realizuar përmes qarkullimit, shtimit dhe profitit, derisa ndonjë institucion, ent dhe funksion ekziston në sistemin e tillë, kjo nga vetvetja është argument se kryen funksion konkret të përcaktuar dhe paraqet pjesë të domosdoshme brenda tërësisë ose strukturës sociale të sistemit. Në qoftë se ndodhin

ndryshime në shoqëri, ato nuk e ndryshojnë dhe në përgjithësi nuk sjellin një tip dhe formë të sistemit social (lëvizjen e pandërprerë, shtimin dhe begatimin e kapitalit me anë të profitit), por i shërbejnë përforcimit, begatimit dhe fuqizimit të sistemit ekzistues dhe kthimit të shoqërisë si sistem social dhe struktura në baraspeshën e mëparshme. Të gjitha ndryshimet (natyrisht sasiore nga jashtë dhe karakteri funksional) janë në kuadër dhe në dobi të sistemit, e jo kundër tij. Ndryshimet sasiore të përcaktuara në shoqëri si sistem social, me anë të shumë funksioneve në shumë shoqëri, të cilat shtohen proporcionalisht me zhvillimin e shoqërisë dhe shtimin e kapitalit me anë të qarkullimit të tij, ndodhin pandërprerë, jo që ta ndryshojnë, po që në kuptimin cilësor dhe esencial ta mbajnë gjithnjë ashtu çfarë është. Të gjitha ndryshimet në shoqëri, nga jashtë dhe të karakterit funksional, kanë rol që të ruajnë baraspeshën dinamike të sistemit social dhe strolullën e tij, në të cilin çdo gjë mbështetet në qarkullimin, në shtimin dhe në rritjen e kapitalit me anë të profitit dhe shërbejnë për adaptimin dhe perfeksionimin e formave ekzistuese shoqërore. Ato ndryshime sasiore dhe funksionale janë: kurorëzimi, punësimi i forcave të reja, të lira, ekonomike dhe funksionale, hulumtimi i prodhimeve të reja dhe shtrirja në tregjet e reja të mundshme në mbarë botën, kryerja e shkollave dhe fakulteteve, punësimi i njerëzve, pa marrë parasysh kush janë dhe nga janë, me të cilët arrihen funksione të reja përmes të cilave të realizohet një profit më i madh me harxhime më të vogla, por me rrezikim të madh. Për këtë arsye në Amerikë, natyrisht nga jashtë përherë gjithçka ndryshon vetëm që të qëndrojë dhe të ruhet gjithçka nga mbrenda me anë të barazpeshës dhe unitetit funksional në organizimin harmonik. Kështu Amerika ndryshohet përherë nga jashtë vetëm që nga brenda të jetë e njëjtë. Ndryshimi i vetëm cilësor dhe esencial në Amerikë do të ndodhte nga mbrenda, në qoftë se do të arrihej në vendnumërim në

lëvizje, në shtim dhe në rritje të kapitalit. Atëherë ky vendnumërim do të paralajmëronte fundin e civilizimit dhe sistemit social, i cili është i mbështetur mbi ato premisa.

Pikërisht për këtë arsye, vështruar nga ana e jashtme, Amerika është vendi i dinamikës, i lëvizjes, i aksionit, i ndryshimit, i spektaklit, i marketingut, i biznesit, i shpalljes, i çregjistrimit, i rrezikut, i humlunit, i reklamës, i transparencës, i filmit, i modës, i inovacioneve dhe i informacioneve të përhershme, e që të gjitha këto janë në shërbim të asaj lëvizjeje të njëjtë e të pandryshuar, të shtimit dhe rritjes së kapitalit. Nga ana tjetër, vështruar në rrafshin e brendshëm vertikal, Amerika është vend stabil konservativ, tradicional, konsistent dhe konsekuent. Ilustrim i këtyre janë faktet se ajo me shekuj nuk ndryshon Kushtetutën, parimet themelore politike dhe ato moralo-etike. Kështu, vetëm nga jashtë shoqëria amerikane është mbase më dinamikja në botë, sepse nga brenda është më konservativja. Prandaj, vallë, mos e habit ndokënd fundamentalizmi protestant, i cili ka kërkuar kthimin në burimet themelore fetare të Biblës dhe ortopraktikës, si në shekullin XIX, që u shfaq në trevën e Amerikës? A e habit ndokënd se sipas rregullit në filmat amerikanë paraqitet kurorëzimi në kishë, betimi në Bibël dhe riti i kryqëzimit? Në qoftë se paraqitet se ndonjë institucion, ent a individ, që largohen nga sistemi social pushtetmbajtës, nuk i shërben funksionalizmit të tij, përmbajtjes dhe forcimit ose i kundërvihet, atëherë ai trajtohet si devijim, deformim dhe përjashtim patologjik, i cili duhet mënjanuar me ndërhyrje kirurgjike. Në ato dhe të tilla pikëpamje, në Amerikë, secili njeri ose mëson, ose studion, ose punon, ose bën biznes, ose profesionalisht merret me politikë e diplomaci, ose shikon televizionin, ose pushon në natyrë. Për shkak të hapësirave të gjera dhe largësisë nga vendi i vendbanimit deri te sipërmarrja, aty, këmbët më të mira janë katër rrotët. Në Amerikë dhe të tilla vende, secili duhet të dijë të ngasë

automobilin, të ketë mjeshtëri dhe punë, dhe që të komunikojë, duhet ta njohë gjuhën angleze. Amerika është vend në të cilin secili medoemos duhet të punojë diçka, në qoftë se nuk është fëmijë, plak a i sëmurë kronik.

Amerika është vend i cili i ofron punë secilit, ndërsa mëshirë dhe humanitet nuk i jep askujt, përveç atyre që u takon me të vërtetë. Në Amerikë ka njerëz të mençur dhe të arsimuar. Ky është vendi që në masë të madhe i ka ruajtur qytetarët e vet nga kotësia, nga të folurit e rrejshëm dhe koha bosh. Natyrisht, në nëntokën e Amerikës ka drogë, vese, homoseksualizëm, bixhoz, prostitucion dhe alkoolizëm. Mirëpo, në rrugë nuk ka njerëz të dehur, madje askund në vende publike, dhe sidomos jo në punë, nuk gjenden lehtë pijetoret dhe mejhanet.

VENDI I LIGJSHMËRIVE

Shtrohet pyetja themelore: Si është e mundur që në SHBA, në vendin e shumë popujve, etnive, religjionve, gjuhëve, traditave, të ketë aq funksione të tilla dinamike që përbëjnë strukturën e sistemit social në raport me të gjithë individët, veçoritë, partikularitetet dhe laramanitë në të gjitha bazat e mundshme, dhe gjithë kjo brenda kornizave të lirisë?

Kjo arrihet, para së gjithash, me vendosjen e prioritetit absolut, të sistemit dhe tërësisë mbi të gjitha individualitetet dhe veçantitë. Sistemi (atdheu, flamuri, himni, dollari, qarkullimi i kapitalit dhe profiti) është gjithçka, ndërsa secili individ apo grup, pa marrë parasysh kush janë dhe nga janë, janë në funksion të sistemit. Për këtë arsye funksionimi i sistemit si tërësi ka përparësinë absolute mbi secilin individ, pjesë apo institucion. Të gjithë, me doemos, duhet t'i shërbejnë tërësisë dhe funksionimit të saj, sepse ç'është e mirë për sistemin, automatikisht është e mirë edhe për individët dhe pjesët e

sistemit. Që këtë ta dinë të gjithë qytetarët, Amerika, në të vërtetë është vend i procedurës së thjeshtë dhe të qartë ligjore. Asgjë pa të nuk mund të ecë dhe të kalojë. Krahas kësaj, Amerika është vend i disiplinës financiare, afariste dhe tatimore. Kush zihet një herë duke vjedhur në Valstrit, ai në botën afariste, ekonomike dhe të biznesit është i vdekur, derisa të jetë gjallë.

Edhe ai që nuk i paguan tatimin shtetit, konsiderohet armik i shtetit dhe hajn. Karriera e tij publike me atë veprim është varrosur. Sipas së njëjtës logjikë, Amerika, në një masë, është vend i informimit objektiv, me kohë (edhe mund të mos jenë të vërteta), dhe shembullor për situatën. Ky informim u përgjigjet gjashtë pyetjeve: kush, çfarë, ku, si, kur dhe pse.

PËRPARËSIA E AMERIKËS DHE E DEMOKRACISË AMERIKANE NË RAPORT ME EVROPËN

Përparësia e parë e SHBA-së në raport me Evropën mbështetet në faktin se ato janë gati më të mëdha dhe më të pasura sesa të gjitha shtetet e Evropës së bashku. Përparësia e dytë mbështetet në të parën, sepse ajo në sajë të pasurisë së vet, sipërfaqes dhe dyfish me më pak banorë, është lënë e hapur dhe mund të pranojë emigrantë të rinj të arsimuar, më shumë se të gjitha shtetet evropiane së bashku. Përparësia e tretë rjedh nga e dyta; Amerika është vend i një popullsie më të re e më të aftë sesa vendet e Evropës. Përparësia e katërt e Amerikës në raport me Evropën, mbështetet në faktin se Amerika është vend i njerëzve më ndërmarrës dhe më konkretë nga e gjithë bota, ndërkaq në vendet evropiane mbisundojnë njerëzit ose të një kombi, ose të një konfesionit. Edhe pse Amerika është Babiloni, besime shumë, religjione (pa konfesionet e gjithëfuqishme, siç janë në Evropë), shumë raca, etni, popuj, gjuhë, tradita, doke dhe kultura,

megjithatë, të gjithë qytetarët e atij vendi i lidh tregu i përbashkët, i cili është plotësisht i hapur dhe i lirë, si dhe ligjet, rregullat, dokumentet dhe procedurat e njëllajta atdhetare. Kështu, Amerika ecën në minimumin e asaj që njerëzit i bashkon dhe këtë e thekson në plan të parë, e jo ato që i ndan dhe i përqaan ata. Fatkeqësisht, edhe ligjet, edhe tregu, edhe dokumentet, në vendet evropiane, edhe sot e kësaj dite, në dallim nga Amerika, së pari janë kombëtare e pastaj atdhetare, për të gjithë qytetarët. E kjo është sikur dallimi në mes të ligjit e demokracisë dhe ligjit e aristokracisë, për se shkruan *Alexis de Tocqueville* në veprën "*De la democrate en Amerique*". Ligjet e demokracisë amerikane shpesh janë të mangët apo jo të plota. Ndodh që t'i thyejnë të drejtat e arritura ose t'i sanksionojnë në mënyrë të rrezikshme. E nëse janë të vlefshme, shumësia e tyre do të ishte, hëpërhë, një e keqe e madhe. Gjithë kjo hetohet mënjëherë. Atëherë, nga buron qëndresa dhe përparimi i republikave amerikane? Në ligjet duhen dalluar me kujdes qëllimi dhe mënyra si ecin nga ai qëllim, si dhe vlefshmëria absolute e tyre nga ajo që është relative. I marrë për supozim, qëllimi i ligjdhënësit është që të shpjerë përpara interesin e një numri të vogël njerëzish në dëm të shumicës. Këto përcaktime janë kombinuar ashtu që të arrijnë rezultatin e paramenduar në një kohë sa më të shkurtër dhe me përpjekje sa më të vogla. Ligji do të hartohet mirë, e qëllimi i tij do të jetë i keq. Ai do të jetë i rrezikshëm në krahasim me efikasitetin e vet. Ligjet e demokracisë synojnë, përgjithësisht, të mirën e shumicës së njerëzve, sepse ata burojnë nga shumica e qytetarëve, të cilët mund të mashtrohen, mirëpo, ata nuk do të kenë interes të kundërt me vetveten. Përkundrazi, ligjet e aristokracisë synojnë që në duar të një numri të vogël njerëzish të monopolizojnë pasurinë dhe pushtetin, sepse aristokracia gjithmonë, sipas natyrës, përbën pakicën. Pra, mund të themi, përgjithësisht, se qëllimi i demokracisë në ligjdhënien e saj është dobishmëria më e

madhe për njerëzimin sesa qëllimi i aristokracisë. Mirëpo, me këtë përfundojnë përparësitë e saj. Aristokracia është e aftë pafundësisht në njohjen e ligdhënies në krahasim me demokracinë. Sunduese mbi veteveten, ajo nuk u është nënshtruar synimeve të përkohshme. Ajo ka plane afatgjata, të cilat di t'i lërë të piquen gjithnjë, derisa të mos vijë rasti më i mirë. Aristokracia sillet me mençuri: ajo e di aftësinë që, në të njëjtën kohë dhe të njëjtin qëllim t'i përqendrojë forcat kolektive të të gjitha ligjeve të saj. Kështu nuk është në demokraci. Ligjet e saj janë gati gjithnjë të mangëta dhe të papërshtatshme. Mjetet e demokracisë, pra, janë më të përkryera nga mjetet e aristokracisë. Ajo shpesh, duke mos qenë e vetëdijshme, punon kundër vetes. Mirëpo, qëllimi i saj është më i dobishëm. Imagjinoni shoqërinë a kushtetutën e saj, të cilën e ka organizuar natyra, ashtu që të mund ta bartë ndikimin e përkohshëm të ligjeve të këqija dhe nga të cilat mund të presë rezultatin e tendencës së përgjithshme të ligjit, duke mos iu ekspozuar rrezikut-dhe ju do ta kuptonit se sistemi demokratik, krahas mangësisë të veta, edhe më tutje është më i përshtatshmi (sepse është më i natyrshmi) që ta shpjerë atë shoqëri përpara. Pikërisht kjo po ndodh në SHBA. E përsëris këtu atë që kam thënë tjetërkund: *"Përparësia e madhe e amerikanëve është se mund t'i përmirësojnë gabimet"*.

Ligjet e secilit shtet evropian, sepse janë kombëtare, janë aristokratike, ata sipas qenësisë së vet përpiqen që pasurinë dhe pushtetin ta sigurojnë për kombin përballë tërësisë së qytetarëve, e ligjet e Amerikës, sepse janë demokratike dhe nga shumica e qytetarëve kanë për interes dhe qëllim të gjithë qytetarët. Ligjet në aristokraci aprovohen lehtë, mirëpo, ligjet e demokracisë janë afatgjata dhe sipas qëllimit më përfshirëse. Kështu edhe në karakterin e ligjit është një përparësi e madhe e Amerikës ndaj shteteve evropiane. Përparësi jo e vogël që pason e Amerikës ndaj Evropës janë vetë njerëzit. Në Amerikë njerëzit janë më të thjeshtë, më të natyrshëm, më spontanë, më të drejt-

përdrejtë, më komunikativë, më të relaksuar në komunikim, më shërbyes, më të besueshëm, më ndërmarrës dhe më të sigurt në veten sesa në Evropë. Më tutje, edhe kjo është përparësi, sepse në Amerikë asgjë s'është e turpshme dhe nënshtruese të punosh atë që sjell dobi materiale e që nuk është sipas ligjit e ndaluar dhe e dëmshme. Përparësia tjetër e Amerikës mbështetet në faktin se është shtet realist e jo idealist. Secili që shkon në Amerikë me iluzione, me imagjinatë, me fantazi, me utopi dhe me kërkesa pa mbulesë, do të sharrojë në to. Sepse është vendi i njerëzve realistë dhe konkretë, Amerika kurrë nuk ka qenë vend i magjistarëve të mëdhenj, i misionarëve, i mesianëve, i poetëve, i filozofëve, i imagjinuesve, i idealistëve, i utopistëve dhe i fanatikëve të mëdhenj. Ky është vendi i punës: i kapitalit, i mësimit dhe i hulumtimit. Përparësia tjetër e Amerikës ndaj Evropës është shkalla e arritur e higjienës publike. Higjiena civilizuese në Amerikë është realizuar në rrafshin e përgjithshëm-në nivel vendi, veçanërisht-në nivel të secilit shtet federal, të firmave dhe në atë individuale-në nivel të secilit individ. Kështu, secilit individ që vjen i papastër dhe i ndytë në punë, i tërëhiqet tri herë vërejtja dhe kthehet nga puna, e herën e katërt përjashtohet me karakteristika të përhershme negative. Më shumë se Evropa, Amerika është mbrojtur nga morali publik dhe konkret, nga prostitucioni, mashtrimi dhe keqpërdorimi i grave në shfrytëzimet seksuale nga pozita e funksionit dhe nga ajo e kapitalit posedues. Amerika është vendi i materiarkatit të llojit të vet, në të cilin gruaja është e mbrojtur nga çdo lloj sulmi. Në Amerikë më shumë se në Evropë janë të mbrojtura: jeta personale, private dhe intime. Nuk ka nuhatje në gjëra të huaja, në punë, në gjëra private dhe në jetën intime. Amerika nuk i zgjidh problemet personale dhe sociale të askujt në mënyrë evropiane, por ofron korniza, profile, forma dhe mundësi të zgjidhjes së tyre përmes lirisë, alternativës dhe iniciativës individuale, natyrisht, gjithmonë shoqëruar me rrezikun dhe me har-

xhime personale. Në të njëjtën frymë, Amerika nuk i ofron e as që i imponon askujt asnjë religjion, mirëpo, secilit përmes lirisë, koekzistencës, ia pranon dhe i liron nga tatimi për blerjen e objekteve fetare dhe u ofron korniza e mundësi të njëjta. Prandaj ajo është vendi i njerëzve, që krahas besimit në zemër të atyre që dëshirojnë të besojnë dhe njerëzve religjiozë, të cilët ritet religjioze i kryejnë në qindra mijëra tempuj të lloj-llojshëm. Përparësi tjetër e Amerikës ndaj Evropës është se ajo është plotësisht vend i hapur me mundësi të panumërta dhe të pakufizuara, si për sukses ashtu edhe për humbje. Në këtë kontekst, disa boshnjakë në Amerikë, në dallim nga pakistanezë, arabë, iranianë dhe myslimanë të tjerë, të cilët e marrin Amerikën vetëm nga jashtë, në rrafshin e civilizimit dhe të gjitha begatitë të saj, Amerikën e pranojnë në vete nga brenda dhe kështu e humbin identitetin e vet dhe nuk udhëhiqen nga civilizimi amerikan, por në të në vend që të integrohen, asimilohen.

DOBËSITË DHE MANGËSITË

Rreziku i parë dhe më i madh që kërcënon Amerikën, është ndalja eventuale e lëvizjes së rritjes dhe shtimit të kapitalit. Kjo do të ishte fillimi i fundit të civilizimit, kulturës, rendit dhe sistemit, i cili mbështetet në atë themel qenësor dhe themelor. Rreziku i dytë i mundshëm, konkret dhe kurtha që kërcënon Amerikën dhe demokracinë e saj, mbështetet në faktin se Amerika sot, siç do të thoshte Bushi, është fuqia e vetme botërore, në të vërtetë e vetmja perandori botërore, e cila si perandori e jo si shtet, nuk ka me kë të krahasohet, përveç me vetveten, e krahasimi me vetveten u ka kushtuar të gjitha vendeve socialiste- vetëshkatërrim dhe vetërrënim. Çfarë do të thotë kjo në fushën e lirisë, demokracisë dhe të drejtave të njeriut, ftojme sërish në ndihmë Alexis de Tocquevillin.

"Ajo që më së shumti ia shoh për të madhe sistemit demokratik, i tillë çfarë është organizuar në SHBA, nuk është, sikur që pohojnë shumë njerëz në Evropë, dobësia e tij, por e kundërta, forca e papërballueshme e tij. E ajo ndaj së cilës më së shumti janë refuzues në Amerikë, nuk është liria përfundimtare e cila sundon aty, por e kundërta, garancia e vogël kundër tiranisë, e cila ekziston aty. Kur një njeri ose parti vuan nga padrejtësia në SHBA, kujt dëshironi t'i drejtoheni? Opinioni? Po, këtë e përbën shumica. Trupit ligjdhënës? Ai përfaqëson shumicën dhe i nënshtrohet symbyllur. Pushtetit ekzekutiv? Shumica e emëron dhe ai shumicës i shërben si mjet pasiv. Ushtria publike? Ushtria publike nuk është asgjë tjetër, pos një shumicë nën armë. Porotës? Porota-kjo është shumica e furnizuar me të drejtën për shpalljen e aktgjykimeve; madje, në disa shtete vetë gjyqtarët i ka zgjedhur shumica. Sado që të jetë e padrejtë masa që ju godet, medoemos, duhet pra t'i nënshtroheni. E kundërta, supozoni trupin ligjdhënës, i cili është strukturuar që të përfaqësojë shumicën, e që të mos jetë medoemos rob i epsheve të veta, pushtet ekzekutiv, i cili ka forcën e vet dhe pushtetin ligjdhënës e që është i pavarur nga te dyjat. Ju megjithatë, do të keni sistem demokratik, mirëpo në të, përgjithësisht, nuk do të ketë shans për tirani. Nuk pohoj se sot në Amerikë zbatohet shpesh tirania. Vetëm se pohoj se në të nuk shihet garanci kundër tiranisë dhe se në të është e nevojshme të kërkohen shkaqet e butësisë së qeverisë ndaj rrethanave dhe traditave përpara se me ligjet".

Pasi parimet themelore politike evropiane mbështeten në naciokraci, partikraci, ideokraci, teokraci, ose, në rastin më të mirë, në aristokraci, e ai amerikan në demokraci, që në esencë është përparësia e saj themelore në raport me të gjitha parimet politike evropiane, megjithatë, edhe demokracia i ka kufijtë e vet, kurthas dhe mangësitë që De Touckuevilli i vëren në ato që pasojnë:

"Personalisht e konsideroj djallëzore dhe të ndrydhur atë parim, sipas të cilit, në politikë, shumica e popujve kanë të drejtë të bëjnë gjithçka, mirëpo në dëshirën e shumicës e vendos prejardhjen e secilit pushtet. A jam me këtë në kontradiktë me vetveten? Ekziston ligji i përgjithshëm, të cilin e ka hartuar ose së paku e ka pranuar jo vetëm shumica e popullit përkatës, por shumica e mbarë njerëzimit. Ai ligj është drejtësia. Drejtësia (nomokratia - në Islam - Sheriati), pra përku-fizon të drejtën e secilit popull. Një popull është si porota, e cila është e autorizuar të përfaqësojë shoqërinë në përgjithësi dhe të ndryshojë të drejtën, e cila bëhet ligj i tij. Pra, porota, që përfaqëson shoqërinë a duhet të ketë pushtet më të lartë sesa vetë shoqëria me ligjet që ajo zbaton? Pra, kur nuk pranoj t'i nënshtrohem ligjit të padrejtë, atëherë nuk ia mohoj të drejtën shumicës që të sundojë. Unë me këtë në vend të suverenitetit popullor mbështes suverenitetin njerëzor. Pra, konsideroj se gjithnjë diku duhet të vendoset ndonjë pushtet shoqëror, i cili të ishte mbi gjithë të tjerët, ose konsideroj se është rrezikuar liria kur ky pushtet të mos ketë para vetes kurrfarë sfidash që do të mund ta ndalonin në ecjen e tij (*"...sikur Allahu të mos i zbrapste disa njerëz me disa të tjerë, do të ishin shembur deri në themel manastiret, kishat, havret si edhe xhamitë në të cilat përmendet me të madhe emri i Allahut..." Kur'an, 22:40*) dhe t'i jepet kohë që vetvetes t'ia zvogëlojë".

Kurtha, provokimi dhe rreziku i llojit të veçantë për Amerikën, e me të edhe për gjithë botën, është edhe për shkak se ajo si fuqi e vetme, në të vërtetë perandori e botës, në vend të bipolaritetit botëror mund të përpiqet të vendosë monopolitetin botëror; në vend të dialogut-monologun; në vend të unitetit në dallime-monopolin; në vend të ekuilibrit dhe baraspeshës-unifikimin, vesterizmin, diznilendizmin, ekranizmin, filmizmin, farmerkanizmin, kokakolizmin dhe mikimauizmin. Si fuqi e vetme, Amerika krahasohet dhe matet me vetveten, që

mund të jetë një rrezik shtesë për gjithë botën. Me të maten dhe krahasohen të gjitha vendet e botës, e kjo, deshën s' deshën amerikanët, shpie në një lloj ndjenje të gjithëfuqishmërisë.

"Gjithëfuqishmëria nga vetvetja (shkruan De Tocquevilli) më duket e keqe dhe e rrezikshme. Realizimi i saj më duket se është mbi fuqinë njerëzore, cilido njeri qoftë: (*"...Sikur Allahu të mos i zbrapste njerëzit, njerën palë me të tjerët, me të vërtetë toka do të shkatërrohej, por Allahu është i mirë për gjithë botët"*). Kur'an, 2:251) dhe konsideroj se vetëm Zoti mund të jetë i gjithëfuqishëm pa rrezik, sepse Urtia dhe Drejtësia e Tij gjithmonë janë të njëjta në sundimin e Tij. Pra, në tokë nuk ekziston një pushtet i cili nga vetvetja të ishte aq i denjë për respekt, apo i cili të kishte një të drejtë të tillë të paparashikuar që t'i lejohej të vepronte pa mbikëqyrje dhe të sundonte pa pengesa. Posa të shohë që e drejta dhe aftësia bën gjithçka, çfarëdo pushteti qoftë, le të quhet ai pushtet popull ose mbret, demokraci a aristokraci, të zbatohet në monarki a republikë them: aty është fara e tiranisë dhe do të përpiqem të shkoj të jetoj nën qeverisjen e disa ligjeve të tjera".

Tri dobësi të tjera të Amerikës burojnë nga vetë themeli mbi të cilin ajo mbështetet - lëvizja e përhershme, shtimi dhe rritja e kapitalit. Lëvizja e përhershme, shtimi dhe rritja e kapitalit përmes profitit me anë të konkurrencës në tregun botëror, me vetëdije, me qëllim, metodikisht dhe sistematikisht injoron dhe vë në plan të dytë politikën sociale, shërimin dhe shëndetësinë, e konkurrenca e pamëshirshme në arritjen dhe rritjen e kapitalit në tregun botëror të materializmit, njerëzit i krijon, i aftëson dhe fetishizon marrëdhëniet e tyre reciproke. Sikur që të gjitha shtetet evropiane janë nacionale, ashtu Amerika është një perandori demokratike. Ashtu sikur shtetet evropiane bëjnë politikën sociale dhe politikën e solidaritetit social, Amerika bën politikën të punësimit të përgjithshëm dhe të ndihmës minimale sociale, vetëm

që të jetohet për ata që nuk mund të punojnë. Ashtu sikur të gjitha shtetet evropiane që kanë të zhvilluar rrjetin e përgjithshëm të mbrojtjes mjekësore dhe shërimin e të sëmurëve me harxhimet e popullit dhe të shtetit, në Amerikë shteti u paguan shërimin më minimal kategorive të rrezikuara, e shërimi në të vërtetë mbështetet mbi barrën e secilit individ. Shërimi në Amerikë për një evropian, sidomos për ata që kanë jetuar në socializëm, është një problem i pazgjidhur. Si dhe kujt prej atyre njerëzve t'ua sqarosh se operacioni i tëmthit dhe shtrirja në spital për njëzet e katër orë paguhet 4000\$, e një ditë në maternitet 5000\$? Në Amerikë është shtrenjtë të jesh i sëmurë, është me rrezik mossigurimi i gjithë pasurisë, mirëpo, sigurimi po ashtu kushton, dhe nuk ke hesap të jesh pensionist, sepse pagesa është simbolike. Për këtë arsye në Amerikë secili kujdeset me përpikëri për shëndetin e vet dhe e ruan punën që të mos e humbasë, gjithnjë derisa të mund të punojë, pa marrë parasysh moshën. Në thelb, Amerika është vend i konkurrencës dhe i punësimit të njerëzve, e jo vend primar i solidaritetit social. Për këtë arsye çrregullimet e mëdha sociale, mosmarrëveshjet, konfliktet dhe ndeshjet do të ishin rrezik i madh për atë vend, sepse ato do t'i ashpëronin dhe shtonin të gjitha dallimet e tjera në mes njerëzve, siç janë: racore, profesionale, etnike, gjuhësore, kulturore, klasore, tradicionale dhe rajonale. Kurtha e tretë dhe rreziku për Amerikën që rrjedh drejtpërdrejt nga lëvizja e kapitalit, është se me lëvizjen imponohet dinamika e jetës, vrapi për fitim, ekzistenca, shtimi dhe përmes profitit të shtimit të pasurisë dhe me realizimi i interesave materiale. Dinamika e tillë e imponuar, stili dhe mënyra e jetës sheshon, materializon, realizon dhe njerëzit i gozhdon dhe i ngjet në gjërat materiale, dhe shumë prej tyre nuk janë të vetëdijshëm për to. Në vend të vlerave dhe idealeve, njerëzit e pangopur me gjëra materiale, shumica e emigrantëve në Amerikë janë të tillë, ata njerëz mjetet civilizuese dhe të mirat materiale si rezultat i

shkencës, i shndërrojnë në koncept, cak dhe vlerë të jetës. Ajo, dinamika e verbër e jetës dhe vrapit i pandalur pas të mirave dhe mjeteve materiale, grijnë, bluajnë, këputin dhe rrënojnë: jetën bashkëshortore, familjen, miqësinë, fqinjësinë, miqësinë e gjerë dhe e përjashtojnë myslimanin nga xhemati, edhe pse kjo nuk është intencë e Amerikës dhe shoqërisë së saj, por logjikë e verbër e ndjekjes së lëvizjes së kapitalit, që e ndihmojnë largësitë shumë të mëdha hapësinore të njerëzve nga njëri-tjetri si dhe komunikacioni tejet i dendur në qytetet e mëdha. Begatia materiale dhe arritja nga jashtë e gjithçkaje, të rinjtë i nxjerr dhe i vetizolon nga jeta e vërtetë, e cila, siç thotë Max Vebëri, mbështetet në rrënjët frymëmarrëse religjioze, moralo-etike, traditokulturore dhe i shpie në fazën e parë të kënaqësisë, e në të dytën të ndrydhjes. Kjo ndrydhje i shpie në sjellje të ndryshme të rrezikshme patologjike, perverse (droga, alkooli, homoseksualizmi) në të gjitha rreziqet e mundshme jo të rëndomta dhe në prapshtitë, të cilat janë të lidhura me harxhime, rreziqe dhe veprime të shtrenjta. Nga bota e perfeksionizmit që në gjithçka të jesh më i miri, më i parëndomti dhe i papërsëritshëm, shkohet në absurd, sepse secili interes i kësaj bote, fitimi dhe qëllimi, kur të realizohen plotësisht, humbin kuptimin dhe qëllimin. Kur plotësohet interesi dhe caku i kësaj bote, në qoftë se nuk është për hir dhe me emër të Zotit, atëherë hyhet në ndrydhje, brenga dhe apati. Vetëm mbështetja në Zotin nuk e humb kurrë cakun dhe qëllimin, pavarësisht nëse janë realizuar apo jo interesat e kësaj bote. Në faqen e bukur të Amerikës, e cila mund të shikohet, bie edhe fakti se (brenda lirisë) për secilin mund të flitet dhe shkruhet, por kurrsesi, sipas procedurës, nuk është e lejueshme të gënjesh. Pastaj në secilin ka besim, derisa të mos e humbë ai vetë. Në faqen e bukur të Amerikës është edhe kjo: gratë, sipas rregullit, nuk punojnë, derisa t'i rrisin fëmijët. Po ashtu Amerika nuk di për festa (festime të kota), tubime të mëdha e të shtrenjta, parakalime e simpoziume boshe. Sikur

në Gjermani dhe Japoni, edhe në Amerikë është i dëmshëm për vetveten, natyrisht edhe për shtetin dhe shoqërinë, secili përtac, papunëtor, tarallak, analfabet, joprofesionist, i paarsimuar, qoftë edhe me diplomën dhe me titullin më të madh, dhe hajn me harxhimet e tij dhe i dobishëm për vete, shtetin dhe shoqërinë, secili i mençur, i ditur, profesionist, i aftë dhe i dobishëm. Për shkak se secili duhet t'i paguaj shtetit tatimin doemos, në Amerikë askush nuk mund të punojë në të zezën. Kjo është esenca e demokracisë kur i jep të drejtë secilit dhe kur kujdeset për secilin, ajo dëshiron ta detyrojë secilin dhe të dijë për secilin.

AMERIKA DHE PERANDORIA OSMANE

Se është shtet e jo perandori e llojit të vet ekonomik dhe diplomatiko-politik, siç e ka hetuar i ndjeri Ajlaz, Amerika do të ishte, duke pasur parasysh shkallën e zhvillimit dhe formën e organizimit, e krahasueshme me Gjermaninë dhe Japoninë. Kështu, si fuqi e vetme në botë dhe perandori e vetme demokratiko-juridike, e krahasueshme është vetëm me ndonjë nga perandoritë e së kaluarës. Sipas shumçkaje, thënë kushtimisht, Amerika më shumë është e krahasueshme me Perandorinë Osmane. Edhe njëra, edhe tjetra, kryesisht nuk kanë qenë as nacionale, as ideologjike, as konfesionale, por shtete juridikoligjore.

Mbase, në të njëjtin vit me mbarimin e Luftës së Parë Botërore (1918), Perandoria Osmane pushoi së ekzistuari, ndërsa SHBA-ja u bë dhe mbeti deri më sot fuqi e parë botërore. E dyta, edhe pse në Perandorinë Osmane, si monarki, biri trashëgonte babanë dhe edhe pse sulltanin nuk e zgjidhte as populli, as parlamenti, e në SHBA për çdo katër vjet populli zgjedh presidentin, megjithatë, kur është fjala për esencën e pushtetit, ushtrinë dhe administratën, në Perandorinë

Osmane dhe në SHBA ato kanë qenë nën komandën e sulltanit, respektivisht presidentit të SHBA-së. Ashtu sikur Perandoria Osmane pranë sulltanit kurrë nuk kishte premierin, por vezirin e madh – Sadri-azemin, po kështu edhe në SHBA, pranë kryetarit nuk ka premier, por shef të Stejtdepartamentit. Sikur që në Perandorinë Osmane të gjithë njerëzit në administratë, udhëheqje dhe në administrimin e perandorisë, përveç sulltanit, mund të ishin joturq, edhe në administratën e SHBA-së, gati të gjithë bashkëpunëtorët, përveç presidentit, sipas lindjes mund të mos jenë amerikanë. Ashtu sikur në Perandorinë Osmane, secili shfrytëzues i pasurisë, nga veziri i madh e deri tek zaimi dhe timarliu i fundit, e humbte pasurinë e shfrytëzuar në qoftë se nuk u përgjigjej në harmoni me obligimet ligjore, detyrat dhe të drejtat ftesave të shtetit, sidomos atyre të luftës, ashtu edhe në SHBA askush, madje as presidenti i shtetit nuk është i liruar nga tatimi. Për obligimet e llojit të tillë në Perandorinë Osmane kujdeseshin bejlerbejtë, të cilët para çdo angazhimi ushtarak sillnin defterët në të cilët ishte e regjistruar pasuria e secilit, të drejtat, por edhe detyrimet dhe detyrat proporcionalisht me ushtarët. Pas kryerjes së rivistës ushtarake në vend, zvogëloheshin ose i merreshin shfrytëzuesit të drejtat pronësore, në qoftë se detyrimet nuk ishin kryer në harmoni me to. Natyrisht, pas sukseseve ushtarake, njerëzve meritore prona u shtohej. Punët e llojit të tillë në SHBA i kryejnë organet tatimore dhe policia tatimore. Sikur Perandoria Osmane që kishte këmbësorinë detare dhe lumore me emrin azapë, kështu edhe në SHBA kanë këmbësorinë detare me emrin marinca. Sikur Perandoria Osmane që ndahej në 40 njësi administrative, krahina, apo ejalete-pashallëqe me vetëqeverisje të gjerë në çështjet lokale-rajonale, po kështu edhe SHBA-ja përbëhet prej 50 shteteve federale. Sikur që në tërë territorin e Perandorisë Osmane ligji themelor dhe kushtetuta ishin të njëjta, andaj gjithë qytetarëve u ofronte paqe, siguri, liri, njohje dhe barazi, të popujve dhe të

konfesioneve të ndryshme në veçoritë e entitetit , ashtu është edhe në SHBA. Sado që tregu i Perandorisë Osmane shtrihej në tri kontinente në një sipërfaqe prej 8 milionë km², ai ishte unik, i lirë, i sigurt dhe barabar i hapur për të gjithë njerëzit e saj, ashtu është edhe tregu në SHBA. Sikurse Perandoria Osmane që insistonte në parimin: secili është yni, kush nuk është kundër nesh, po atë insiston edhe SHBA-ja. Të dyja këto vende, në të vërtetë perandori, njëra e së kaluarës e tjetra e së tashmes, kërkojnë dhe potencojnë në mes njerëzve minimumin e asaj që e kanë të përbashkët dhe që i lidh.

Derisa Perandoria Osmane u ekspozojë nga shumë rreziqeve të jashtme-vetëm Rusia kundër saj zhvilloi më shumë se 100 luftëra, SHBA-ja, që nuk është sulmuar, më shumë ballafaqohet me rreziqe të brendshme nga veset e qytetarëve të saj.

Në fund, Perandoria Osmane që zgjati për gjashtë shekuj, ka qenë shumë më e ngadalshme sesa SHBA-ja e cila, për shkak të natyrës së lëvizjes së kapitalit nga jashtë, është vendi më dinamik në botë. Një karakteristikë e përbashkët qenësore që i zbkuronte këto dy vende, as për gjashtëqind vjet të Perandorisë Osmane kurrnjihërë nuk kishte ndonjë sulltan i cili të ketë pohuar se nuk besonte në Zotin, as për afro 230 vjet të historisë së ekzistimit të SHBA-së të ketë qenë ndonjë president pabesimtar. Pra, edhe suksesi në këtë botë kërkon strofullën më të sigurt, që është besimi në Zotin xh.sh.

Përktheu nga boshnjakishta:

Ismail REXHEPI

(Marrë nga: "Takvim", Sarajevo, 1998, st. 205 –225)

Sadik Mehmeti

**IMAMATET E XHEMATIT DHE ADMINISTRATA
NË INSTITUCIONET ISLAME NË PRIZREN
ME RRETHINË MË 1935**

Me ligjin e datës 3 tetor 1929, e tërë Mbretëria e Jugosllavisë (deri atëherë Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene) u nda në 9 banovina, në vend të 33 krahinave të mëparshme. Me këtë ligj territori i Kosovës u nda në 3 qendra administrative të banovinave kufitare: në banovinën e Zetës, të Vardarit dhe të Moravës.¹

Kjo nuk qe ndarja e fundit territoriale e Kosovës në atë kohë. Ndërrimet më të mëdha, sa i përket territorit të Kosovës, u bënë me Ligjin e dt. 9 shtator 1931, që nga shteti ishte proklamuar si Ligji për ndryshime dhe plotësime të ligjit për ndarjen e shtetit në banovina, dt. 3 tetor 1929.²

Sipas kësaj ndarjeje, banovina e Vardarit, me qendër në Shkup, nga territori i Kosovës përfshinte 7 rrethe, në mesin e tyre edhe

¹ Dr. Limon Rushiti, Ndarja territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës (1929 - 1941), "Vjetari", i Arkivit të Kosovës, nr. XII-XIII, Prishtinë, 1981, f. 48.

² Po aty, f. 59.

rrethin e Sharrit me seli në Prizren, rrethin e Gorës me seli në Dragash dhe rrethin e Podgorës me seli në Suharekë.³

Ndërsa, sipas ndarjes administrative fetare, këto tri rrethe, së bashku me qytetin e Prizrenit, i takonin Komisionit të Vakëf - Mearifit të rrethit të Prizrenit me seli në Prizren, si organ më i lartë fetar islam në këtë vend.

Komisioni i Vakëf-Mearifit të rrethit kishte për detyrë të hulumtonte dhe të evidenconte tërësisht pasurinë e tundshme dhe të patundshme të vakëfit, të udhëhiqte dhe të mbikëqyrte funksionin e vakëfeve dhe institucioneve të tjera fetare (xhamive, mejtepeve, medreseve etj.), të jepte propozime lidhur me shitblerjen, shkëmbimin a dhënien me qira të objekteve të ndryshme të Vakëfit, të emëronte dhe të shkarkonte nëpunësit fetarë në rrethin e vet, etj.⁴

Komisioni i Vakëf-Mearifit të rrethit të Prizrenit kishte edhe kryetarin dhe nëpunësit e vet, përkatësisht këshilltarët e kryetarit. Në vitin 1935 kryetar i këtij organi ishte Mehmed Udoviçiçi, ndërsa nëpunës të tjerë të administratës kanë qenë: Kemajl ef. Shukriu, zëvendëskryetar, Shaban Jashari, udhëheqës i shërbimit dhe Iljaz Mustafa, arkëtar.⁵

Në kompetencën e këtij komisioni ishte edhe Gjyqi i Sheriatit i rrethit të Prizrenit, me seli po në Prizren. Paraqitja tradicionale e kadiut (gjyqtarit) si mbrojtës i vakëfeve kishte qenë bazë që neni 30 i Kushtetutës së Bashkësisë së Fesë Islame në Mbretërinë Jugosllave më 1930 të përcaktonte që gjyqtari i Sheriatit njëherit të ishte edhe anëtar i Komisionit të Vakëf-Mearifit të rrethit dhe, sipas pozitës që mbante, edhe kryetar i atij komisioni.⁶

³ Po aty, f. 60.

⁴ Mr. Haki Kasumi, *Bashkësia Fetare Islame në Kosovë (1929-1941)*, "Vjetari", i Arkivit të Kosovës, nr. XVI - XVII, Prishtinë, 1983, f. 97.

⁵ Arkivi i Kosovës, *Fondi Sresko Vakufsko Mearifsko Poverenstvo - Prizren*, k. 7, 1935.

⁶ Fikret Karčić, *Šeriatski sudovi u Jugoslaviji 1918 - 1941*, Sarajevo, 1986, f. 73.

Kështu, Mehmed Udoviçiç, përveç detyrës së kryetarit të Komisionit..., kryente edhe detyrën e gjyqtarit të Sheriatit të rrethit të Prizrenit.⁷ Ai ishte me përkatësi boshnjake nga Mostari, që më 1926 kishte mbaruar shkollën për Gjyqtar të Sheriatit në Sarajevë.⁸

Ç'është e drejta, më 21 mars 1929, nxirret Ligji mbi rregullimin e gjyqeve dhe gjyqtarëve të sheriatit, me se bëhej edhe suprimi i myftinive⁹ të deriatëhershme, me punën e të cilave më tutje ngarkoheshin gjyqet e sheriatit.

Prizreni paraqiste edhe më tutje qendrën administrative fetare ku mbaheshin evidenca të ndryshme për pjesën dërrmuese të myslimanëve të Kosovës, madje që në vitin 1935 gjejmë të dhëna për ekzistimin e sërishëm të Myftinisë së Prizrenit, e cila tanimë nën administratën e vet kishte një territor më të gjerë, që përfshinte gati tërë Kosovën, me përjashtim të rrethit të Kaçanikut, që i takonte Myftinisë së Shkupit.¹⁰

Myfti i Prizrenit në vitin 1935 ishte Nysret ef. Galibi, ndërsa zëvendësmyfti Shaqir Berberkiçi, me përkatësi boshnjake.¹¹

Komisioni i Vakëf - Mearifit të rrethit të Prizrenit nën kontrollin e vet kishte njësitë më të vogla, të ashtuquajtura Imamate të xhematit. Këto organe ishin të formuara në qytet e nëpër fshatra dhe ato i udhëhiqnin imamët ofiqarë (imamët e xhematëve), të cilët i emëronte Ulema Mexhlisi i Shkupit.

Imamati i xhematit ishte organ përfaqësues i xhematit, i cili organizonte mësimin fetar, kujdesej për edukimin fetar të xhematlinjve të vet, udhëhiqte evidencat e pjesëtarëve të BFI-së në territorin e vet (mbante evidenca për numrin e myslimanëve të lindur, të kurorëzuar

⁷ AK, F. Sreski Šeriatski Sud - Prizren, k. 1. M. 81, 1935.

⁸ Kasim Hadžić, Stogodišnjica Sudačke škole (Mektebi Nubuvva), u Sarajevu, "Glasnik", VIS, nr. 5, Sarajevo, 1987, f. 659.

⁹ Fikret Karčić, vep. cit., f. 66.

¹⁰ Mr. Haki Kasumi, pun. cit., f. 102.

¹¹ AK., FSVMP-Prizren, k. 7, 1935.

dhe të vdekur) si dhe ushtronte mbikëqyrjen ndaj nëpunësve të tjerë fetarë të xhematit të tij, nëse këtë detyrë nuk e kishin organet më të larta fetare. Imami i xhematit, pos të tjerash, bënte edhe kurorëzimin sipas rregullave fetare¹² dhe për këtë mbante edhe evidenca të sakta.

Me një fjalë, imametet e xhematit ishin organe bazë të Bashkësisë Islame, përmes së cilave organizohej dhe funksiononte jeta fetare¹³ në vend.

Këto njësi administrative fetare, të cilat ishin nën kontrollin e Vakëf-Mearifit të rrethit, në fillim formoheshin në çdo fshat a lagje të qytetit që kishte të paktën 100 shtëpi myslimane.¹⁴ Mirëpo, deri në vitin 1928 u bënë disa ndryshime lidhur me numrin e shtëpive myslimane që përbënin një xhemat. Kështu, në vitin 1925 numri i shtëpive myslimane u shtua në 200 sosh, ndërsa me reformimin e imamateve në vitin 1928 numri i shtëpive myslimane u shtua në 300 sosh.¹⁵

Pas vitit 1928, imametet e xhematit ndaheshin në dy kategori: të qytetit e të fshatit, dhe në krye të imametit të xhematit ishte imami-hoxha.

Për të pasur të dhëna sa më të sakta për numrin e imamateve, numrin e imamëve ofiqarë, numrin e xhamive, pastaj numrin e shtëpive myslimane dhe numrin e banorëve myslimanë, Drejtorati i Vakëfeve-Mearife i Shkupit, të gjitha komisioneve të vakëfeve - mearife të rretheve në territorin e vet (ky Drejtorat përfshinte 42 komisione të

¹² Dr. Haki Kasumi, *Bashkësitë fetare në Kosovë*, Prishtinë, 1988, f. 153. Ndonëse deri në vitin 1928 të gjithë imamët mbanin evidenca për numrin e myslimanëve të lindur, të kurorëzuar dhe të vdekur, megjithatë, ata nuk konsideroheshin zyrtarisht të angazhuar.

¹³ Dr. Haki Kasumi, *Gjendja organizative e Bashkësisë Islame te shqiptarët nën okupimin jugosllav 1912 - 1941*, Simpoziumi ndërkombëtar: Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët, Prishtinë, 1995, f. 462.

¹⁴ AK., F. Myftinia e Rrethit të Gorës, k. 1. 1919.

¹⁵ Mr. Haki Kasumi, *Bashkësia Fetare Islame e Kosovës 1918 - 1929*, "Vjetari" i Arkivit të Kosovës, nr. XII - XIII, Prishtinë, 1981, f. 258.

vakëfeve-mearife të rretheve, nga të cilat 11 i përkisnin Kosovës) u kishte dërguar një shkresë nr. 9337/35, dt. 8 tetor 1935, me të cilën kërkoheshin të dhëna për imamatet e xhematit.¹⁶

Një kërkesë e tillë i qe dërguar edhe Komisionit të Vakëf – Mearifit të rrethit të Prizrenit, në të cilën thuhej: "Që të mund të plotësojmë dhe të kontrollojmë ndryshimet në evidencat e këtij Drejtorati (të Vakëfeve-Mearife në Shkup -S.M.), kërkujmë nga Komisioni i Vakëf-Mearifit (të rrethit të Prizrenit- S.M.) që sa më parë që është e mundur të bëjë regjistrimin e të gjithë xhematëve që gjenden në territorin e këtij komisioni".¹⁷

Në shkresën e dërguar nga Drejtorati..., jepeshin edhe udhëzime se çfarë duhej të përmbante ai regjistrim.

Aty thuhej: "Ky regjistrim duhet të përmbajë këto të dhëna: numrin rendor; emrin e xhematit; a është xhemati i fshatit, i qytetit apo i përzier; cilat lagje (për qytetet) dhe cilat fshatra (për fshatrat) i përfshin ai xhemat; kush është imam ofiqar i xhematit përkatës; cilat xhami gjenden në secilin xhemat veç e veç dhe ku; sa shtëpi myslimane ka në secilin xhemat veç e veç; sa banorë myslimanë ka në secilin xhemat veç e veç dhe kjo veçmas meshkuj e veçmas femra; ku gjendet selia e xhematit dhe vërejtjet eventuale". - thuhej në atë shkresë, për të vazhduar: "Për mbledhjen veç e veç të të dhënave për këtë regjistrim Komisioni le t'i përdorë imamët ofiqarë, përkatësisht të mbledhë të dhëna prej tyre dhe, pas verifikimit, ato të dhëna t'i shënojë në regjistrin përfundimtar".¹⁸

¹⁶ Arkivi i Kosovës, Sresko Vakufsko Mearifsko Poverenstvo - Prizren, k. 7, dok. nr. 581, 1935.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Po aty.

Në vazhdim të kësaj urdhërese u tërhoqej vërejtja imamateve se: "Imamët ofiqarë janë përgjegjës personalisht për saktësinë e të dhënave".¹⁹

"Kjo përbën një punë urgjente - thuhej më tej në këtë urdhëresë - dhe regjistrin përfundimtar duhet ta dorëzoni më së voni deri në fund të këtij muaji²⁰, (tetor 1935-S.M.) – përfundonte shkresa e dërguar nga DVM-ja e Shkupit.

Kërkesës së Drejtoratit..., do t'i përgjigjej natyrisht edhe kryetari i Komisionit të Vakëf - Mearifit të rrethit të Prizrenit, M.Udoviçiçi, dhe imamët ofiqarë të këtij komisioni, të cilët na japin të dhëna me rëndësi për ndarjen administrative fetare sipas imamateve të xhematit të rrethit të Sharrit së bashku me qytetin e Prizrenit, të rrethit të Gorës dhe të rrethit të Podgorës.

Gjatë hulumtimeve në Arkivin e Kosovës, kemi gjetur përgjigjen, d.m.th. regjistrat që kryetari i Komisionit të rrethit të Prizrenit, M. Udoviçiç, i kishte dërguar Drejtoratit të Vakëfeve-Mearife të Shkupit.²¹

Prandaj, do t'u referohemi këtyre dokumenteve, të cilat botohen për herë të parë, dhe po i japim në tërësi, para së gjithash për shkak të rëndësisë që kanë këto të dhëna, sidomos po të kihet parasysh se administrata është faktor i rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror. Ajo madje ka për detyrë të vërë rregulla dhe norma juridike organizative në një bashkësi shoqërore. Ndërsa në kontekstin islam, përveç kësaj, ajo detyrohet të pengojë shpirtligësinë, dhunën dhe ndarjen ndërmjet njerëzve. Dhe jo vetëm kaq, administrata në institucionet islame ka pasur dhe ka edhe sot rol edukativ, që me përcak-

¹⁹ Po aty.

²⁰ Po aty.

²¹ Po aty.

timin e organeve përkatëse t'i mundësohet që populli të ndiejë përgjegjësi për krijimin e një shoqërie të drejtë e të ndershme.²²

Në anën tjetër, "organet administrative fetare islame (imamatet e xhematit, komisionet e vakëfeve-mearife dhe më vonë Ulema Mexhlisi i Shkupit) ishin të vetmet institucione, që mund të quhen organe institucionale legale për shqiptarët myslimanë të viseve të okupuara, ku ata mund të komuniknin jozyrtarisht në gjuhën amtare, shqip".²³

Ndonëse këto institucione luajtën rol shumë pozitiv në ruajtjen e identitetit kombëtar shqiptar dhe për krijimin e mundësisë së rezistencës së organizuar shqiptare kundër pushtuesit serbomadh, megjithatë, deri më sot për to nuk është shkruar ndonjë studim i veçantë!²⁴

Ky shkrim, kujtojmë, paraqet një kontribut modest për ndriçimin e veprimtarisë së këtyre institucioneve, prandaj publikimi i këtyre të dhënave del edhe më i ngutshëm.

Duke iu referuar këtyre regjistrave, mësojmë për ndarjen administrative fetare të rrethit të Sharrit, të rrethit të Gorës dhe të rrethit të Podgorës, emrin e 28 imamëve ofiqarë së bashku me datën e lindjes së tyre si dhe dekretin me të cilin ata ishin emëruar në atë detyrë nga Ulema Mexhlisi i Shkupit.

Gjithashtu mësojmë edhe për numrin dhe vendin e xhamive që asokohe gjendeshin në kuadër të këtyre imamateve.

Ndërkaq, një e dhënë tjetër shumë me rëndësi që japin këto dokumente, mendojmë, është numri i shtëpive myslimane, pastaj numri i banorëve myslimanë (veçan meshkuj dhe veçan femra) për secilin imamat dhe për secilin rreth veç e veç.

²² Ismail Ahmedi, Aspekte letrare, Shkup, 1995, f. 65.

²³ Dr. Haki Kasumi, Gjendja organizative e Bashkësisë Islame te shqiptarët nën okupimin jugosllav 1912-1941, pun. cit., f. 463.

²⁴ Po aty.

Në bazë të këtyre regjistrave na mundësohet të dimë numrin e saktë të shtëpive dhe banorëve myslimanë të rretheve në fjalë.

Kjo, sidomos, sepse regjistrimi i popullsisë dhe statistikave e bëra në vitin 1921 e 1931, nga pushtetarët serbomëdhenj, për shumë arsye, nuk janë të sakta. Ata, përmes këtyre farë regjistrimesh të falsifikuara kishin dashur që para botës të nxirrnin sa më pak shqiptarë dhe sa më tepër elementë sllavë.²⁵

Duke iu referuar të dhënave të Komisionit të Vakëf-Mearifit të rrethit të Prizrenit, mësojmë se rrethi i Sharrit, pa qytetin e Prizrenit, në vitin 1935 kishte gjithsej 9 imamate të xhematit, nën jurisdiksionin e të cilave ishin 67 fshatra, 31 xhami, 3.131 shtëpi myslimane, 23.445 banorë myslimanë, 11.886 meshkuj dhe 11.549 femra.

Ndërsa qyteti i Prizrenit, i cili bënte pjesë në kuadër të rrethit të Sharrit, kishte gjithsej 6 imamate të xhematit, 95 rrugë, 22 xhami, 2.439 shtëpi myslimane, 12.576 banorë myslimanë, 6.209 meshkuj dhe 6.367 femra.

Siç po shihet, rrethi i Sharrit në vitin 1935 kishte gjithsej 15 imamate, 9 të fshatrave dhe 6 të qyteteve, 53 xhami, 5.570 shtëpi myslimane, 36.021 banorë myslimanë, 18.095 meshkuj dhe 17.916 femra. Ky ishte rrethi me më shumë imamate dhe me më shumë xhami, shtëpi dhe banorë myslimanë.

Rrethi i Gorës në vitin 1935 kishte gjithsej 8 imamate të xhematit (5 në Opojë dhe 3 në Gorë), përfshinte 38 fshatra (Brodi, në të vërtet, ishte qytezë), kishte 36 xhami, 2.347 shtëpi myslimane, 17.602 banorë myslimanë, 9.051 meshkuj dhe 8.549 femra. Ky ishte rrethi i dytë për nga numri i imamateve.

Rrethi i Podgorës, ndërkaq, në vitin 1935 kishte gjithsej 5 imamate, përfshinte 37 fshatra, 13 xhami, 1.403 shtëpi myslimane, 14.519

²⁵ Dr. Hakif Bajrami, Kosova - njëzet shekuj të identitetit të saj, Prishtinë, 2001, f. 9.

banorë myslimanë, 5.901 meshkuj dhe 7.018 femra. Ky ishte rrethi me numrin më të paktë të imamateve.

Nga sa u tha më lart, mund të përfundojmë se Komisioni i Vakëf-Mearifit të rrethit të Prizrenit, nën jurisdiksionin e të cilit bënin pjesë rrethi i Sharrit, rrethi i Gorës dhe rrethi i Podgorës, në vitin 1935 kishte gjithsej 28 imamate të xhemitit dhe përfshinte 142 fshatra, 6 mëhallë me 95 rrugë të qytetit të Prizrenit, 102 xhami, 9.320 shtëpi myslimane, 68.142 banorë myslimanë, 33.047 meshkuj dhe 33.483 femra.

Paraqitja e këtyre të dhënave në mënyrë tabelare do të dukej kështu:

Nr. rend.	Rrethi	Nr. Imamateve	Nr. fshatrave	Nr. xhamive	Nr. shtëpive myslimane	Nr. banorëve myslimanë	meshkuj	femra
1	Sharrit me Prizrenin	15	67+6 mëhallë	53	5570	36021	18095	17916
2	Gorës	8	38	36	2347	17602	9051	8549
3	Podgorës	5	37	13	1403	14519	5901	7018
	Gjithsej	28	142+6 mëhallë	102	9320	68142	33047	33483

Tabelës nuk ka nevojë t'i bëhet ndonjë koment, pos të konstatojmë se qyteti i Prizrenit në vitin 1935 ishte i ndarë në gjashtë (6) lagje me 95 rrugë. Në dokumentet në shqyrtim jepen edhe emrat e të gjitha rrugëve të Prizrenit, madje aty shënon së në cilën rrugë të cilës lagje gjendej akëcila xhami. Mirëpo, pothuajse të gjitha emërtimet e rrugëve të qytetit të Prizrenit në këtë kohë ishin me kuptime sllave, prandaj ne nuk e pamë të nevojshme t'i shënojmë ato. Riemërtimi i rrugëve me kuptime sllave kishte filluar nga viti 1930 dhe ishte bërë

për dy arsye: me qëllim të zhdukjes së emrave të lashtë dhe me qëllim që Kosova të dukej sa më shumë serbe.

Në vazhdim po japim regjistrin e imamateve të xhematit për rrethin e Sharrit, qytetin e Prizrenit, rrethin e Gorës dhe rrethin e Podgorës, ashtu si janë të dhëna në dokumentet në fjalë.

I. IMAMATET E RRETHIT TË SHARRIT

A. Imamatet e qytetit të Prizrenit

1. Imamati i Bajrakisë

Ky imamat përfshin 12 rrugë të qytetit të Prizrenit. Imam ofiqar është Abdyl Mehmedi, i lindur më 1877. Është i dekretuar me vendimin nr. 1675, dt. 27 prill 1933. Në këtë imamat ka 5 xhami: 1. xhamia e Bajrakisë, 2. xhamia e Emin Pashës, 3. xhamia e Saraçhanes, 4. xhamia e Haxhi Ramadanit dhe 5. xhamia e Mustafë Pashës. Ky imamat ka 409 shtëpi myslimane; 1.992 banorë myslimanë, prej tyre 886 meshkuj dhe 1.106 femra. Selia e imamatit gjendet në mëhallën e Bajrakisë.

2. Imamati i Terzisë

Përfshin 16 rrugë të tjera të qytetit të Prizrenit. Imam ofiqar është Shaban Emiri, i lindur më 1888. Në këtë imamat ka dy xhami: 1. xhamia e Terzisë dhe 2. xhamia e Hoça Mëhallës. Ky imamat ka 394 shtëpi myslimane; 1.984 banorë myslimanë, prej tyre 996 meshkuj dhe 998 femra. Selia e Imamatit gjendet në Terzi Mëhallë.

3. Imamati i Dragomanit

Përfshin 21 rrugë të tjera të qytetit të Prizrenit. Imam ofiqar është Kemajl Nuridini, i lindur më 1880. Është i dekretuar me vendimin nr. 898, dt. 9 mars 1933. Ky imamat ka vetëm 2 xhami: 1. Xhaminë e

Dragomanit dhe 2. Xhaminë e Kurillës. Ka 415 shtëpi myslimane; 2.369 banorë myslimanë, prej tyre 1.183 meshkuj dhe 1.186 femra. Selia e Imamatit gjendet në lagjen e Dragomanit.

4. Imamati i Suzisë

Përfshin 14 rrugë të tjera të qytetit të Prizrenit. Imam ofiqar është Qemajl Shukriu, i lindur më 1888. Është i dekretuar me vendimin nr. 896, dt. 9 mars 1933. Ky imamat ka 7 xhami: 1. xhaminë e Suzisë, 2. xhaminë e Haxhi Kasëmit, 3. xhaminë e Myderrizit, 4. xhaminë e Iljas Kukës, 5. xhaminë e Sejdi Begut, 6. xhaminë e Sinan Pashës, dhe 7. xhaminë e Maksud Pashës. Ka 384 shtëpi myslimane; 1.835 banorë myslimanë, prej tyre 909 meshkuj dhe 926 femra. Selia e Imamatit gjendet në lagjen e Suzisë.

5. Imamati i Qatib Sinanit

Përfshin 17 rrugë të tjera të qytetit të Prizrenit. Imam ofiqar është Sylejman Esadi, i lindur më 1891. Është i dekretuar me vendimin nr. 899, dt. 9 mars 1933. Ky imamat ka vetëm 2 xhami: 1. xhaminë e Qatib Sinanit dhe 2. xhaminë e Arastës. Ka 420 shtëpi myslimane; 2.218 banorë myslimanë, prej tyre 1.093 meshkuj dhe 1.125 femra. Selia e Imamatit gjendet në lagjen e Qatib Sinanit.

6. Imamati i Jeni (Mahallës)

Përfshin 18 rrugë të tjera të qytetit të Prizrenit. Imam ofiqar është Beqir Hizri, i lindur më 1884. Është i dekretuar me vendimin nr. 902, dt. 9 mars 1933. Ky imamat ka 4 xhami: 1. xhaminë e Jeni Mahallës, 2. xhaminë e Çohaxhi Mahmudit, 3. xhaminë e Ahmed Begut dhe 4. xhaminë e Budakë Hoxhës. Ky imamat ka 417 shtëpi myslimane; 2.178 banorë myslimanë, prej tyre 1.142 meshkuj dhe 1.036 femra. Selia e Imamatit gjendet në lagjen e Jeni-Mahallës.

B. Imamatet e fshatrave

1. Imamati i Zhurit

Përfshin fshatrat Zhur, Dobrosh dhe Shkozë. Imam ofiqar është Haki Bajrami, i lindur më 1882. Është i dekretuar me vendimin nr. 895, dt. 9 mars 1933. Në këtë imamat ka 2 xhami: të dyja gjenden në fshatin Zhur. Ka 325 shtëpi myslimane²⁶, 2.057 banorë myslimanë, prej tyre 1.035 meshkuj dhe 1.022 femra. Selia e imamatit gjendet në fshatin Zhur.

2. Imamati i Lybeqevës

Përfshin këto katër fshatra: Lybeqevën, Leskovecin, Kushninin dhe Jabllanicën. Imam ofiqar është haxhi Vejsel Muharremi, i lindur më 1906. Ai është i dekretuar me vendimin nr. 890, dt. 9 mars 1933. Ky imamat ka katër xhami; nga një në secilin fshat. Ka gjithsej 317 shtëpi myslimane; 2.040 banorë myslimanë, prej tyre 1.012 meshkuj dhe 1.028 femra. Selia e Imamatit gjendet në fshatin Lybeqevë.

3. Imamati i Hoçës së Qytetit

Përfshin fshatrat Hoqë e Qytetit, Vërmicë, Billush, Poslisht, Jeshkovë dhe Lez. Imam ofiqar është Hasan Sylejmani, i lindur më 1880. Është i dekretuar me vendimin nr. 893, dt. 9 mars 1933. Ky imamat ka 5 xhami; nga një në secilin fshat, me përjashtim të fshatit Poslisht. Ka gjithsej 332 shtëpi myslimane; 2.085 banorë myslimanë, prej tyre 1.080 meshkuj dhe 1.005 femra. Selia e Imamatit gjendet në Hoqë të Qytetit.

²⁶ Numri i shtëpive dhe banorëve të Imamatit të Zhurit, në dokumentet në fjalë, është dhënë sipas regjistrimit të vitit 1931, sepse deri atëherë, shkruan aty, raporti për këtë imamat nuk është përfunduar.

4. Imamati i Neprogoshtit

Përfshin këto fshatra: Lubija e Epërme, Neprogoshti, Manastreci dhe Struxha. Imam ofiqar është Ramiz Ibrahim. Në këtë imamat ka gjithsej katër xhami: nga një në secilin fshat. Ky imamat ka 367 shtëpi myslimane; 2.403 banorë myslimanë, prej tyre 1.214 meshkuj, 1.189 femra. Selia e Imamatit gjendet në Neprogosht.

5. Imamati i Peçanit

Përfshin këto 7 fshatra: Peçanin, Llokvicën, Lubinë e Poshtme, Pllanjanin, Drajçiqin, Mushnikovën dhe Gornasellën. Imam ofiqar është Ramadan Rasimi, i lindur më 1889. Ai është i dekretuar me vendimin nr. 901, dt. 9 mars 1933. Ka 5 xhami: nga një në fshatrat Peçan, Llokvicë, Lubijë e Poshtme, Pllanjan dhe Mushnikovë. Ka 358 shtëpi myslimane; 2.248 banorë myslimanë, prej tyre 1.136 meshkuj dhe 1.112 femra. Selia e Imamatit gjendet në Peçan.

6. Imamati i Korishës

Përfshin këto fshatra: Korishën, Lubizhdën, Skorobishtin, Novosellën, Kabashin dhe Lutogllavën. Imam ofiqar është Mehmed Ademi, i lindur më 1883. Ai është i dekretuar me vendimin nr. 889, dt. 9 mars 1933. Në këtë imamat ka tri xhami: një në Korish, një në Skorobisht dhe një në Novosellë. Ky imamat ka 341 shtëpi myslimane; 2.186 banorë myslimanë, prej tyre 1.092 meshkuj dhe 1.094 femra. Selia e Imamatit gjendet në Korish.

7. Imamati i Piranës

Përfshin këto 14 fshatra: Landovicën, Piranën, Trepeshnicën, Serbicën e Epërme, Serbicën e Poshtme, Vlashnen, Kobajt, Atmaxhën, Nashecin, Grazhdanikun, Gërçarin, Caparcin, Shpinadinë dhe Gelancën. Imam ofiqar është Hizër Halidi, i lindur më 1884. Është i dekre-

tuar me vendimin nr. 894, dt. 9 mars 1933. Ky imamat ka vetëm 4 xhami: nga një në fshatrat Piranë, Vlashne, Atmaxhë dhe Gërçar. Ka 265 shtëpi myslimane; 1.915 banorë myslimanë, prej tyre 952 meshkuj dhe 963 femra. Selia e Imamatit gjendet në Vlashne.

8. Imamati i Rogovës

Përfshin këto 13 fshatra: Rogovën, Damjanin, Kushninin, Gërçinën, Likovcin, Godenin, Romajën, Smaçin, Zylfajt, Dedajt, Kabashin, Llukinjën dhe Ujëzin. Imam ofiqar është Ahmed Latifi, i lindur më 1897. Është i dekretuar me vendimin nr. 2289, dt. 19 nëntor 1934. Ky imamat ka vetëm 2 xhami: një në fshatin Rogovë dhe një në fshatin Romajë. Ka 427 shtëpi myslimane; 4.229 banorë myslimanë, prej tyre 2.224 meshkuj dhe 1.995 femra. Selia e Imamatit gjendet në Rogovë.

9. Imamati i Gjonajve

Përfshin këto 10 fshatra: Gjonajt, Pllanejin, Zymin, Lubizhdën, Milajt, Gorozhubin, Kajushën, Mazrekun, Karashingjergjin dhe Krajkin. Imam ofiqar është Ymer Mustafa, i lindur më 1885. Është i dekretuar me vendimin nr. 892, dt. 2 mars 1933. Ky imamat ka vetëm 2 xhami: një në fshatin Gjonaj dhe një në fshatin Pllanejë. Ka 399 shtëpi myslimane; 4.282 banorë myslimanë, prej tyre 2.141 meshkuj dhe 2.141 femra. Selia e imamatit gjendet në Gjonaj.

II. IMAMATET E RRETHIT TË GORËS

1. Imamati i Bresanës

Përfshin fshatrat: Bresanë, Kuklibeg, Kuk, Pllajnik dhe Buzes. Imam ofiqar është Isak Veliu, i lindur më 1883. Është i dekretuar me vendimin nr. 882, dt. 9 mars 1933. Ky imamat ka 3 xhami: nga një në fshatrat Bresanë, Kuk dhe Pllajnik. Ka 309 shtëpi myslimane; 2.214

banorë myslimanë, prej tyre 1.082 meshkuj dhe 1.132 femra. Selia e Imamatit gjendet në Bresanë.

2. Imamati i Kosavës

Përfshinë fshatrat: Blaç, Zaplluxhe, Kosavë, Kapre, Rrencë, Xërrxe dhe Radesh. Imam ofiqar është Xhemil Abdullahu, i lindur më 1903. Është i dekretuar me vendimin nr. 1059, dt. 28 mars 1933. Në këtë imamat ka 7 xhami, nga një në secilin fshat. Ky imamat ka 319 shtëpi myslimane; 2.654 banorë myslimanë, prej tyre 1.382 meshkuj dhe 1.272 femra. Selia e Imamatit gjendet në fshatin Blaç.

3. Imamati i Bellobradit

Përfshin fshatrat: Bellobrad, Brrut, Zgatar, Zym, Plavë dhe Dragash. Imam ofiqar është Nezir Veliu. Ky imamat ka 5 xhami, nga një në secilin fshat me përjashtim të fshatit Zym. Ka 280 shtëpi myslimane; 2.080 banorë myslimanë, prej tyre 1.047 meshkuj, 1.033 femra. Selia e Imamatit gjendet në Bellobrad.

4. Imamati i Shajnes

Përfshin këto fshatra: Shajnen, Lybevishtin, Leshtanin, Kukajanin dhe Orqushën. Imam ofiqar është Ymer Ahmedi, i lindur më 1879. Është i dekretuar me vendimin 884, dt. 9 mars 1933. Ky imamat ka 5 xhami: nga një në selin fshat. Ka 291 shtëpi myslimane; 2.088 banorë myslimanë, prej tyre 1.112 meshkuj dhe 976 femra. Selia e Imamatit gjendet në fshatin Shajne.

5. Imamati i Buçës

Përfshin këto gjashtë fshatra: Rapçën e Epërme, Rapçën e Poshtme, Kërstecin e Madh, Kërstecin e Vogël, Buçën dhe Breznën. Imam ofiqar është Sinan I. Sinani, i lindur më 1896. Është i dekretuar me

vendimin nr. 885, dt. 9 mars 1933. Në këtë imamat ka gjithsej 6 xhami; nga një në secilin fshat. Ka 385 shtëpi myslimane; 2.399 banorë myslimanë, prej tyre 1.230 meshkuj dhe 1.169 femra. Selia e Imamatit gjendet në Rapçë.

6. Imamati i Vraniçit

Përfshin këto fshatra: Vraniç, Mliki, Dikancë, Baçkë, Glloboçicë dhe Krushë. Imam ofiqar është Nazif Hyseni, i lindur më 1888. Është i dekretuar me vendimin nr. 886, dt. 9 mars 1933. Në këtë imamat ka 6 xhami, nga një në secilin fshat. Ka 397 shtëpi myslimane; 2.290 banorë muslimanë, prej tyre 1.174 meshkuj dhe 1.116 femra. Selia e Imamatit gjendet në Vraniç.

7. Imamati i Restelicës

Përfshin fshtrat Restelicë dhe Zlipotok. Imam ofiqar është Bajram Shabani, i lindur më 1904. Është i dekretuar me vendimin nr. 887, dt. 9 mars 1933. Ky imamat ka dy xhami, nga një në secilin fshat. Ka 305 shtëpi myslimane; 1.702 banorë myslimanë, prej tyre 891 meshkuj dhe 811 femra. Selia e Imamatit gjendet në Restelicë.

8. Imamati i Brodit

Është Imamat i qytetit dhe përfshin vetëm qytezën e Brodit. Imam ofiqar është Mehmed H. Sylejmani, i lindur më 1880. Është i dekretuar me vendimin nr. 888, dt. 9 mars 1933. Ky imamat ka dy xhami, të dyjat në qytezën e Brodit. Ka 336 shtëpi myslimane; 2.173 banorë myslimanë, prej tyre 1.133 meshkuj dhe 1.040 femra. Selia e Imamatit gjendet në Brod.

III. IMAMATET E RRETHIT TË PODGORËS

1. Imamati i Suharekës

Është imamati i fshatit dhe përfshin fshatrat Suharekë, Peçan, Sllapuzhan, Sopi, Savrovë, Bukosh, Stravuçinë, Krushicë dhe Çadrak. Imam ofiqar është Haki S. Mahmudi, i lindur më 1887. Është i dekretuar me vendimin nr. 3306, dt. 18 shtator 1933. Ky imamati ka vetëm dy xhami: një në Suharekë dhe një në Sopi. Ka 366 shtëpi myslimane; 3.161 banorë myslimanë, prej tyre 1.589 meshkuj dhe 1.572 femra. Selia e Imamatis gjendet në Suharekë.

2. Imamati i Mushtishtit

Përfshin këto fshatra: Mushtisht, Dollovc, Dvoranë, Maçitevë, Vraniç, Greikoc, Sallagrahdë dhe Dubravë. Imam ofiqar është Sherif Qerimi, i lindur më 1887. Është i dekretuar me vendimin nr. 879, dt. 24 mars 1933. Ky imamati ka tri xhami: një në fshatin Mushtisht, një në fshatin Vraniç dhe një në fshatin Greikoc. Ka gjithsej 350 shtëpi myslimane; 3.194 banorë myslimanë, prej tyre 1.681 meshkuj dhe 1.513 femra. Selia e Imamatis gjendet në Mushtisht.

3. Imamati i Bllacës

Përfshin fshatrat: Bllacë, Dule, Greiçec, Budakovë, Papaz, Vershec dhe Movlan. Imam ofiqar është Zejnullah Ramadan Behluli. Ky imamati ka 2 xhami: një në Bllacë dhe një në Budakovë. Ka 477 shtëpi myslimane; 3.156 banorë myslimanë, prej tyre 1.706 meshkuj dhe 1.450 femra. Selia e Imamatis gjendet në Bllacë.

4. Imamati i Studençanit

Përfshin fshatrat: Studençan, Dobrodelan, Reshtan, Nepërbisht, Ternje, Leshan dhe Gjinoc. Imam ofiqar është Nuredin haxhi Halidi, i

lindur më 1895. Është i dekretuar me vendimin nr. 693, dt. 21 prill 1934. Ky imamat ka 2 xhami një në fshatin Studençan dhe një në Leshan. Ka 297 shtëpi myslimane; 2.508 banorë myslimanë, prej tyre 1.216 meshkuj dhe 1.292 femra. Selia e Imamatit gjendet në Studençan.

5. Imamati i Nishorit

Përfshin fshatrat: Nishor, Semetisht, Peçan, Kostërc, Kërvosar dhe Tumiçinë. Imam ofiqar është Muharrem Salihu, i lindur më 1883. Është i dekretuar me vendimin nr. 881, dt. 8 mars 1933. Në këtë imamat ka 4 xhami: nga një në fshatin Nishor, Semetisht, Peçan dhe Kërvosar. Ka 343 shtëpi myslimane; 2.500 banorë myslimanë, prej tyre 1.309 meshkuj dhe 1.191 femra. Selia e Imamatit gjendet në Nishor.

Nexhat S. Ibrahimi

**HISTORIA ISLAME NDËRMJET REALITETIT DHE
PARAGJYKIMEVE**

Kush është Thomas W. Arnoldi?

Thomas W. Arnoldi (1864 – 1930), është orientalist, historian, filozof dhe hulumtues i njohur nga Anglia, profesor në Universitetin Islamik të Aligarhut në Indi gjatë viteve 1888-1898, pastaj profesor i filozofisë në Universitetin e Londrës (1898 – 1904), profesori i parë i gjuhës arabe në Shkollën për gjuhët orientale në Londër (1904 - 1930), dhe dekan i saj prej vitit 1921 - 1930.

Jeta e tij në mesin e muslimanëve i ndihmoi këtij evropiani ta njohë Islamin jo vetëm nga jashtë, por edhe nga brenda, duke depërtuar në thellësitë dhe zjarrin fetar të njerëzve të devotshëm, botë kjo në të cilën shumë pak evropianë depërtuan. Arnoldi kishte kolegë e miq të shumtë nga mesi i muslimanëve dhe ishte profesor i një numri intelektualësh muslimanë me renome, njëkohësisht kishte miqësi edhe me një numër orientalistësh e shkencëtarësh evropianë.

Vepra e Th. W. Arnoldit

Ndonëse vepra e Th. W. Arnoldit “Historia e përhapjes së Islamit” për herë të parë e botuar në gjuhën angleze në Aligarh në Indi më 1896, edhe këto kohë ajo është tejet aktuale, si nga aspekti i çështjeve që trajton, ashtu edhe nga aspekti i metodës që përdor gjatë shtruarjes së materies.

Ka disa faktorë pse vepra jetoi kaq gjatë pa humbur në cilësi e vlerë, por, sipas bindjes sonë, mbi të gjitha, për faktin se vepra trajton dhe përpunon procesin e përhapjes së Islamit, siç e quajnë disa, religjionit më të ri në skenën botërore, duke mos lënë anash konceptin fetar, filozofik, shoqëror, politik dhe kulturor, të pranishëm tashmë pesëmbëdhjetë shekuj në mbarë rruzullin tokësor.

Kemi punime dhe studime të shumta të muslimanëve dhe jomuslimanëve që në të kaluarën kanë trajtuar aspektin politiko-shoqëro-ekonomik, kulturor, shkencor e filozofik të Islamit, kanë trajtuar ngri-tjen dhe rënien e Islamit e çështje të tjera, por aspekti fetar i veprimit të muslimanëve është lënë në margjina të preokupimeve shkencore, asnjëherë nuk është studiuar në mënyrë analitike dhe të gjithanshme. Qasja e Thomas W. Arnoldit, edhe pse fare pak e mbështetur shkencërisht e politikisht nga të tjerët, mbase, është impresionuese, kurajuese dhe, mbi të gjitha, konstruktive e shkencore edhe në kohën tonë.

Disa çështje thelbësore të veprës - Misioni

Thomas W. Arnoldi përveç që shtroi historinë e përhapjes së Islamit në botë, shtroi edhe depërtimin e Islamit në Ballkan e edhe tek shqiptarët.

Ndonëse niveli i studimeve dhe hulumtimeve në kohën e tij ishte në shkallë të ulët, ndonëse disa fakte të zbuluara më vonë nuk kanë qenë të njohura në kohën e tij, Arnoldi ofron një qasje origjinale, të

pangarkuar, pa paragjykime e fanatizëm dhe të dhëna mjaft interesante që veprën e bëjnë përmendore të historisë. Ai iu shmang historisë të shtruar në mënyrë kronologjike dhe hulumtoi zjarrin e muslimanëve në përhapjen e besimit islam, aspektin introspektiv, sakral të tij. Misioni (da'va) nuk është i panjohur për Islamin, përkundrazi, është detyrë e shenjtë e të gjithë muslimanëve që ta prezantojnë atë (**Ud'u ila sebili rabbike ... Kur'an**). ... Në dallim prej shumë shkencëtarëve të tjerë, fenomenin e frymës misionariste në Islam Arnoldi nuk e kërkon në dhunën dhe padurimësinë e fanatikëve muslimanë, në ekspeditat ushtarake: me shpatë në një dorë dhe me Kur'an në dorën tjetër, por në proceset normale të transformimit, në veprimin modest të predikuesve dhe tregtarëve muslimanë, të cilët përpiqeshin ta përhapnin fenë nëpër tërë botën, sipas shumë udhëzimeve kuranore.

Nëpër faqet e kësaj vepre do të shohim praktikimin historik të ajeteve kuranore të kësaj natyre, do të shohim historinë e predikimit islam, e jo të konvertimit detyrues, i cili kohë pas kohe mund të haset nëpër të gjitha periudhat e historisë së Islamit, duke abstenuar nga Urdhëresa hyjnore. Mirëpo, në vepër haset mungesa e klasës priftërore, e klerit, organizatës së veçantë për propagandimin e fesë, që e cek edhe Sami Frashëri në librin e tij “Përhapja e Islamit”. Në islam nuk ekzistonte ekuivalenti kristian, por ekziston ndjenja e përgjegjësisë që zë fill në personalitetin e besimtarit – muslimanit. Me këtë, secili është njëherësh edhe misionar.

Dhuna, përjashtim e jo rregull

Arnoldi shumë herë thekson se faktorët kryesorë të përhapjes së Islamit nuk duhen kërkuar në fanatizëm, në dhunë, por në simplifikimitin, jokomplikueshmërinë e thjeshtësinë e mësimin islam: “*Nuk ka zot tjetër pos Allahut Një dhe se Muhammedi është i dërguar i Tij*”

është e tëra që kërkon Islami për hyrje në Islam. Mësimi islam nuk është i ngarkuar me sisteme teologjike, ndaj mund ta shpjegojë çdo besimtar. Ai është i karakterit jodogmatik, racional, i qartë dhe vetëm pas përqafimit të tij të Islamit nga bindja, kërkon që individi i tillë të aftësohet dhe t'i zbatojë detyrat praktike të fesë: Shehadetin, namazin, zekatin, agjërimin dhe haxhin. Në këtë unitet të racionalizmit dhe ritualeve mund të gjendet sekreti i fuqisë me të cilën Islami dominoi në mendjet dhe zemrat njerëzore.

Xhizja, haraxhi – shenjë respektimi e jo diskriminimi

Po ashtu, Arnoldi shqyrton edhe tolerancën islame dhe lirinë e jetës fetare për të gjithë ata që paguajnë xhizjen, kompensim për sigurinë fetare e fizike brenda shtetit islam. Ekzistimi me disa shekuj i qindra sekteve e lëvizjeve ideore kristiane brenda Perandorisë Islame dëshmon më së miri për tolerancën që ka ekzistuar gjatë këtyre kohëve, kurse rastet e dhunës kanë qenë fryt i fanatikëve dhe entuziastëve e jo parim i Islamit, i ajeteve kuranore.

All-llahu në Kur'an pohon: *“Në fe nuk ka detyrim ...”*. (II, 256); *“Sikur të kishte dashur Zoti yt, do të kishte besuar gjithkush që është në tokë, pa përjashtim. A do t'i detyrosh ti njerëzit të bëhen besimtarë? Asnjë njeri nuk është besimtar pa vullnetin e All-llahut dhe Ai i dënon ata që nuk mendojnë.”* (X, 99-100).

Raportet e Osmanlinjve ndaj qytetarëve kristianë ishin në shenjë të mirëkuptimit dhe të tolerancës

Me pushtimin e Konstantinopolit më 1453, Mehmeti II, së pari doli në mbrojtje të kishës kristiane ortodokse dhe kishës kristiane përgjithësisht. Me këtë veprim ai e njohu Kristianizmin që paraqet një shkallë më tej të tolerancës. Me Fermanin që shpalli, e privilegjo

kishën dhe patrikun ortodoks Genadij II, administrimin intern të saj pa përzierje nga shteti, që ishte një kualitet në krahasim me shtetin bizantin. Disa burime bizantine gjendjen e popujve të ndryshëm nën Bizantin e përshkruajnë si të tmerrshme si në aspektin shpirtëror, ashtu edhe në atë biologjik. Janë joserioze ata individë dhe ato qarqe që në bazë të disa rasteve ekstreme dëshirojnë t'i zhvlerësojnë gjithë ato vlera.

Axhemi oglani / devshirma - përjashtim nga toleranca

Sipas Th. Arnoldit përjashtim nga mirëkuptimi dhe toleranca është marrja peng e fëmijëve meshkuj nga familjet kristiane, për t'i edukuar në frymën e ushtrisë perandorake. Ndonëse një veprim i tillë nuk ishte i justifikuar me burimet islame, ky veprim kishte rrënjë në sundimin e mëhershëm bizantin dhe nuk paraqiste risi dhe, në anën tjetër, popujt e varfëruar nga luftërat e shumta ishin në gjendje të mjerueshme, ndaj marrjen e djelmoshave në ushtrinë mbretërore edhe nuk e shihnin aq të tmerrshme, siç e përshkruajnë këtë disa relatorë kristianë, por si një mundësi të prosperimit politik dhe ekonomik të individit, familjes dhe rrethit ku jetonte.

Edhe Arnoldi, por edhe evropianët e tjerë, vërejnë dy faza të sundimit të Perandorisë Osmane: dy shekujt e parë janë në shenjë të drejtësisë e prosperimit të përgjithshëm, kurse shekujt e mëvonshëm karakterizohen nga rënie në të gjitha fushat e jetës.

Megjithë këto, mund të thuhet se jomuslimanët në Perandorinë Osmane ishin në gjendje më të favorshme sesa jomuslimanët nëpër vendet e tyre kristiane të asaj kohe, dhe se të gjitha problemet brenda Perandorisë Osmane nuk ishin vetëm për jomuslimanët, por edhe për vetë muslimanët.

Islami dhe shqiptarët

Kaptinë e veçantë është përqafimi i Islamit nga ana e shqiptarëve. Nëse kemi parasysh shkrimet e shumicës së autorëve shqiptarë dhe ato që ata shkruajnë, gjithsesi të ndikuar nga konceptonet historike sllavo-serbe, më pak perëndimore e fare pak shkencore,- atëherë në veprën e Th. Arnoldit na del një tjetër gjendje nga ajo që jemi mësuar ta dëgjojmë e ta lexojmë.

Dhuna, shpata, persekutimi, ngecja e shqiptarëve në zhvillim, si pasojë e përqafimit të Islamit e çështje të tjera, janë pohime të pavërtetuara e të pavërtetueshme, të paargumentuara e të paargumentueshme. Paragjykimet që datojnë nga tradita judeo-kristiane e greko-romake, nga kryqëzatat e inkuizicioni, kolonializmi e kongresi i Berlinit, Versaja, Londra, Shën Stefani, Jalta ...

kanë lënë gjurmë në këto shkrime, ndaj mbetet si obligim për institucionet dhe individët kompetentë që t'i përvishen një pune serioze për shkrimin e një historie shqiptare e edhe botërore, çfarë ka qenë e jo çfarë dëshirojmë ne sot të ketë qenë, aq më pak, çfarë dëshirojnë disa grupe fundamentaliste sllavo-bolshevike dhe fundamentaliste katoliko-centriste, të influencuara nga jashtë, të ketë qenë historia.

Përfundim

Pajtohemi apo nuk pajtohemi në tërësi me Th. Arnoldin, vepra e tij është një përmendore për historinë e da'ves (misionarizmit) në Islam, një vepër e pakalueshme dhe një shembull se si duhet të shkruhet historia dhe si duhet të trajtohet e kaluara. Kjo vepër e përkthyer tash disa vite por ende e pabotuar në gjuhën shqipe, do të kontribuonte edhe në kapërcimin e tendosjeve shekullore ndërmjet botës anglosaksone e perëndimore përgjithësisht e popujve muslimanë dhe në lidhjen e miqësisë dhe këmbimin e vlerave ndërmjet popujve dhe

kulturave. Atë që kanë bërë më herët Arnoldi e B. Shoi dhe që sot e bëjnë Rozhe Garod e Princi Çarls, nesër duhet ta bëjnë brezat e ardhshëm. Shembulli i Arnoldit duhet të ndiqet nga të gjitha palët se si duhet të shkruhet për njëri-tjetrin.

Neve shqiptarëve këto përpjekje duhet të na shërbejnë shembull se si duhet të kultivohet shkenca, kultura, bashkëjetesa e mirëkuptimi. Islami si cilësi këtë rol e ka luajtur në të kaluarën, këtë është në gjendje ta bëjë edhe sot, po edhe në të ardhmen.

Prandaj, apeli për publikimin sa më të shpejtë të kësaj vepre në gjuhën shqipe, mendoj se është i arsyeshëm. Çdo vonesë do të ishte në dëm të kulturës dhe qytetërimit shqiptar.

BIBLIOGRAFI

Ramadan Shkodra

I) BOTIMI I REVISTËS EDUKATA ISLAME 1971-2001

- 1) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore, nr. 1 Viti I 1971, Prishtinë, f. 56, for. 14x19.50 Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës Ilmije për RSS, Prishtinë, *Redaktor kryesor dhe përgjegjës*: Haxhi Sherif Ahmeti, korrektor: Hajrullah Hoxha, tirazhi: 1.000 ekzemplarë, shtypur në ndërmarrjen e shtypshkronjës “Progres” Mitrovicë.
- 2) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore, nr. 2 Viti I 1971, Prishtinë, f. 7, for. 14x19.50
Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës Ilmije për RSS, Prishtinë.
Redaktor kryesor dhe përgjegjës: Haxhi Sherif Ahmeti, korrektor: Hajrullah Hoxha, tirazhi: 1.200 ekzemplarë, shtypur në ndërmarrjen e shtypshkronjës “Progres” Mitrovicë.
- 3) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore, nr. 3 Viti I 1971, Prishtinë, f. 60, for. 14x19.50
Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës Ilmije për RSS, Prishtinë.

Redaktor kryesor dhe përgjegjës: Haxhi Sherif Ahmeti, korrektor: Hajrullah Hoxha, tirazhi: 1.700 ekzemplarë, shtypur në ndërmarrjen e shtypshkronjës “Progres” Mitrovicë.

- 4) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore,
nr. 4 Viti II 1972, Prishtinë, f. 61+2, for. 14x19.50
Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës Ilmije për RSS, Prishtinë.
Redaktor kryesor dhe përgjegjës: Haxhi Sherif Ahmeti, korrektor: Asllan Murati, tirazhi: 2.000 ekzemplarë, shtypur në ndërmarrjen e shtypshkronjës “Progres” Mitrovicë.
- 5) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore,
nr. 5 Viti II 1972, Prishtinë, f. 64, for. 14x19.50
Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës Ilmije për RSS, Prishtinë.
Kryeredaktor dhe korrektor: Haxhi Sherif Ahmeti, tirazhi: 2.000 ekzemplarë, shtypur në ndërmarrjen e shtypshkronjës “Progres” Mitrovicë
- 6) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore,
nr. 6 Viti II 1972, Prishtinë, f. 62, for. 14x19.50
Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës së Ulemave për RSS, Prishtinë.
Redaktuar prej këshillit redaktues: Muhamed Islami, Ismail Hakia, Muharrem Ramadani, Rashid Osmani, Bajrush Ahmeti, Jetish Bajrami dhe Sherif Ahmeti. Kryeredaktor: Sherif Ahmeti, tirazhi: 2.000 ekzemplarë, shtypur në ndërmarrjen e shtypshkronjës “Progres” Mitrovicë.
- 7) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore,
nr. 7 Viti III 1973, Prishtinë, f. 76+4, for. 13.50x19
Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës së Ulemave për RSS, Prishtinë.

Redaktuar prej këshillit redaktues: Muhamed Islami, Ismail Hakia, Muharrem Ramadani, Rashid Osmani, Bajrush Ahmeti, Jetish Bajrami dhe Sherif Ahmeti. Kryeredaktor: Sherif Ahmeti, tirazhi: 2.000 ekzemplarë, shtypur në ndërmarrjen e shtypshkronjës “Progres” Mitrovicë.

- 8) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore,
nr. 8 Viti III 1973, Prishtinë, f. 77+2, for. 14x19.50
Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës Ilmije për RSS, Prishtinë,
Redaktuar prej këshillit redaktues: Muhamed Islami, Ismail Hakia, Muharrem Ramadani, Rashid Osmani, Bajrush Ahmeti, Jetish Bajrami dhe Sherif Ahmeti. Kryeredaktor: Sherif Ahmeti, tirazhi: 2.000 ekzemplarë, shtypur në ndërmarrjen e shtypshkronjës “Progres” Mitrovicë.
- 9) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore,
nr. 9/10 Viti IV 1974, Prishtinë, f. 101+3, for. 14x19.50
Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës së Ulemave për RSS, Prishtinë.
Redaktuar prej këshillit redaktues: Muhamed Islami, Ismail Hakia, Jetish Bajrami, Safet Basha, Abdullah Zhegrova dhe Sherif Ahmeti. Kryeredaktor: Sherif Ahmeti, tirazhi: 2.500 ekzemplarë, shtypur në ndërmarrjen e shtypshkronjës “Progres” Mitrovicë.
- 10) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore,
nr. 11/12 Viti IV 1974, Prishtinë, f. 76+4, for. 14x19.50
Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës së ulemave për RSS, Prishtinë.
Redaktuar prej këshillit redaktues: Muhamed Islami, Ismail Hakia, Jetish Bajrami, Safet Basha, Abdullah Zhegrova dhe Sherif Ahmeti. Kryeredaktor: Sherif Ahmeti, tirazhi: 2.500 ekzemplarë, shtypur në ndërmarrjen e shtypshkronjës “Progres” Mitrovicë.

- 11) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore,
nr. 13 Viti V 1975, Prishtinë, f. 75+5, for. 14x19.50
Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës së Ylemave RSS, Prishtinë.
Redaktuar prej këshillit redaktues: Muhamed Islami, Ismail Hakia,
Jetish Bajrami, Safet Basha, Abdullah Zhegrova, Bajrush Ahmeti
dhe Sherif Ahmeti. Kryeredaktor: Sherif Ahmeti, tirazhi: 2.500
ekzemplarë, shtypur në ndërmarrjen e shtypshkronjës “Progres”
Mitrovicë.
- 12) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore,
nr. 14 Viti V 1975, Prishtinë, f. 66+2, for. 14x19.50
Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës së Ylemave për RSS,
Prishtinë.
Redaktuar prej këshillit redaktues: Muhamed Islami, Ismail Hakia,
Jetish Bajrami, Safet Basha, Abdullah Zhegrova, Bajrush Ahmeti
dhe Sherif Ahmeti. Kryeredaktor: Sherif Ahmeti, tirazhi: 2.500
ekzemplarë, shtypur në ndërmarrjen e shtypshkronjës “Progres”
Mitrovicë.
- 13) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore,
nr. 15/16 Viti VI 1976, Prishtinë, f. 110+2, for. 14x20
Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës së Ylemave për RSS,
Prishtinë.
Redaktuar prej këshillit redaktues: Muhamed Islami, Ismail Hakia,
Jetish Bajrami, Safet Basha, Abdullah Zhegrova, Bajrush Ahmeti
dhe Sherif Ahmeti. Kryeredaktor: Sherif Ahmeti, tirazhi: 2.500
ekzemplarë, shtypur në ndërmarrjen e shtypshkronjës “Progres”
Mitrovicë.

- 14) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore,
nr. 17 Viti VI 1976, Prishtinë, f. 80, for. 14x20
Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës së Ylemave për RSS,
Prishtinë,
Redaktuar prej këshillit redaktues: Muhamed Islami, Ismail Hakia,
Jetish Bajrami, Safet Basha, Abdullah Zhegrova, Bajrush Ahmeti
dhe Sherif Ahmeti. Kryeredaktor: Sherif Ahmeti, tirazhi: 2.500
ekzemplarë, shtypur në ndërmarrjen e shtypshkronjës “Progres”
Mitrovicë.
- 15) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore,
nr. 18 Viti VI 1976, Prishtinë, f.78+2, for. 14x20
Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës së Ylemave për RSS,
Prishtinë,
Redaktuar prej këshillit redaktues: Muhamed Islami, Ismail Hakia,
Safet Basha, Abdullah Zhegrova, Jetish Bajrami, Bajrush Ahmeti
dhe Sherif Ahmeti. Kryeredaktor: Sherif Ahmeti, tirazhi: 2.500
ekzemplarë, shtypur në ndërmarrjen e shtypshkronjës “Progres”
Mitrovicë.
- 16) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore,
nr. 19 Viti VII 1977, Prishtinë, f.78+2, for. 14x19.50
Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës së Ylemave për RSS,
Prishtinë.
Redaktuar prej këshillit redaktues: Muhamed Islami, Ismail Hakia,
Safet Basha, Abdullah Zhegrova, Jetish Bajrami, Bajrush Ahmeti
dhe Sherif Ahmeti. Kryeredaktor: Sherif Ahmeti, tirazhi: 2.500
ekzemplarë, shtypur në ndërmarrjen e shtypshkronjës “Progres”
Mitrovicë.

- 17) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore,
nr. 20 Viti VII 1977, Prishtinë, f.84+4, for. 13.50x20
Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës së Ylemave për RSS,
Prishtinë,
Redaktuar prej këshillit redaktues: Muhamed Islami, Ismail Hakia,
Safet Basha, Abdullah Zhegrova, Jetish Bajrami, Bajrush Ahmeti
dhe Sherif Ahmeti. Kryeredaktor: Sherif Ahmeti, tirazhi: 2.500
ekzemplarë, shtypur në ndërmarrjen e shtypshkronjës “Progres”
Mitrovicë.
- 18) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore,
nr. 21 Viti VII 1977, Prishtinë, f.76, for. 14.50x20
Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës së Ylemave për RSS,
Prishtinë.
Redaktuar prej këshillit redaktues: Muhamed Islami, Ismail Hakia,
Safet Basha, Abdullah Zhegrova, Jetish Bajrami, Bajrush Ahmeti
dhe Sherif Ahmeti. Kryeredaktor: Sherif Ahmeti, tirazhi: 2.000
ekzemplarë, shtypi: Organizata punuese për veprimtarinë grafike
“Progres-Svetozar Gjorgjeviq” Mitrovicë.
- 19) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore,
nr. 22 Viti VIII 1978, Prishtinë, f.70+2, for. 14x19.50
Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës së Ylemave për RSS,
Prishtinë.
Redaktuar prej këshillit redaktues: Muhamed Islami, Ismail Hakia,
Safet Basha, Abdullah Zhegrova, Jetish Bajrami, Bajrush Ahmeti
dhe Sherif Ahmeti. Kryeredaktor: Sherif Ahmeti, tirazhi: 2.000
ekzemplarë, shtypi: Organizata punuese për veprimtarinë grafike
“Progres-Svetozar Gjorgjeviq” Mitrovicë.

- 20) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore,
nr. 23 Viti IX1979, Prishtinë, f. 58+2, for. 14x19.50
Botoi: Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës së Ylemave për RSS,
Prishtinë.
Redaktuar prej këshillit redaktues: Muhamed Islami, Ismail Hakia,
Safet Basha, Abdullah Zhegrova, Jetish Bajrami, Bajrush Ahmeti
dhe Sherif Ahmeti. Kryeredaktor: Sherif Ahmeti, tirazhi: 2.000
ekzemplarë, shtypi: Organizata punuese për veprimtarinë grafike
“Progres-Svetozar Gjorgjeviq” Mitrovicë.
- 21) **EDUKATA ISLAME**, revistë fetare tremujore,
